

ZHVILLIMI I KOMPETENCËS NDËRKULTURORE NËPËRMJET MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE

Enkeleda Jata

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat Sociale, me profil Pedagogji, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor:
Prof.Dr.Nikoleta Mita

Numri i fjalëve: 59463

Vendi, muaji, viti i dorëzimit: Tiranë, Korrik 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë e nënshkruara, Enkeleda Jata, deklaroj nën përgjegjësinë time, se ky punim doktoral është shkruar prej meje, nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe as nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara gjatë shqyrtimit të literaturës, apo argumentimit të çështjeve.

ABSTRAKT

Përdorimi i gjuhës në kontekstin e duhur social dhe kulturor është bërë tashmë një detyrim për të gjithë ne. Në ditët e sotme kërkohet që studentët të aftësohen për të kuptuar individë që u përkasin profileve sociale dhe kulturore të ndryshme nga e tyre. Tashmë është e pranuar gjerësisht që kompetencat gjuhësore nuk janë të mjaftueshme për të pasur një komunikim të suksesshëm me individë të kulturave të ndryshme. Mësimi i një gjuhe, duke përfshirë dimensionin ndërkulturor, bën që të përvetësohen si kompetencat gjuhësore, ashtu edhe kompetencat ndërkulturore.

Qëllimi i këtij studimi është të zbulojë mundësitë e mësimi të gjuhës angleze për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore, të argumentojë se përdorimi i ndërthurur i kompetencave gjuhësore dhe ndërkulturore ndihmon, një përvetësim më të mirë të gjuhës së huaj dhe krijimin e strategjive efektive për mësimdhënien e saj, që t'u përshtatet kërkesave të qytetarit të sotëm global. Duke paraqitur problemet që hasin studentët dhe pedagogët, si dhe modelet më të efektshme të zhvillimit të kompetencave ndërkulturore, besojmë që ky studim do të japë një ndihmesë, sado të vogël, në fushën e didaktikës së gjuhëve të huaja.

ABSTRACT

It has turned into a must for all us, the use of language according to the appropriate social and cultural context. Nowadays, the students have to be enabled to better understand the individuals that fall in social and cultural profile different from ours. It has been widely accepted that linguistic competences are not enough to have a successful communication with individuals of other culture. Learning a language by implying the intercultural aspect, makes it possible for both linguistic and intercultural competences to be acquired.

This study is focused in the potentials of developing intercultural competences through teaching English language. This is an effort to provide a methodological efficient model for the development of this competence.

The aim of this study is to explore the possibilities of teaching English for the development of intercultural competence and to identify successful teaching methods for developing this competence in higher education. This study argues that use of combined linguistic and intercultural competence will help to create global citizens, to improve the way of foreign language acquisition, and to create effective strategies for teaching foreign languages. Presenting the problems faced by students and professors as well as models of effective development of intercultural competence, it is believed that this study will be a contribution in the field of foreign languages didactics.

DEDIKIM

Një dedikim i sinqertë shkon për familjen time, që nuk rreshti kurrë së sakrifikuari.

Thanks, Dad and Mom, for your endless love.

Thank you, Lord, for always being there for me since the beginning of my journey.

FALENDERIME

Falenderimi i parë i takon udhëheqëses sime shkencore Prof.Dr. Nikoleta MITA, për gjithë mbështetjen dhe ndihmën që më ka dhënë gjatë këtyre tre viteve. Falë ndihmës Prof. Nikoletës pata mundësinë të arrija deri këtu. Do t'i jem gjithmonë mirënjohëse.

Një falenderim i veçantë shkon edhe për statisticienë Marina NTALLA, e cila më ndihmoi për nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave me saktësi.

Falenderoj gjithashtu kolegët e mi, pedagogët e gjuhës angleze të Shkollës së Lartë Private „Hëna e Plotë“ Beder, Universitetit „Aleksandër Moisiu “Durrës dhe Universitetit „Aleksandër Xhuvani“Elbasan, për mbështetjen dhe sugjerimet e tyre.

Falenderoj të gjithë studentët që u bënë pjesë e këtij studimi dhe më ndihmuan shumë me përgjigjet e tyre.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

01. Përligjja e temës	1
02. Objekti dhe qëllimi i kërkimit.....	3
03. Struktura e punimit.....	4

KAPITULLI I: KONSIDERATA TEORIKE PËR KOMPETENCËN NDËRKULTURORE

1.1 Kuptimi i kompetencës ndërkulturore.....	6
1.2. Kuptimi i dimensionit ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj.....	26
1.3. Rëndësia e kulturës në mësimin e gjuhës së huaj	31
1.4. Vetëdija kritike kulturore.....	45
1.5. Rëndësia e kompetencës ndërkulturore.....	49
1.6. Nga kompetenca komunikative te kompetenca ndërkulturore.....	52
1.7. Kompetenca ndërkulturore sipas Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.....	58
1.8. Role të reja për mësimin dhe të nxënësit e gjuhës së huaj.....	64

KAPITULLI II: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

2.1. Qëllimi i studimit.....	68
2.2. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	68
2.3. Metodat e kërkimit.....	69

2.4. Kampioni i pjesëmarrësve në studim.....	69
2.5. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave parësore.....	71
2.5.1. Pyetësor për pedagogët.....	72
2.5.2. Pyetësor për studentët.....	73
2.5.3. Fokus grup me pedagogë.....	75
2.5.4. Skedë vëzhgimi.....	75
2.5.5. Ese të studentëve.....	76
2.6. Realizimi i kërkimit.....	77
2.7. Kufizime të studimit.....	78

KAPITULLI III: GJETJE TË KËRKIMIT DHE ANALIZA E GJETJEVE

3.1. Gjetje për pedagogët.....	79
3.1.1. Perceptimi i pedagogut për kompetencën ndërkulturore.....	81
3.1.2. Studentët, gjuha dhe kultura e huaj sipas referimeve të pedagogëve...	91
3.1.3. Njohja e pedagogëve me kulturën e huaj.....	93
3.1.4. Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj sipas pedagogëve.....	97
3.1.5. Mësimdhënia ndërkulturore në lëndën e gjuhës së huaj sipas pedagogëve.....	99
3.1.6. Lidhja e praktikave të mësimi në gjuhën e huaj me perceptimin e pedagogut për kompetencën ndërkulturore.....	100
3.2. Gjetje nga pyetësi për studentët.....	104

3.2.1. Perceptimi i studentit për kompetencën ndërkulturore sipas gjinisë.....	115
3.2.2. Studentët, gjuha dhe kultura e huaj sipas gjinisë.....	116
3.2.3. Njohja me kulturën e huaj sipas gjinisë.....	119
3.2.4. Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj sipas gjinisë.....	122
3.2.5. Mësimdhënia ndërkulturore në lëndën e gjuhës së huaj sipas gjinisë.....	123
3.3. Skedat e vrojtimit.....	124
3.3.1. Skeda e vrojtimit të pedagogëve.....	125
3.3.2. Skeda e vrojtimit të studentëve.....	129
3.4. Gjetjet nga fokus grupet.....	132
3.5. Gjetjet nga esetë.....	136

KAPITULLI IV: MODELI I ZHVILLIMIT TË KOMPETENCËS

NDËRKULTURORE NËPËRMJET M ËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE

4.1. Kuptimi i modeleve të reja.....	140
4.2. Metodatat e mësimdhënies dhe kompetenca ndërkulturore.....	142
4.3. Vlerësimi i kompetencës ndërkulturore.....	167
4.3.1. Disa nga modelet për vlerësimin e kompetencave ndërkulturore.....	172
4.4. Problemet dhe vështirësitë që ndeshin mësuesit në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.....	188

KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. Kompetenca ndërkulturore mbi bazën e perceptimit të studentëve.....	193
5.1.1. Roli i gjinisë në perceptimin e kompetencës ndërkulturore të studentëve.....	195
5.2. Kompetenca ndërkulturore mbi bazën e perceptimit të pedagogëve.....	196
5.2.1. Perceptimi i kompetencës ndërkulturore mbi bazën e raportimit të pedagogëve.....	196
5.2.2. Lidhja e metodave të mësimdhënies në gjuhën angleze me perceptimin e kompetencës ndërkulturore.....	198
5.3. Vrojtimi i pedagogëve dhe studentëve	200
5.3.1. Skeda e vrojtimit të pedagogëve.....	200
5.3.2. Skeda e vrojtimit të studentëve.....	201
5.4. Fokus Grupet.....	202
5.5. Rekomandime.....	203

REFERENCA

SHTOJCA

LISTA E TABELAVE

<i>Tabela 1.</i> Frekuencat e kohës së punës të pedagogëve të gjuhës angleze.....	70
<i>Tabela 2.</i> Analiza faktoriale e shkallës "Perceptimi i objektivave të mësimi të gjuhës së huaj".....	83
<i>Tabela 3.</i> Si është shpërndarë koha e mësimdhënies për "mësimin e gjuhës" dhe "mësimin e kulturës" në lëndën e gjuhës angleze, sipas referimeve të pedagogëve.....	87
<i>Tabela 4.</i> Frekuencat e pyetjes "A keni ndjesinë se ju do të donit t'i kushtoni më shumë kohë "mësimi të kulturës" gjatë orëve të mësimi tuaj në gjuhë të huaj, por që në njëfarë mënyre nuk e keni realizuar atë"?.....	88
<i>Tabela 5.</i> Vlera mesatare e motivacionit të studentëve për mësimin e gjuhës angleze mbi bazën e referencave të pedagogëve.....	91
<i>Tabela 6.</i> Vlera mesatare në lidhje me kontaktin e studentëve me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e referencave të pedagogëve.....	92
<i>Tabela 7.</i> Vlera mesatare e faktorëve në lidhje me njohjen e pedagogëve me vendin e gjuhës angleze.....	94
<i>Tabela 8.</i> Vlera mesatare në lidhje me udhëtimet e pedagogëve për në shtetin e gjuhës së huaj.....	95
<i>Tabela 9.</i> Vlera mesatare në lidhje me kontaktet kulturore-shkencore të pedagogëve me shtetin e gjuhës së huaj.....	96

<i>Tabela 10. Vlera mesatare në lidhje me aktivitetet e pedagogut për mësimin e kulturës së huaj mbi bazën e referimeve të pedagogëve.....</i>	<i>98</i>
<i>Tabela 11. Vlera mesatare në lidhje me aspekte të veçanta kulturore që pedagogu trajton në mësim mbi bazën e referimeve të pedagogëve.....</i>	<i>99</i>
<i>Tabela 12. Vlera mesatare në lidhje me mësimdhënien kulturore në mësim mbi bazën e referimeve të pedagogëve.....</i>	<i>99</i>
<i>Tabela 13. Marrëdhëniet mes praktikës së mëimit të gjuhës së huaj dhe aspekteve të veçanta kulturore (sipas raportimeve të mësuesve).....</i>	<i>101</i>
<i>Tabela 14. Marrëdhëniet mes praktikave të mëimit të gjuhës së huaj dhe perceptimit të objektivave të mëimit të gjuhës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve).....</i>	<i>101</i>
<i>Tabela 15. Marrëdhëniet mes praktikave të mëimit dhe mëimit të kulturës në gjuhën e huaj (sipas raportimeve të pedagogëve).....</i>	<i>102</i>
<i>Tabela 16. Marrëdhëniet mes praktikave të mëimit dhe gjuhës e kulturës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve).....</i>	<i>102</i>
<i>Tabela 17. Marrëdhëniet mes praktikave të mëimit dhe njohjes së kulturës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve).....</i>	<i>103</i>
<i>Tabela 18. Marrëdhëniet mes praktikave të mëimit dhe gjuhës e mësimdhënies ndërkulturore (sipas raportimeve të pedagogëve).....</i>	<i>104</i>
<i>Tabela 19. Analiza faktoriale e shkallës "Perceptimi i kompetencës ndërkulturore"...</i>	<i>105</i>

<i>Tabela 20. Analiza faktoriale e shkallës "Sa a njihni vendin e lidhur me gjuhën angleze?"</i>	107
<i>Tabela 21. Analiza faktoriale e shkallës " Aktivitetet mësimore për të njohur kulturën e huaj"</i>	109
<i>Tabela 22. Analiza faktoriale e shkallës "Mësimdhënia ndërkulturore"</i>	113
<i>Tabela 23 . Vlera mesatare e perceptimit ndërkulturor mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	115
<i>Tabela 24. Si është shpërndarë koha e mësimdhënies për "mësimin e gjuhës" dhe "mësimin e kulturës" në lëndën e gjuhës angleze që ju zhvilloni në këtë vit akademik?</i>	116
<i>Tabela 25. Vlera mesatare e motivacionit për mësimin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	117
<i>Tabela 26. Vlera mesatare në lidhje me kontaktin me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	118
<i>Tabela 27. Vlera mesatare e faktorëve në lidhje me njohjen me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	119
<i>Tabela 28. Vlera mesatare në lidhje me udhëtimet për në shtetin e gjuhës së huaj mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	120
<i>Tabela 29. Vlera mesatare në lidhje me kontaktet kulturore-shkencore me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve</i>	121

<i>Tabela 30.</i> Vlera mesatare në lidhje me aktivitetet e pedagogut për mësimin e kulturës së huaj mbi bazën e gjinisë së studentëve.....	122
<i>Tabela 31.</i> Vlera mesatare në lidhje me aspekte të veçanta kulturore që pedagogu trajton në mësim mbi bazën e gjinisë së studentëve.....	123
<i>Tabela 32.</i> Vlera mesatare në lidhje me mësimdhënien kulturore në mësim mbi bazën e gjinisë së studentëve.....	124

LISTA E GRAFIKËVE

<i>Grafiku 1.</i> Vlerat mesatare të faktorëve të shkallës " Perceptimi i objektivave të mësimit të gjuhës së huaj.....	85
<i>Grafiku 2.</i> Vlerat mesatare të faktorëve të shkallës " Perceptimi i objektivave të mësimit të gjuhës së huaj" sipas referimeve të pedagogëve.....	86
<i>Grafiku 3.</i> Skedat e vrojtimit të pedagogëve.....	129
<i>Grafiku 4.</i> Skedat e vrojtimit të studentëve.....	132

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1.</i> Kompetenca ndërkulturore sipas Byram.....	11
<i>Figura 2.</i> Një mënyrë për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore.....	14
<i>Figura 3.</i> Piramida e Kompetencës Ndërkulturore.....	15
<i>Figura 4.</i> Procesi i zhvillimit të kompetencës ndërkulturore.....	16
<i>Figura 5.</i> Modeli i kompetencës komunikative.....	56
<i>Figura 6.</i> Skema e rishikuar e ‘kompetencave komunikative’	57
<i>Figura 7.</i> Modeli i vazhdimësisë së zhvillimit ndërkulturor.....	182

HYRJE

01. Përligjja e temës

Në ditët e sotme të një ndërveprimi të gjerë ndërkombëtar kërkohet që njerëzit të përdorin gjuhën në mënyrën e duhur në ambiente sociale dhe kulturore. Mësimi i gjuhëve ndihmon njerëzit të fitojnë kompetencën gjuhësore, për të komunikuar. Por në mësimin e gjuhës duhet të përfshihet edhe dimensionin ndërkulturor, që t'i pajisë njerëzit me kompetencën ndërkulturore; që u nevojitet për të bashkëvepruar me njerëzit e kulturave të tjera.

Në literaturën e fushës, dimensionin ndërkulturor përcaktohet si transmetim informacioni për një vend të huaj dhe lidhet me: a) aftësimin e njerëzve për të kuptuar sesi kryhet ndërveprimi ndërkulturor; b) me identitetet sociale që janë pjesë e gjithë bashkëveprimit; c) me perceptimet e të gjitha palëve, që ndikojnë në suksesin e komunikimit; d) me synimin që të mund të mësojnë më shumë për njerëzit me të cilët komunikojnë.

Kompetenca ndërkulturore konsiderohet si një objekt i rëndësishëm i mësimin të një gjuhe të huaj. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (2007) përcaktoi ndërgjegjësimin, të kuptuarit dhe kompetencën ndërkulturore si objektivat kryesore të të nxënies, për të diplomuarit në gjuhë.

Këto attribute kanë ndërlikimet e veta për pedagogjinë, kurrikulën dhe studimin e kompetencave ndërkulturore. Sipas modelit të Byram-it (1997), kompetenca ndërkulturore përbëhet nga katër elemente: njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vetëdija kritike kulturore.

Sipas Sercu-t (2004) kompetenca ndërkulturore përbëhet prej dy dimensionesh: kulturore specifike (njohuritë dhe aftësitë për gjuhën e vendit) dhe kulturore e përgjithshme (njohuri dhe aftësi më të përgjithshme të transferueshme në të gjitha kulturat). Njohuritë e përgjithshme kulturore zhvillojnë aftësinë për të respektuar kulturën, për të rriur interesin dhe tolerancën për të dhe për të njohur pikëpamjet e bashkëveprimit të dy kulturave, kulturës vendase dhe kulturës së vendit të gjuhës që mëson.

Përvoja e deritanishme bashkëkohore dëshmon se që të zhvillohet kompetenca ndërkulturore, ndihmojnë një sërë metodash të mësimdhënies. Duke qenë se qasja e bazuar në kompetenca është një qasje e re e shekullit të 21-të, studimet për të janë të kufizuara. Mungesa e studimeve empirike është identifikuar nga studiues të ndryshëm.

Në përvojën e arsimit shqiptar qasja e të mësuarit mbi bazën e kompetencave është një qasje jo shumë e lëvruar. Ndërkaq, nevoja për zotërimin e gjuhës angleze është një kërkesë e shtuar fort në Shqipëri, veçanërisht me hapjen e saj drejt botës, me aspiratën për t'iu bashkuar familjes evropiane, sepse anglishtja luan rolin e një gjuhe globale.

Nisur nga këto fakte dhe nga fakti që unë jap mësimin e gjuhës angleze në një universitet, ku studiojnë studentë nga vende të ndryshme, vendosa të ndërmarr këtë studim për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore nëpërmjet mësimin të kësaj gjuhe. Besoj se nëpërmjet tij mund të ndihmoj për një njohje më të mirë të kësaj fushe dhe për një mësimdhënie të efektshme në funksion të saj. Studimi im për kompetencën ndërkulturore mund të shikohet edhe si një përpjekje për të dhënë një model metodologjik për zhvillimin e kësaj kompetence.

Në punim jepet një këndvështrim mbi rëndësinë e kompetencave ndërkulturore dhe metodologjinë që përdoret për zhvillimin e këtyre kompetencave në mësimdhënien e gjuhës angleze.

Informacioni për punimin është mbledhur nëpërmjet pyetësorëve për studentët dhe pedagogët, fokus grupeve dhe skedës së vrojtimit në tre institucione të arsimit të lartë, Shkolla e Lartë Private „Hëna e Plotë“ Beder, Universiteti „Aleksandër Moisiu“ i Durrësit dhe Universiteti „Aleksandër Xhuvani“ i Elbasanit .

02. Objekti dhe qëllimi i kërkimit

Qëllimi i këtij studimi është të zbulojë mundësitë e mësimit të gjuhës angleze për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore dhe të dallojë metodat e suksesshme të mësimdhënies për zhvillimin e kësaj kompetence në arsimin e lartë. Mësimi i gjuhës së huaj është përcaktuar si ndërkulturore (Sercu et.al. 2005). Klasa e gjuhës së huaj është vendi ku takohen të paktën dy kultura. Megjithë njohjen e rëndësisë së të mësuarit ndërkulturore, mësuesit e gjuhëve të huaja ngurojnë të integrojnë në kurrikula teorinë e reja të bazuar në kompetenca dhe të zhvillojnë kompetencën ndërkulturore në praktikën pedagogjike, edhe nga mungesa e studimeve konkrete që do ta ndihmonin këtë praktikë. Ky studim synon të lidhë teorinë me praktikën, duke kontribuar në debatin për kompetencat ndërkulturore. Çështja e kompetencës ndërkulturore studiohet në kontekstin e programeve universitare dhe në kontekstin e grupeve multikulturore.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të tregojë që studentët kanë nevojë për përvetësimin e këtyre kompetencave, për të pasur një komunikim sa më të efektshëm me individë të kulturave të vendeve anglishtfolëse.

Një tjetër synim i këtij studimi është të pasqyrojë procesin aktual të mësimdhënies dhe vendin që zë kompetenca ndërkulturore në të, duke treguar të gjitha problemet që hasin pedagogët dhe studentët.

Rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë që të dallojmë metoda më efikase të mësimdhënies për rritjen e aftësive të studentëve.

0.3 Struktura e punimit

Ky punimi përmban pesë kapituj, referencat dhe shtojca (pyetësor, fokus grupë, skeda vrojtimi)

Në kapitullin e parë të këtij studimi paraqitet baza teorike, me arritjet e derisotme teorike për kompetencën ndërkulturore. Aty trajtohen konceptet themelore të kompetencave komunikative dhe kompetencave ndërkulturore, vendi që zënë kompetencat ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze si një qëllim mësimor i rëndësishëm dhe i pashmangshëm. Në të, vihen në dukje të gjitha aftësitë që duhet të fitojë studenti për takime ndërkulturore.

Në kapitullin e dytë pasqyrohet metodologjia e kërkimit, e cila përmban pyetjet kërkimore, hipotezat e kërkimit, instrumentet që janë përdorur për të vërtetuar hipotezat, kampionë e përzgjedhur për studim, si dhe procedurat e kryerjes së studimit.

Në kapitullin e tretë renditen gjetjet që kemi marrë me anë të pyetësorëve të pedagogëve, studentëve, fokus grupeve, skedave të vëzhgimit dhe eseve, dhe bëhet analiza e tyre.

Në kapitullin e katërt trajohen modele të zhvillimit të kompetencës ndërkulturore nëpërmjet mësimit të gjuhës së huaj.

Në kapitullin e pestë jepen përfundimet dhe rekomandimet kryesore të këtij studimi.

KAPITULLI I: KONSIDERATA TEORIKE PËR KOMPETENCEN NDËRKULTURORE

1.1. Kuptimi i kompetencës ndërkulturore

‘Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore është si të mësosh të ngasësh një biçikletë, një aktivitet kompleks që ka nevojë për udhëzime dhe kohë.’ Gregersen-Hermans & Pusch, (2012)

Ne jetojmë në kohën e ndryshimeve të mëdha. Lëvizja e popullsisë vazhdon me ritmet më të larta në historinë e njerëzimit, duke sjellë kontakte të gjera ndërkulturore ndërmjet grupeve të ndryshme gjuhësore dhe kulturore. Pra, bota bëhet gjithnjë e më shumë e ndërlidhur dhe komunikimi ndërkombëtar po përfshin një numër në rritje të popullsisë. Interneti e ka bërë botën të duket e vogël. Ne sot po jetojmë në një ‘fshat global’ ku aksesimi drejt kulturave të tjera është më e lehtë se kurrë. Falë zhvillimit të teknologjisë, sot është shumë e lehtë të bashkëpunosh me individë nga gjithë bota, çka bën që kontaktet ndërkulturore të jenë të shumta.

Pikërisht gjatë këtyre proceseve ka lindur termi *kompetencë ndërkulturore*, përmbajtja e të cilit ende nuk është përcaktuar plotësisht. Diskutimi rreth kuptimit të këtij termi dhe zhvillimit të kompetencës ndërkulturore është një çështje e rëndësishme aktuale.

Në këtë kontekst institucionet drejtuese të arsimit kanë përfshirë objektiva ndërkulturore në kurrikulat shkollore dhe mësuesit përballen me sfidat për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore.

Shprehjen *kompetencë ndërkulturore* e dëgjojmë shpesh herë në debate pedagogjike, por pa u ndalur të reflektojmë sesi mund ta ndërthurim me kurrikulat aktuale të mësimdhënies. Duke pasur parasysh ndryshimet që ndodhin në botën e sotme, mund të themi që kompetenca ndërkulturore po fillon të luajë një rol kyç në komunikimin midis individëve që u përkasin kulturave të ndryshme. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore është shumë i nevojshëm për të bashkëjetuar në shoqërinë e sotme multikulturore. Fantini,A. & Tirmiyi,A pohojnë që kompetenca ndërkulturore është ‘.. një sërë aftësish që duhen për të performuar në mënyrën e duhur efektive, kur ndërveprojmë me të tjerë që janë të ndryshëm, si nga ana linguistike ashtu edhe nga ana kulturore’(Fantini,A. & Tirmiyi,A, 2006:13).

Kompetenca ndërkulturore prek gati të gjitha fushat e jetës, çka është shumë e rëndësishme për studentët që duan të studiojnë jashtë shtetit. Duke lëvizur nga njëri vend në tjetrin, individë të një nacionaliteti bashkëjetojnë me individë të nacionaliteteve të tjera. Në këto raste, ekziston mundësia e konflikteve socio-kulturore, për zgjidhjen e të cilave janë të nevojshme aftësitë për të kuptuar njëri-tjetrin, për të tejkaluar të gjitha pengesat kulturore, për një funksionim sa më të mirë të shoqërisë demokratike. Të gjithë këto zhvillime që kanë ndodhur, çuan në krijimin e metodave për të ndihmuar bashkëjetesën në një mjedis multikulturor. Modelet e zhvillimit dhe të vlerësimit të kompetencave ndërkulturore nxjerrin shumë pyetje për mësuesit e pedagogët, duke qënë se është një qasje e re.

Sigurisht, jo të gjitha modelet e zhvillimit të kompetencave ndërkulturore i përshtaten çdo përvojë ndërkulturore që mund të hasë njeriu në jetën e përditshme, por e ndihmojnë të formojë aftësitë, njohuritë, qëndrimet që i duhen për ndërveprim kulturor.

Sipas Barret, M et al. kompetenca ndërkulturore, e zbatuar në veprimin e kombinuar të këtyre cilësive, na lejon:

- të kuptojmë dhe respektojmë njerëzit që u përkasin kulturave të ndryshme nga e jona;
- të reagojmë në mënyrën e duhur efektive, kur ndërveprojmë dhe komunikojmë me individë që u përkasin këtyre kulturave;
- të krijojmë marrëdhënie pozitive dhe konstruktive;
- të kuptojmë veten, nëpërmjet takimeve në ambiente të ndryshme kulturore. (Barret,M., et al. 2014:16)

Për të kuptuar konceptin e *kompetencës ndërkulturore*, duhet të kemi të qarta konceptet identitet, kulturë, takim ndërkulturor dhe kompetencë. (Barrett,M. et al., 2014:13)

Identiteti i ndihmon njerëzit të përcaktojnë individualitetin e tyre dhe i orienton e i pozicionon në botën që i rrethon. Identiteti është *personal* dhe *social*. Ai personal u referohet karakteristikave të personit (i dashur, tolerant, etj), marrëdhënieve ndërpersonale (nënë, bije etj); ai social bazohet në përkatësitë në grupe të ndryshme sociale (skuadër sporti, grupi i punës, grupi i edukimit etj). Ndërkaq, identiteti i njeriut varion sipas situatës (bashkëshort në shtëpi, shef në pune etj). (Barrett,M. et al., 2014:13)

Kultura: është një term i vështirë për t'u përkufizuar. Ajo përfshin kulturën materiale, institucione sociale dhe, së treti, norma, kultura, vlera, qëndrimet të cilat anëtarët e grupit i përdorin si referencë për t'i dhënë kuptim dhe për t'u lidhur me botën. Kultura është një kompozitë e këtyre të trijave. Brenda grupeve kulturore ka një variacion të konsiderueshëm, sepse burimi material, social dhe subjektiv që perceptohen të lidhura me anëtarësinë e grupit, shpeshherë kontestohen nga individë të ndryshëm ose nëngrupe. Te

gjitha kulturat jane fluide dhe ndryshojnë gjatë kohës, si rezultat i ngjarjeve historike, ekonomike dhe politike. Kulturat ndryshojne dhe sepse anëtarët e brendshëm kontestojne kuptimin, normat dhe vlerat. Ndërkaq mirëkuptimi dhe funksionimi social mund edhe të përkeqësohet, nëse të tjerët i shohin identitetet tona të papërshtatshme. (Barrett,M. et al. 2014:13-15)

Takimi ndërkulturor: Një takim konsiderohet ndërkulturor, kur dy ose më shumë persona vijnë nga kultura të ndryshme dhe diferencat midis tyre perceptohen dhe theksohen nga situata ose nga orientimet e qëndrimet e personave përkatës. Pra, reagimet e personave vinë nga përballja me një kulture tjetër, prandaj, për te pasur një komunikim të mirëkuptueshëm, nevojitet kompetenca ndërkulturore. (Barrett,M. et al. 2014:16)

Kompetencë: Ky term në togun *kompetence ndërkulturore* nuk nënkupton vetëm një sërë aftësish që aplikohen në një kontekst të caktuar, por një kombinim të qëndrimeve, të të kuptuarit, të njohurive dhe të aftësive që përdoren për t'iu përgjigjur në mënyrë të suksesshme situatave të ndryshme që mund të shfaqin sfida, vështirësi ose detyra të caktuara. Duke qenë se situatat mund të jenë nga më të larmishmet, kërkohet pasurim dhe mësim ivazhdueshëm.(Barrett,M. et al. 2014:6)

Gjithashtu edhe një element i rëndësishëm për të përmendur është ‘*Çfarë është një folës ndërkulturor?*’ Autorja House,J. thotë që ‘është një person i cili ka arritur të pozicionet në mes, i cili di dhe mund të performoj në kulturën e tij amtare ashtu edhe në kulturën tjetër’ (House,J., 2007:19). Sa kohë që të ekzistojnë ndryshime gjuhësore kulturore gjithmon do të ekzistojnë folës ndërkulturor.

Siç ka theksuar Deardoff-i, 'kompetenca ndërkulturore është një proces i gjatë; nuk ka ndonjë pikë në të cilën një person arrin të bëhet 'kompetent ndërkulturalisht'(Deardoff: 2009:xiii). Duke qenë një proces i tillë, kërkon kohë dhe praktikë për zotërimin e të gjitha elementeve të nevojshme ndërkulturore. 'Kompetenca ndërkulturore e një individi nuk mund të jetë kurrë e plotë, por gjithmonë mund të pasurohet nga eksperiencia të vazhdueshme, me takime të ndryshme kulturore.' (Barret et al. 2014:7)

Një person që zotëron kompetencat ndërkulturore është i aftë të kuptojë dhe të analizojë biseda që bëhen me individë të kulturave të ndryshme, të respektojë vlerat, besimet e të tjeve, të jetë i aftë për të ndërtuar marrëdhënie dhe të krijojë kontakte të vazhdueshme për të mësuar dhe ndarë përvojë.

Të dish një gjuhë dhe disa informacione faktike mbi kulturën vendit të saj, nuk do të thotë që je kompetent ndërkulturalisht. Në praktikën tonë është tendencë dhënia e njohurive për histori, letërsi, gjuhë, muzikë etj.-produkete të kulturës. Këto elemente mbeten të nevojshme, por jo të mjaftueshme për të zhvilluar kompetencat ndërkulturore. (Deardoff: 2009; xiii)

Në të shkuarën në fokus ka qenë zgjerimi i njohurive për kulturën. Sot, janë zhvilluar disa modele që u japin rëndësi njohurive për kulturën amtare dhe të huaj, kuriozitetit, respektit, aftësive për t'u përshatur etj. Modeli që zhvillon Byram për kompetencën ndërkulturore, përbëhet nga pesë elemente (Byram, 1997:45). Sipas Byram-it, 'një person që zotëron kompetenca ndërkulturore është i aftë të shohë lidhjet midis kulturave të ndryshme, nga aspekti i jashtëm dhe i brendshëm i një shoqërie, është në

gjendje të ndërmjetësorë dhe interpretojë për vete dhe të tjerët; ka një kuptim analitik ose kritik për kulturën e tij dhe të tjerëve, është i ndërgjegjshëm për prespektivën e tij, dhe kupton që mënyra e të menduarit dhe të kuptuarit të tij është e përcaktuar nga konteksti kulturor e jo diçka natyrale.’ (Byram: 2000:8-13)




Figura 1. Kompetenca ndërkulturore sipas Byram

Qëndrimet: Tek qëndrimet futet ‘kurioziteti dhe të qenit mendjehapur, gatishmëria për t’i dhënë fund mosbesimit për kulturat dhe besimi për kulturën tënde’ (Byram, 1997:50). Kjo nënkupton gatishmëri për të rivitalizuar vlerat, besimet dhe sjelljet e një kulture, duke pranuar se ato nuk ekzistojnë vetëm ato forma dhe nuk janë të vetmet mënyra korrekte; të qenit të aftë të shikojnë nga një perspektivë e një të jashtmi i cili respekton një sërë vlerash, besimesh dhe sjelljesh të tjera të ndryshme (Byram, et al. 2002:12). Kjo do të thotë të kesh njohuri mbi kulturën vetjake dhe të tjetrit; të jesh kurioz dhe i hapur ndaj kulturave të ndryshme dhe t’i pranosh ato. Ndër to është shumë e rëndësishme nxitja e kuriozitetit, edhe pse e vështirë për t’u realizuar nga pedagogët. Duke qenë kuriozë, studentët kuptojnë që njerëz të ndryshëm mendojnë dhe veprojnë ndryshe nga ata.

Njohuri: Këtu hyjnë ‘njohuri për grupin social dhe produktet e praktikat e vendit të një personi dhe vendit të bashkëbiseduesit, si edhe për proceset e përgjithshme të shoqërisë dhe ndërveprimit individual’ (Byram, 1997:51). Sipas Byram-it kjo do të thotë të dish si funksionojnë grupet sociale dhe identitetet kulturore, dhe të kuptosh që çdo fjalë, çdo veprim është i lidhur me kontekstin kulturor ku jeton’ (Byram, 2001:6). Njohuria mund të ketë dy përbërës madhorë: njohuri mbi proceset sociale dhe njohuri mbi ilustrimet e këtyre proceseve dhe produkteve. Kjo e fundit përfshin njohurinë mbi mënyrën sesi ka të ngjarë t’ju perceptojnë të tjerët si dhe disa njohuri mbi njerëzit e tjerë. (Byram et al. 2002:12) Pedagogu zgjeron njohuritë jo vetëm për kulturën e vendeve të tjera, po edhe për kulturën amtare. Byram-i thekson, gjithashtu, që pedagogët nuk janë në dijeni për të gjitha njohuritë që u duhen studentëve, prandaj duhet të rritin edhe tek aftësitë e tyre.

Aftësitë interpretuese dhe krahasuese janë ‘afësi për të interpretuar një dokument ose një ngjarje nga një kulturë tjetër, për ta shpjeguar dhe lidhur me dokumente nga kultura përkatëse’ (Byram, 1997:52).

Kjo do të thotë të pozicionohesh në rolin e ndërmjetësuesit, të arrish të identifikosh keqkuptimet që vinë nga ndryshimet kulturore e të jesh në gjendje për t’i shpjeguar, sipas dy kulturave (Byram, 2001:6). Si mund ta realizojmë këtë në klasat tona: Le të imagjinojmë nëse do të kemi për të diskutuar për temën ‘Viti i Ri’. Mund t’i nxisim studentët të krahasojnë mënyrën tradicionale të festimeve të vitit të ri në kulturën tonë me atë në vendet anglishtfolëse. Duke bërë krahasimin, do të reflektojnë edhe për kulturën amtare, dhe ndoshta do të gjejnë gjëra të cilat më parë ata nuk i kishin menduar ose vënë re. Çdo individ kulturën e merr si të mirëqenë dhe, vetëm në momentin kur ka konflikte kulturore ose vihet përballë situatave që janë të ndryshme nga ato që është mësuar, fillon e reflekton edhe mbi

kulturën e tij. Me anë të kësaj metode, studentet mund të zhvillojnë aftësinë interpretuese dhe krahasuese.

Aftësitë e zbulimit dhe ndërveprimit: Këto janë ‘aftësia për të zbuluar njohuri të reja mbi kulturën e praktikat kulturore dhe për t’i zbatuar këto njohuri, qëndrime edhe nën kufizime që na ofron komunikimi dhe ndërveprimi në kohë reale’ (Byram, 1997:52).

Kjo do të thotë të përdoren të gjitha njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet për të komunikuar me individë të kulturave të ndryshme, duke pasur parasysh ngjashmëritë dhe ndryshimet kulturore. Këto aftësi rriten edhe nga vetë studenti, që merr rolin e një hulumtuesi, duke hetuar, vëzhguar e duke mbledhur të dhëna.

Vetëdija kritike kulurore është ‘aftësi për të vlerësuar, në mënyrë kritike dhe mbi kritere të mirëpërcaktuara, perspektivat, praktikat dhe produktet si në kulturën vetjake dhe amtare, ashtu dhe në kulturën e shtetit tjetër’ (Byram, 1997:52). Studentët fillojnë të vlerësojnë kulturën e tyre. Çdo temë që do të diskutohet në klasë do t’i bëjë ata të njohin avantazhet dhe disavantazhet e kulturës së tyre. Byram-i thekson se nuk është synimi të ndryshojmë vlerat e studentëve, por t’i bëjmë të qartë edhe të ndërgjegjshëm.

Një mënyrë e mirë për të ndihmuar studentët të eksplorojnë kulturën e gjuhës së synuar është modeli i propozuar nga Liddicoat. Liddicoat-i e përshkruan zhvillimin e kompetencës ndërkulturore si një cikël (Liddicoat,2001:45). Ai thekson se përvetësimi i një kulture nëpërmjet gjuhës fillon me input. Ky model e ka fokusin kryesor tek procesi i ‘konstatimit’, si një element shumë i rëndësishëm që duhet të zhvillohet nga pedagogët. Studenët nxiten që të konstatojnë karakteristika të komunikimit që janë të panjohura për ata. Liddicoat-i thotë që këto ‘konstatime’ mund të jenë vlerësime negative ose pozitive të

praktikave të reja nga studentët është pikërisht ‘konstatitimi’ që bëhet objekt për reflektim të mëtjeshëm. Pasi studentët kanë konstatuar ndryshimet, diskutojnë rreth këtyre ndryshime duke dhënë edhe reflektimin e tyre në lidhje me këto ndryshime.




Figura 2. Një mënyrë për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore (Liddicoat, 2001:45)

Këtyre pak studimeve që trajtojnë zhvillimin e kompetencave ndërkulturore u shtohet edhe modeli i prezantuar nga Deardorff-i i emëruar ‘*Piramida Model i Kompetencave Ndërkulturore*’. i cili u realizua me anë të ‘*teknikës Delphi*’, (‘*Teknika Delphi*’ është një teknik gjerësisht e përdorur dhe e pranuar për mbledhjen e të dhënave nga përgjigjet e panelit të ekspertëve) duke marrë miratimin e ekspertëve (Deardorff, 2006:253). Ky model tregon të gjitha hapat, për të arritur ato që i quan ‘rezultate të dëshirueshme’.

Në bazën e piramidës janë ‘*qëndrimet e kërkuara*’, të cilat arrihen nga individi, duke përdorur elemente si respekti, të qenit i hapur, kurioziteti.

Më pas kalohet në një stad ndërveprues, ‘*njohuri*’ dhe ‘*aftësi*’, në të cilin rriten njohuritë e nevojshme për kulturën e synuar e kulturën amtare dhe zhvillohen aftësitë sociolinugistike.

‘Rezultat i dëshirueshëm i brendshëm’, u referohet aftësive të individit për t’u përshtatur.

Në majën e piramidës është *‘Rezultat i dëshirueshëm i jashtëm’*, që lidhet me të gjitha qëndrimet, sjelljet, njohuritë që i duhen një individ për të komunikuar në mënyrë efektive. Duke ndjekur këtë piramidë, një individ mund të arrijë të bëhet kompetent ndërkulturalisht.




Figura 3. Piramida e Kompetencës Ndërkulturore, (Deardorff, 2009:13)

Pas modelit të Piramidës, Deardorff-i trajton, nga një pikëpamje tjetër, një model të dytë, në formën e një cikli, ‘*The Process Model of Intercultural Competence*’ (Deardorff,2009). Ky model i zhvillimit përqendrohet në rezultatet e jashtme dhe të brendshme të kompetencave ndërkulturore. Deardorff-i thekson se ‘zhvillimi i kompetencës ndërkulturore është një proces i vazhdueshëm, dhe, për këtë arsye, është e rëndësishme që individët të kenë mundësinë për të reflektuar dhe vlerësuar këtë zhvillim. (Deardorff, 2009:476).

Në modelin e paraqitur, qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë bashkëveprojnë, për rezultatet e jashtme dhe të brendshme. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore fillon me qëndrimet, ashtu siç është sugjeruar edhe nga Byram-i (1997). Rezultatet e jashtme janë ato që sjellin ndryshime, duke çuar në rifillimin e ciklit sërish. Deardorff-i thekson rëndësinë që merr në këtë proces të menduarit kritik (aftësia për të vlerësuar dhe përvetësuar njohuri) (Deardorff, 2009:476).




Figura 4. Procesi i zhvillimit të kompetencës ndërkulturore Deardorff (2006)

Për vlerësimin e kompetencave ndërkulturore Deardorff-i rekomandon të kenë pëparësi disa aspekte specifike duke vënë në dukje që vlerësimi i tyre nuk mund të behët vetëm nga një individ (Deardorff, 2009:483). Liddacoat-i thekson se kompetenca ndërkulturore presupozon të jesh i ndërgjegjshëm që kultura është relative. (Liddacoat, 2001:54)

Bennett-i nënvizon se kompetenca ndërkulturore është një bashkësi konjitive, emocionale, aftësish komunikative dhe karakteristikash, që mbështetin ndërveprimin e duhur efektiv, në një shumëllojshmëri të kontekstit kulturor. Konjitive përbëhet nga: vetëdija kulturore, njohuri specifike kulturore, njohuri të përgjithshme kulturore, analiza e ndërveprimit. Emocionale përbëhet nga kurioziteti, fleksibiliteti konjitiv, motivimi, të qënurit mendjehapur. Aftësitë komunikative përbëhet nga aftësitë për të ndërtuar marrëdhënie, aftësitë komunikative: dëgjimi, zgjidhja e problemeve, empatia, aftësitë për të mbledhur informacion (Bennett, 2011:3) .

Ndërsa autori Neuner (2012) thotë që kompetenca ndërkulturore mund të klasifikohet në tre dimensione: dimensionin konjitiv (njohurit): të mësosh të dish; dimensionin emocional (qëndrimet/ vlerat) të mësosh të jesh; dimensionin pragmatik (aftësitë) të mësosh të bësh (Neuner, 2012:35)

Dimensioni konjitiv- të mësosh të dish

‘Të mësosh të dish’ në aspektin e edukimit ndërkulturore përfshin më shumë se njohuri për vendet dhe kulturat e tjera që mësohen në lëndë të ndryshme shkollore (prsh. gjeografi, histori dhe gjuhë). Nga prespektiva e edukimit ndërkulturore i gjithë informacioni që na ndihmon për të kuptuar dhe vlerësuar njëri-tjetër në një mjedis multikulturore është po aq i rëndësishëm sa cdo gjë tradicionale që ofrojnë lëndët shkollore. Ndërsa, dimensionin konjitiv përfshin njohuri faktike për të gjithë aspektet e ndryshme (vlerat dhe normat, kultura me ‘C’ e madhe) si dhe rutinën e përditshme dhe ritualet (kultura me ‘C’ të vogël), gjithashtu përfshin njohuri strategjike se si të negociojë takime ndërkulturore në klasë (vetë-përfaqësim, që kanë të bëjnë

me keqkuptime dhe keqinterpretime, që kanë të bëjnë me konfliktet, të mësuarit për të bashkëpunuar etj.) (Neuner, 2012:35)

Dimensioni emocional – të mësosh të jesh

Edukimi ndërkulturor duhet të mbështes nxënësit në zhvillimin e vetëdijës dhe vlerësimit të përkatësisë së tyre kulturore, si dhe respektin dhe tolerancën për të tjerët. Kjo duhet të bazohet në të drejtën për të qenë të ndryshëm. (Neuner, 2012:35)

Dimensioni pragmatik – të mësosh të bësh

‘Të mësosh të bësh’ në edukim ndërkulturor do të thotë të mësosh për të zbatuar njohuri faktike dhe strategjike aty ku pyetjet ndërkulturore janë për tu negociuar dhe ku detyrat duhet të zgjidhen me bashkëpunim. (Neuner, 2012:35)

Autorët Sinicrope, Norris & Watanabe paraqesin përjasjen e Ruben (1976), ai mbron teorinë e sjelljeve për të lidhur hendekun midis të ditur dhe të bërit, pra ndërmjet atë çfarë individët dinë rreth të qenurit kompetent ndërkulturalisht dhe atë se çfarë aktualisht bëjnë këto individë në situata ndërkulturore. Ruben teorizoi që duke vëzhguar individët në situata të ngjashme me ato për të cilat ata janë duke u trajnuar ose përzgjedhur do të japin informacion për parashikimin e performancës së tyre në situata të ngjashme në të ardhmen. Ruben (1976) identifikon shtatë dimensione të kompetencës ndërkulturore: (Sinicrope, Norris & Watanabe, 2007:3-4)

1. *Shfaqja e respektit* e cila i referohet aftësive të një individi për të ‘shfaqur respekt dhe konsiderim pozitiv’ për individët e tjerë.
2. *Postura e ndërveprimit* që i referohet aftësive të individit për t’ju ‘përgjigjur të tjerëve në një mënyrë përshkruese, jo vlerësues dhe jo gjykuese’
3. *Orientim drejt njohurive* ‘përshkuan aftësitë e një individi për të ‘njohur shtrirjen në të cilën njohuritë janë individuale në natyrë.’ Me fjalë të tjera, orientimi drejt njohurive përshkruajnë aftësitë e një individi për të njohur dhe pranuar që njerëzit e shpjegojnë botën rreth tyre në mënyra të ndryshme, me këndvështrime të ndryshme se çfarë është e ‘drejtë’ apo e ‘e gabuar’.
4. *Empatia* - aftësitë e një individi për të vendosur veten në vend të tjetërit (put himself in another’s shoes)
5. *Sjellje të vetë-orientuara* – janë aftësitë e një individi për të ‘qenë fleksibël dhe të veprojë në (fillimin dhe harmonizimin) e roleve.’ Me fjalë të tjera, fillimi i referohet kërkimit të informacionit dhe sqarimeve dhe vlerësimit të ideve për zgjidhjen e problemeve. Harmonizimi, nga ana tjetër i referohet rregullimit të status quo të grupit nëpërmjet ndërmjetësimit.

6. *Menaxhim i ndërveprimit* – aftësia e një individi për të bashkëbiseduar në diskutim dhe për të filluar dhe mbaruar ndërveprimin bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të saktë të nevojave dhe dëshirave të tjerëve.

7. *Toleranca për ambiguitet* përshkruan aftësitë e një individ për 'të reaguuar ndaj situatave të reja me sa pak siklet të mundshëm. (Ruben, 1976, pp.339-341, Cit. Sinicrope, Norris, Watanabe, 2007:3-4)

Sipas Emert, H.A (2008:13-15), disa karatersitika që përbëjnë kompetencën ndërkulturore janë: efektshmëri, përshtatshmëri dhe motivim, njohuri, qëndrime , sjellje dhe aftësi.

Efektshmëria ka të bëjë me faktin që individët mund të realizojnë qëllimet e tyre (Wiseman,2002, Cit. Emert,H.A 2008).

Përshtatshmëria presupozon që komunikimi të zhvillohet mbi bazën e kontekstit dhe pasqyron normat e pritshme siç përcaktohen nga të brendshmit kulturorë (Ting-Toomez,1999, Cit. Emert,H.A, 2008)

Motivimi Nëse një individ nuk është i motivuar për të komunikuar, atëherë nuk ndjen nevojë të përgatitet ndërkulturalisht.

Njohuritë Janë informacione njohëse që një i huaj merr në situata ndërkulturore, p.sh. njohuri për veten dhe të tjerët dhe informacione të tjera, për t'i përdorur gjatë ndërveprimit (Bennett& Bennett, 2004; Wiseman, 2002, Cit. Emert,H.A,2008).

Qëndrimet përfshijnë emocionet dhe synimet e komunikimit, si empati dhe tolerancë.

Sjelljet dhe aftësitë lidhen me veprime që sigurojnë sukses në takimet ndërkulturore. (Emert, H.A, 2008:13-15)

Fondacioni Bertelsmann Stiftung(2006) ka qenë gjithmonë i përfshirë në projekte që merren me nxitjen e tolerancës e të dialogut kulturor në Evropë dhe vende të tjera. Një nga

temat më të rëndësishme, ku është angazhuar, është pikërisht ajo e kompetencës ndërkulturore. Ky fondacion nisi një cikël diskutimesh rreth saj, duke paraqitur disa teza që ndihmojnë për realizimin e programeve edukative me interes global.

Më poshtë janë paraqiten 13 tezat sipas *Fondacionit Bertelsmann Stiftung* (Fondacionit Bertelsmann Stiftung, 2006:3-13):

Teza 1 - ëshë e rëndësishme të jesh i aftë për të përballuar në mënyrë konstruktive diversitetin kulturor në rritje.

Mundësitë e kontakteve me kultura e besime të tjera janë në rritje. Si rezultat i këtyre kontakteve, kërkohet aftësi për të përballuar në mënyrë konstruktive diversitetet kulturore. Sigurisht që nuk mund të eliminohen apo shmangen konfliktet midis individëve dhe grupeve plotësisht (kur bëhet fjalë kur ato janë të pashmangshme) por mund ti perceptojnë dhe përballojnë më mënyrë konstruktive.

Teza 2 - Përkufizimi i kompetencës ndërkulturore

Jepet ky përkufizim: ‘Kompetenca ndërkulturore është aftësia për të ndërvepruar në mënyrë të duhur efektive në situata ndërkulturore, duke u bazuar në qëndrime specifike, njohuri ndërkulturore, aftësi dhe reflektim’.

Teza 3 - Pa një kuadër socio-politik nuk ka kompetenca ndërkulturore

Vërtet kompetenca ndërkulturore përdoret në kontakte ndërmjet dy individëve, por nuk duhet harruar që këta persona janë pjesë e kulturave dhe sistemeve përkatëse. Janë

pikërisht politikat sociale që krijojnë një kuadër të favorshëm për kompetencën ndërkulturore, duke mos mbështetur idenë për një grup kulturalisht homogjen.

Teza 4 - Kompetenca ndërkulturore bazohet në një përkufizim të kulturës si një proces i orientuar

Kompetenca ndërkulturore lidhet drejtpërdrejt me botën reale ku jetojmë, që e kemi krijuar dhe e rikrijomë çdo ditë. Rrjedhimisht, zgjerohet edhe kultura brenda këtij konteksti të ndërveprimit njerëzor. Globalizimi ka bërë që kultura të mos jetë më si diçka statike, por një produkt i një radhe procesesh, ku bashkëveprojnë norma, vlera dhe stile të jetesës.

Teza 5 - Kompetenca ndërkulturore zhvillohet në mënyrë dinamike

Kompetenca ndërkulturore nuk është as statike dhe as rezultatet direkt të një eksperience bazuar nga përvoja. Kompetenca ndërkulturore jo domosdoshmërisht përvetësohet nëpërmjet vizitave në vendin e huaj. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore është një proces dinamik (Deardorff, 2006). Si rrjedhojë, dhe përvetësimi i kompetencës ndërkulturore është një proces dinamik që pasurohet vazhdimisht, në formën e një spiraleje. Ky proces përfshin 4 dimensione: qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë ndërkulturore, aftësitë për të reflektuar dhe aftësitë për ndërvepruar në mënyrë konstruktive.

Teza 6 - Rezultatet e jashtme: Ndërveprim konstruktiv - Arritja e objektivave të vlerësuar dhe shmangja e shkeljes së rregullave kulturore

Siç kuptohet në këto teza kompetenca ndërkulturore con në ndërveprim të atyre që marrin pjesë në situata ndërkulturore që është efektiv dhe i duhur, gjithashtu edhe

konstruktiv. Për të patur një komunikim të përshtatshëm, rregullat themelore të kulturës së pjesëmarrësve nuk duhen shkelur. Kjo çon në një komunikim efektiv, ku personat pjesëmarrës arrijnë objektivat e tyre.

Teza 7 - Qëndrimet – Vlerësimi i diversitetit kulturor dhe tolerimi i ambiguitetit

Një pikë e rëndësishme për të përvetësuar kompetencës ndërkulturore është qëndrimi pozitiv drejt situatave ndërkulturore. Qëndrimi është po aq i rëndësishëm sa dhe përmbajtja kulturore që duhet mësuar, pasi nuk lejon krijimin e pasigurive dhe konflikteve. Prandaj është e rëndësishme që pjesëmarrësit të jenë të hapur e pozitivë dhe tolerant ndaj situatave të panjohura ndërkulturore.

Teza 8 - Njohuri dhe aftësi ndërkulturore – Njohuri kulturore gjithëpërfshirëse, aftësi komunikimi dhe menaxhimi të konflikteve

Njohuritë gjithëpërfshirëse mbi kulturën janë shumë të rëndësishme për ndërveprim. Kompetenca ndërkulturore përfshin ‘të dish atë’ dhe ‘të dish si’. Elemente themelore të tyre janë: kuptimi i këndvështrimit, vlerave, normave dhe gjithcka mbi jetën të tjerëve; kuptimi i rolit dhe impaktit të elementeve të kulturës në sjellje dhe komunikim; kuptimi i kontekstit historik, politik dhe fetar; ndërgjegjja sociolinguistike si marrëdhënie midis gjuhës dhe kontekstit social. Një aspekt tjetër qendror është menaxhimi i diferencave dhe zgjidhjes së konflikteve.

Teza 9 - Rezultate të jashtme: Reflektimi ndërkulturor – rivitalizimi i kuadrit të referencave dhe aftësia për të ndier empati

Një tipar tjetër i nevojshëm është aftësia për të ndryshuar perspektivën, përshtatja në situata të reja kulturore, pranimi i elementeve të reja, dhe reduktimi i frikës ndaj së panjohurës. Kërkon që individi të përshtatet në mënyrë fleksibel situatave të reja ndërkulturore. Kjo do të thotë më pak fjalë botëvështirimi i një individ për kulturën dhe mënyrën jetës nuk është absolute por reflektohet mbi ato. Këto janë disa nga kriteret për zhvillimin e empatisë.

Teza 10 - Kompetenca ndërkulturore kërkon arsim të integruar

Duke qenë se kompetenca ndërkulturore nuk mund të ofrohet vetëm nga një lëndë, kërkon jo vetëm mësimin e gjuhës sipas kurrikulave tradicionale, por edhe bashkëveprimin e integruar të formave të ndryshme të të mësuarit dhe në nivel të ndryshme.

Teza 11 - Kompetenca ndërkulturore kërkon vlerësimin formativ (një proces i vazhdueshëm)

Nga çfarë u paraqit deri këtu, krijimi i një instrumenti që përdor një sërë indikatorësh për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të kompetencës ndërkulturore, duket si diçka e mundur.

Teza 12 - Një kuptim global i kompetencës ndërkulturore akoma nuk ekziston

Orgjina dhe natyra e kompetencës ndërkulturore është parë vetëm nga një perspektivë perëndimore, përfshirja edhe një perspektive aziatike do të çonte në përkufizime të reja të kompetencës ndërkulturore.

Teza 13 - Nga kompetenca ndërkulturore tek kompetenca globale kulturore

Kompetenca ndërkulturore ka limitet e veta, duke qenë se në thelb të saj ajo kërkon një relativitet etnik, por nuk gjeneron një set vlerash të përbashkëta, që mund të ndihmojnë ndërveprimin midis pjesëmarrësve. Një çështje për diskutim është që shoqëria jonë globale ka nevojë të bashkohet rreth disa vlerave të përbashkëta që mund të shërbejnë për ekzistencën e saj. A mund të jetë e realizueshme një kompetence globale kulturore?

Navaitiene et al. (2013) shprehen që teori të ndryshme dhe modele të kompetencave ndërkulturore bazohen në këto pesë elemente kryesore që janë: motivimi (emocional), njohurit (konjitive), aftësit (sjellet), konteksti (situata, mjedisi, kultura, marrëdhënia, funksionet) dhe përfundimet (të përshtatshëm dhe efektiv, të kuptuarit). Duke pasur parasysh rëndësinë e aspekteve të ndryshme të kompetencës ndërkulturore paraqesin modelin e Spitzberg & Changnon (2009) ku kanë klasifikuar të gjitha modelet e ndryshme të kompetencës ndërkulturore të propozuar nga autorë të ndryshëm në pesë kategori të shpjeguar më me detaje si më poshtë (kompozicional, bashkë-orientues, zhvillimit, i përshtatshëm dhe proces i shkakor) (Cit. Navaitiene et al. 2013:24-25)

1. *Modelet kompozicional*, këto modele identifikojnë komponentët e kompetencës ndërkulturore por pa u përpjekur të zbulojnë lidhjen midis këtyre elementeve përberësve. Elementet kryesore janë qëndrimet, aftësitë dhe njohurit të gjitha sëbashku përbëjnë kompetencën ndërkulturore. Autorët kanë klasifikuar në modelin kompozicional këto modele : *Intercultural competence components model* (Hamilton et al, 1998); *Facework-based model of intercultural competence* (Ting-Tomey & Kurogi, 1998); *Pyramid model of intercultural competence* (Deardorff, 2006; 2009) (Cit. Navaitiene et al. 2013:24)

2. *Modelet bashkë-orientues*, këto modele fokusohen sesi zhvillohet komunikimi brenda ndërveprimit ndërkulturore. Këto modele janë të dobishëm për zgjidhjen e problemit të ndërveprimit, diferencat/ndryshimet dhe paqartësisë në të kuptuar. Deardorff shprehet që këto modele mund të mbartin shumë karaktersita të modeleve të tjera por janë më shumë të fokusuar në një kriter të vecantë të reciprocitet komunikues dhe kuptimet e përbashkëta. (Deardorff, 2009:10) Modelet që mund të kategorizohen në këto model janë : *Intercultural interlocutor competence model* (Fantini, 1995); *Intercultural competence model* (Byram, 1997; 2003); *Intercultural competence model for strategic human resource management* (Kupka, 2008); *Coherence-cohesion model of intercultural competence* (Rathje;2007) (Cit. Navaitiene et al. 2013:24)

3. *Modelet e zhvillimit*, këto modele përshkruajnë të gjitha hapat për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore gjatë gjithë kohës dhe i kushtojnë një vëmendje të vecante procesit të të nxënimit gjatë këtyre fazave. Pra, me pak fjalë këto modele fokusohet tek fazat në të cilën një individ kalon gjatë zotërimit të kompetencave ndërkulturore. Modelet që futen në këtë kategori janë: *Intercultural maturity model* (King & Baxter Magolda, 2005; *Developmental intercultural competence model* (Bennett, 1986); *U-Curve model of intercultural adjustment* (Gullahorn & Gullahorn, 1992) (Cit. Navaitiene et al. 2013:25)

4. *Modelet e përshtatshmërisë*, fokusohen tek qëndrimeve, të kuptuarit dhe sjelljeve gjatë ndërveprimit me anëtarë të kulturave të ndryshme. Këto modele fokusohen sesi individët përshtaten në takime ndërkulturore. Përshtatshmëria paraqitet si një kriter i rëndësishëm për kompetencën ndërkulturore. Këto modele janë të dobishme për të përcaktuar nivelin e përshtatshmërisë. Modelet që mund të futen në këtë kategori janë: *Intercultural*

communicative competence model (Kim, 1988); *Intercultural communicative accommodation model* (Gallois et al., 1988); *Attitude acculturation model* (Berry et al., 1989); *Relative acculturation extended model* (Navas et al., 2005; 2007) (Cit. Navaitiene et al. 2013:25)

5. *Modelet e procesit shkakor*, janë të fokusuar që të gjejnë lidhjen shkakore midis komponenteve të ndryshëm të dimensionit ndërkulturor. Kompetencën ndërkulturore në këto modele paraqitet si një sistem linear që merret me variablat, që ndikojnë dhe/ose ndikojnë variablat e tjera. Modelet që mund të karakterizohen në këtë kategori janë: *Anxiety/Uncertainty management model of intercultural competence* (Hammer et al., 1998); *Relational model of intercultural competence* (Imahori & Lanigan, 1989); *Multilevel process change model of intercultural competence* (Ting-Toomez, 1999); *Intercultural communication model of relationship quality* (Griffith & Harvey (2000); *Process model of intercultural competence* (Deardorff, 2006); *Model of intercultural communication competence* (Aratsaratnam, 2008) (Cit. Navaitiene et al. 2013:25)

1.2. Kuptimi i dimensionit ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj

'Mbijetesa jonë nuk ka kërkuar kurrë një bashkëpunim kaq të madh dhe mirëkuptim midis të gjithë njerëzve nga të gjitha vendet sa në këtë moment të historisë...kur ne hapim zemrat dhe mendjen ndaj atyre që nuk mendojnë e besojnë si ne - pikërisht këtu ne zbulojmë të paktën mundësinë e të pasurit besim, vlera dhe aspekte të tjera të përbashkëta.'

Barack Obama

Dimensioni ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj është bërë një çështje e rëndësishme për pedagogët ashtu edhe për kërkuesit shkencorë në fushën e gjuhëve të huaja. Mësimi i gjuhës së huaj gjithmonë ka qënë i fokusuar në përmisimin e metodave të

mësimi të kompetencave gjuhësore. Tashmë me rritjen e kontakteve ndërkulturore, ngrihet çështja për rëndësinë e dimensionit ndërkulturor, duke vënë në pikëpyetje cili është qëllimi kryesor i mësimi të gjuhës së huaj. Të mësoh gjuhën e huaj duke pasur parasysh aspektin ndërkulturor i ndihmon studentët të përvetësojnë kompetencat gjuhësore për të komunikuar si dhe kompetencat ndërkulturore. Michael Byram, Profesor në Universitetin 'Emeritus at Durham University' në Mbretërinë e Bashkuar ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për të rritur ndërgjegjësim në lidhje me rëndësinë që ka dimensionit ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj. Dimensionit ndërkulturor është i shmangur nga shumë akademike, duke hequr kështu një pjesë shumë të rëndësishme dhe jetike në botën që po jetojmë sot. Byram et al. shprehet që shqetësimet në lidhje me dimensionin kulturor nuk është ndonjë çështje e re. Ajo është e përmendur në historinë e *Landeskunde* në gjermani dhe në *civilizimi* në France. (Byram, et al.1998:2) Sipas Holmes politikat e të mësuarit të gjuhës dhe kurrikulat e mësimi të përfshijnë dimensionin ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj, por ti zbatosh këto në klasat e gjuhëve të huaja, nuk është e lehtë për mësuesit e gjuhëve të huaj (Holmes, 2014:76). Sipas Byram, Gribkova & Starkey deklarojnë që 'dimensionit ndërkulturor' në mësimin e gjuhës së huaj ka si synim të aftësoj studentin si folës ndërkulturor ose ndërmjetës që janë të aftë si identitetet komplekse dhe të shmangin stereotipizimet që e shoqëron një njëri kur perceptohet përmes një identiteti të vetëm (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:9). Komunikimet në të cilën nuk kanë njohuri për elementët kulturor të gjuhës së synuar con në keqkuptime dhe mosmarrëveshje. Kompetenca ndërkulturore nuk është e lidhur vetëm me mësimin e gjuhës së huaj, por është pjesë e jetës së përditshme dhe ndikon në çdo fushë. Doktorët, biznesmenët, politikanët, diplomatët, studentët, çdokush që hyn në kontakt me individë të kulturave të tjera duhet të zotërojë kompetencat

ndërkulturore. Bennett, M.J në artikullin *'The intercultural development research institute'* shprehet që liderët e sofistikuar janë nënpunës të aftë për t'ju përshtatur gamës së gjerë kulturore të klientit. Kompetenca ndërkulturore nuk zhvillohet nga një lëndë akademike e vetme, por nga të gjitha lëndët akademike së bashku, ndër këto është edhe gjuha e huaj. Fantini thotë që nëse mësuesit e gjuhëve të huaja dhe atyre në fushën ndërkulturore do të kishin një qëllim të përbashkët, ai do të ishte zhvillimi i kompetencave komunikative ndërkulturore ose shkurt zhvillimi i kompetencave ndërkulturore (Fantini, 1995:4). Autori shprehet që ndërkulturalistët kanë tendencë që t'ja lejnë mësuesve të gjuhëve të huaja zhvillimin e kompetencave gjuhësore, gjithashtu mësuesit e gjuhëve të huaja kanë tendencë që t'ja lejnë ndërkulturalistëve detyrat e zhvillimit të aftësive ndërkulturore, pavarësisht faktit që të dyja palët janë në dijeni që gjuha dhe kultura janë ndërlidhura me njëra-tjetrën. Fantini përmend tre temat kryesore të kompetencës ndërkulturore: aftësia për të krijuar marrëdhënie; aftësia për të komunikuar me humbje minimale ose shtrëmbime; aftësia për të arritur një nivel pajtueshmëri me ata që janë të përfshirë. (Fantini, 1995:3)

Autorët shprehet që këto aftësi janë të dëshirueshme, të mos themi të nevojshme për çdo person në çdo vend. Ai thotë që këto aftësi jo vetëm janë pjesë e 'marrëdhënies ndërkulturore' por edhe pjesë e ngushtë e 'marrëdhënies ndërpersonale', ajo çfarë e komplikon çështjen në nivel kulturor, është se kur ndërveprojmë me individ në kultura të ndryshme, ne ndajmë gjithnjë e më pak të përbashkëta ndërsa variabelt e tjera rriten. Ashtu siç shprehet autori më të dukshme janë variabelt që paraqesin ndryshime në gjuhë, kulturë, dhe botëkuptimin që ndërmjetëson ndërveprimin tonë (Fantini, 1995:3-4).

Ndërpresonal  Ndërkulturore

-Variablet +

Të gjithë neve pa përjashtimi mund të na ketë ndodhur të zhvillojmë dialog me individë të kulturave dhe përkatësive të ndryshme. Kur zhvillohet një dialog mes individësh që u përkasin kulturave të ndryshme, të kuptuarit varet nga formimi kulturor që ka secili. Mënyra sesi perceptohet mesazhi shpesh herë sjell keqkuptime. Stringer & Cassiday thojnë që keqkuptimet mund të ndodhin kur flasim një gjuhë të huaj, edhe njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë mund të përjetojnë keqkuptime pasi një fjalë mund të ketë kuptime të ndryshme. Autorët paraqesin kuptimin e fjalës ‘pop’ në të cilën në pjesën perëndimore të Shteteve të bashkuar ka kuptimin e një pije me gaz, ndërsa në pjesën lindore i referohet përdorimit të drogës. (Stringer & Cassiday, 2009:10) Kur njerëzit flasin me njëri-tjetrin identiteti i tyre social është pjesë e pashmangshme e këtij ndërveprimi (Byram, Gribkova dhe Starkey, 2002:9). Me anë të kompetencës ndërkulturore synohet të përgatiten folës ndërkulturore, që të jenë të aftë për të komunikuar me njerëz me identitete të ndryshme kulturore (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:9). Dimensioni ndërkulturore kërkon pedagogë të aftë, që t’i përgatisin studentët për të përvetësuar *kompetencat linguistike* (aftësia për të përdorur gjuhën e huaj sipas rregullave të saj) dhe kompetencat *ndërkulturore* (aftësinë për të komunikuar me individë të ndryshëm si nga ana gjuhësore ashtu edhe ajo kulturore) (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:10). Nëpërmjet dimensionit ndërkulturore të mësimi, studentët mësojnë: se si ndodh ndërveprimi ndërkulturore; se si identitetet sociale janë pjesë e ndërveprimit të përgjithshëm; se si perceptimi i tyre dhe i njerëzve të tjerë ndikon në

komunikim; sesi gjejnë më shumë informacion për njerëz, me të cilët komunikojnë (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:15).

Me fjalë të tjera mësimi i gjuhës brenda dimensionit ndërkulturor, jo vetëm që synon të ndihmoj studentë në zhvillimin e kompetencës gjuhësore, pra aftësit për të folur, shkruar, lexuar në formën e duhur dhe korrekte por gjithashtu ndihmon studentët të zhvillojnë kompetencën ndërkulturor pra mësojnë sesi ndodh ndërveprimi ndërkulturor, kuptojnë që perceptimet që ata kanë, këndvështrimet që ata kanë ndikojnë në komunikim, dhe pedagogu si ndërmjetës në këtë proces ndihmon në lehtësimin e procedurave. Pedagogu luan një rol thelbësor në ndërtimin e koncepteve, ideve të studenteve.

Dimension ndërkulturor përfshinë ndarjen e njohurive me njëri-tjetër dhe diskutim i mendimeve të tyre. Duhet të jenë rregulla të rëna dakord për të tilla diskutime bazuar në kuptimin e të drejtave të njeriut dhe respektin për të tjerë. Studentët mësojnë si nga vetja ashtu edhe nga të tjerë, duke krahasur kontekstin e tyre kulturor me kontekstin e panjohur (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:26).

Bennett-i thekson se duhet të dimë këto gjera për kompetencën ndërkulturore: njohuritë kulturore jo domosdoshmërisht çojnë në zhvillimin e kompetencave; kontakti kulturor jo domosdoshmërisht çon në zhvillimin e kompetencave; kontakti kulturor mund të çojë në reduktimin e stereotipizimit; mësimi i gjuhës mund të mos jetë i mjaftueshëm për mësimin e kulturës. Autori thotë që së pari duhet të dijm se çfarë çon në zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Sipas autorit duhet pasur parasysh:

-Hartimi i programeve me një synim të caktuar dhe me sekuenca të njëpasnjëshme zhvillimore.

- Balancimi i sfidave dhe suportit, ulje e ankthit.
- Lehtësimi i procedurave të nxënies përpara, gjatë dhe pas eksperiencës ndërkulturore
- Thellimi i eksperiencës ndërkulturore, shkrirje e gjuhës
- Trajnimi për kompetencat ndërkulturore
- Kultivimi i kuriozitetit dhe fleksibilitetit njohës. (Bennet,J., 2011:5)

Scarino & Liddicoat vënë në dukje se kultura është e rëndësishme për të lehtësuar komunikimin midis njerëzve. Kështu në një klasë të gjuhës së huaj studentët nuk zhvillojnë thjesht njohuritë e tyre për një kulturë tjetër, por kuptojnë veten e tyre në marrëdhënie me atë kulturë. Ka dhe një mënyrë tjetër për të menduar për kulturën në mësimdhënien e gjuhës së huaj: dallimi midis prespektivës kulturore dhe prespektivës ndërkulturore. Ky pol 'kulturor' përfshin përvetësimin e njohurive për një kulturë që është e jashtme për studentin dhe nuk ka si qëllim të transformojë identitetin, praktikën, vlerat, qëndrimet, besimet dhe pikëpamjet aktuale të tij. Poli 'ndërkulturor' nënkupton përfshirjen transformuese të studentit në procesin e të mësuarit. (Scarino et al., 2009:27) Byram shprehet që nëse kultura futet në procesin e mësimin të gjuhës së huaj, atëherë duhet të planifikohet me detaje ashtu siç i është kushtuar vëmendje të veçantë elementeve të tjerë të gjuhës (Byram, 2008:86). Byram, Gribkova dhe Starkey shprehen që të zhvillosh dimension ndërkulturor në mësimin e gjuhës së huaj do të thotë të përfshish këto qëllime: t'i ofrosh studenteve si kompetencën ndërkulturore ashtu edhe atë gjuhësore; t'i përgatitësh për ndërveprim me njerëz që i përkasin kulturave të tjera; t'i aftësosh të pranojnë dhe të kuptojnë njerëz nga kultura të tjera si individë me prespektiva, vlera dhe sjellje të ndryshme; dhe t'i ndihmojnë të kuptojnë që ky ndërveprim ndikon në zgjerimin e eksperiencave. (Byram, Gribkova dhe Starkey, 2002:10)

1.3. Rëndësia e kulturës në mësimin e gjuhës së huaj

‘Ne duhet të mësojmë të jetojmë së bashku si vëllezër, ose do të vdesim së bashku si budallenj’ – Martin Luter King

Të jetojmë së bashku do të thotë të jemi në kontakt dhe ndërveprim me individë të kulturave të ndryshme. Mund të gjejmë me qindra përkufizime të kulturës, çka dëshmon se është e vështirë të japim një përkufizim të saktë të saj. Kultra mund të interpretohet në mënyra të ndryshme nga individë të ndryshëm. Kultura u referohet vlerave, besimit, qëndrimeve etj. të një grupi të caktuar njerëzish. Siç shprehet Jackson. J kultura mund të na dalloj nga të tjerë nga një serë mënyrash si prsh. vendodhja gjeografike, gjuha, raca, orientimi seksual, feja ose përkatësia politike, veshja, ushqimi e kështu me rallë (Jackson,J., 2014:61). UNESCO e përkufizon kulturën si ‘e gjithë bashkësia e shenjave në të cilën anëtarët e një shoqërie të caktuar njohin njëri-tjetrin duke i dalluar ata nga njerëzit që nuk i përkasin asaj shoqërie’ gjithashtu një përkufizim tjetër që jepet po këtu ‘Përcaktimi i karakteristikave të ndryshme shpirtërore, materiale, intelektuale dhe karaktersikat emocionale të një shoqërie ose grupi shoqëror(që përfshin) përvec art dhe letërsi, jetese, mënyrat e të jetuarit së bashku, sistemet e vlerave, traditave dhe besimet (UNESCO, 2007:12). Kulturë është një element i rëndësishëm për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Përdorimi i gjuhës në kontekstin e duhur social dhe kulturor është një detyrim. (Byram, Gribkova & Starkey, 2002:7).

Martin, N.J. et al. e përkufizon kulturën si ‘modele të mësuara të preceptimit, vlerave, sjelljeve të ndara nga një grup njerëzish, që është gjithashtu dinamik dhe heterogjen. Kultura përfshin edhe emocionet dhe ndjenjat tona’(Martin, N.J. et al, 2008:45) Çdo individ ku jeton, mësohet të shohë botën sipas mjedisit ku jeton, vlerave

dhe perceptimeve që ka mësuar. Lungren-i thekson se të qenit kompetent ndërkulturalisht është unik për çdo individ dhe zhvillohet në ndërveprimin me individët dhe në vetëreflektimin e individit (Lundgren, 2009:137). Shumë autorë e ndajnë kulturën në dy elemente: të padukshme dhe dukshme. Këtë ndarje e ndeshim në modelin ajsberg të kulturës, bazuar në Brembeck 1997, ku bëhet krahasimi i kulturës së dukshme (gjuha, ushqimi, etj.) dhe kulturës së padukshme (vlera, perceptime, qëndrime etj.) (Cituar nga Lazar, 2007:7). Ky model përqëndrohet te fakti që disa elemente janë të dukshme, ndërsa disa janë shumë të vështirë për t'u zbuluar. Pra, vetëm një pjesë e vogël mund të shihet sipër ajsbergut, ndërsa pjesa tjetër është nën ujë dhe është pikërisht kjo pjesa nën ujë që është baza kryesore. (Council of Europe and European Commission, T-kit no 4, 2000:20) Ideja e modelit të ajsbergut është të tregojë sesa e vështirë është të kuptosh individët që u përkasin kulturave të ndryshme, pasi gjithmonë na tërheq pjesa e dukshme e tyre. Brian Street thotë se 'Kultura është një folje...'Nuk ka rëndësi të përpiqemi të gjejmë përkufizimin se çfarë është kultura, por të themi se çfarë bën kultura'(Cit. Graddol, D et al., 1993:24). Këndvështrimi i tij bazohet në atë çfarë bëjnë njerëzit dhe çfarë shohim ne duke bërë.

Në ditët e sotme, si rezultat i globalizimit dhe lëvizjes së njerëzve nga njëri vend në tjetrin, për arsye nga më të ndryshmet, si punë, shkolle etj., bëhet i mundur kontakti me individë të kulturave të ndryshme. Ky zhvillim i ri në botë shkakton largimin e individëve (fizik\pskikologjik) nga mjedisi mëmë (mjedis i rahatshëm) dhe i detyron të përballen me ndryshime kulturore (Glaser et al., 2007:15). Mënyrat sesi reagojnë individët janë të ndryshme, disa e kanë më lehtë për t'u përshtatur, disa të tjerë janë tërësisht të çorientuar nga një mjedis i huaj.

Është pranuar gjerësisht se kultura është një element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës së huaj, dhe gjuha është një formë shumë e mirë për të shprehur kulturën. Linguistët dhe mësuesit e gjuhëve të huaja janë të ndërgjegjshëm që një gjuhë e dytë apo një gjuhë e huaj nuk mund të mësohet pa marrë në konsideratë kulturën e komunitetit, në të cilin gjuha përdoret (Hinkel. E., 2013:2). Është e pamundur që të mësojmë një gjuhë të huaj, pa u ndeshur me kulturën e saj. Gjuha është forma më universale dhe më e rëndësishme për të shprehur kulturën njerëzore (UNESCO, 2009:13). Mësimi i një gjuhe të huaj nuk duhet të fokusohet vetëm në çështjet gramatikore, apo tek fjalori i saj, por të ndërthuret së bashku me kulturën.

Kultura gjithmonë ka qenë dhe vazhdon të jetë e pranishme dhe e lidhur me gjuhën, edhe pse asnjëherë nuk i është dhënë rëndësia e duhur, si një element thelbësor në komunikim. Shaver & Grandouiller deklarojnë që të mësosh kulturën me synim që të zhvillosh kompetencën duhet të jetë një element i rëndësishëm në kurrikulat e mësimin të gjuhëve të huaja (Shaver & Grandouiller, 2014:38). Janë bërë një sërë debatesh në nivel akademik për rëndësinë e kulturës, dhe shpesh here është diskutuar që të trajtohet si një lëndë më vete. Liddicoat-i thotë se kultura i jep formë gjithçkaje që themi, kur dhe si e themi, duke përdorur që nga gjuha më e thjeshtë tek ajo më e ndërlikuar. është jetike për mënyrën sesi flasim, shkruajmë, dëgjojmë apo lexojmë (Liddicoat, 2001:47). Studentet duhet të aftësohen për të pasur një komunikim sa më të suksesshëm me individë të kulturave të ndryshme. Të kuptojnë që u përkasin kulturave të ndryshme, të pranojnë dhe respektojnë kulturat e individëve të tjerë. Sipas Shaver & Grandouiller mësimi për artin, letërsinë, historinë ose ngjarjet kulturore, në anglisht ‘Big C’ , ka qenë dhe vazhdon të

mbetet një element tradicional dhe i rëndësishëm i programit, por ‘little C’ është elementi që do të ketë një efekt shumë të madh tek studentët, sidomos kur udhëtojnë në vendin ku gjuha flitet. Little C mund të identifikohet me elementet e përditshme të kulturës, që janë shpesh të padukshme nga një vëzhgues i rastit, por që përcaktojnë reagimin e një individi të një kulture të caktuar në një situatë të dhënë (Shaver & Grandouiller, 2014:38). Autorja Irimia, M.L., shprehet që duhet të vihet theksi midis kulturës big-C dhe kulturës small-C. Kultura big-C përfaqëson njohuri për literaturën, musikën, kërcimin, pikturën, skulpturën, teatrin dhe filmin. Kultura small-C përfshinë një aspekt më të gjerë si prsh. sjelljet, supozimet, besimet, perceptimet, normat dhe vlera, marrëdhëniet dhe vlerat, marrëdhëniet shoqërore, zakonet, festimet, ritualet, karakteristikat e ndërveprimit, përdorimi i hapësirës fizike dhe gjuha e trupit. Disa nga këto elemente të small-c mund të jenë dukshme dhe të padukshme. Elementet e padukshme mund të vihen re vetëm në moment të ballafaqimit me një kulturë tjetër (Irimia,M.L.,2012:325).

Autorë të ndryshëm kanë arritur në përfundimin se të dish të flasësh një gjuhë në nivelin më të lartë të mundshëm, nuk do të thotë që zotëron kompetencat e duhura sociale dhe kulturore për një komunikim sa më të efektshëm. Të gjithë ne kemi udhëtuar jashtë shtetit dhe mund të kemi hasur probleme kulturore të ndryshme që na kanë çuar në konflikte, paragjykime dhe keqkuptime. Çdo vend ka rregullat dhe normat e tij, edhe brenda një vendi mund të hasim ndryshime kulturore. Këshilli i Europës në ‘*Autobiography of intercultural encounter*’(2009:23) shprehet që ‘ Të kuptosh dhe të flasësh me dikë nga një kulturë tjetër nuk është e lehtë sepse ka besim, vlera dhe sjellje të ndryshme nga të tuat.’ Kjo vjen pasi çdo individ i përket një grupi kulturor të caktuar dhe në momentin që

përballet me individë të kulturave të tjera, mund të hasë vështirësi për t'u përshtatur dhe për të komunikuar. Ndryshimet kulturore mund të shkaktojnë konfuzion dhe keqkuptime kulturore. Në rrallë të parë është e rëndësishme që të kuptohen që jo çdo vlerë është e njëjtë për çdo individë: 'Vlerat, janë ide se çfarë është e duhur ose e gabuar, e drejtë apo e padrejtë, e mirë apo e keqe, e rëndësishme apo e pa rëndësishme (Cit, Jackson,J., 2014: 53,. Lustig & Koester 2010; Ting-Toomey & Chung 2012). Gjatë fazës së socializimit, ne e marrim si të mirëqënë që gjërat duhen të jenë dhe njerëzit duhet të veprojnë në një mënyrë të caktuar, gjë që është e gabuar. Le të marrim një shembull të paraqitur nga Jackson (2014) në lidhje me besimin: mënyra sesi i interpretojmë gjërat është e lidhur me kulturën nga të cilën në vijmë. Autori fokusohet tek mënyra se si e interpretojnë konceptin kohë njerëz që i përkasin besimeve të ndryshme. Prsh, në fenë Muslimane, Krishterë dhe Judiste koha është në formë lineare (që do të thotë që ka një fillim, një mes dhe një fund) kurse në Budizmi, Hinduizmi and Sikhizmi dimension i kohës është në formën e një cikli (që do të thotë procesi i krijimit lëvizë në formën e një cikli dhe kur nuk ka fund). (Jackson,2014:5) Përkatesiat fetare ndikojnë tek individët në mënyrën se si i interpreton gjërat. Ne sot si individë në një botë multikulturore jemi të ekspozuar ndaj këtyre ndryshimeve kulturore. Jo çdo besim, jo çdo vlerë apo traditë duhet ta marrim si të mirëqënë, duhet të zhvillojmë një të kuptuar të botës, që mos të kemi konflikte, duke respektuar vlerat, besimet, traditat e do individit. Për këtë arsye është e rëndësishme mësimi i kulturës në gjuhën e huaj, jo vetëm që të jemi të aftë për të komunikuar por mësojmë sesi të veprojmë ose të mos veprojmë në një situatë të caktuar, çfarë është e sjellshme apo e pa sjellshme. Njëpërmjet procesit të ndërveprimit për një komunikim të suksesshëm në mësojmë 'rregulla' e të ndërverpuarit me individë të ndryshëm. Në një mjedis ku jemi rritur e lindur nuk jemi shumë të

ndërgjegjshëm për kulturën ashtu siç është përshkruar edhe nga autorë të tjerë kulturën amtare si të ‘të padukshme’ ose ‘të heshtur’ (Cit. Jackson.J., 2014:60, (Furtengberg et al. 2001; Hall 1959, 1966; Kramersch 1993)). Byram shprehet që nëpërmjet procesit të socializimit individët mësojnë rreth botës, vlerave, besimeve dhe sjelljeve, dhe roli i gjuhës është thelbësor në këtë proces. Socializim do të thotë të përvetësosh njohurit për një shoqëri dhe të mësosh sesi të sillesh brenda kësaj shoqërie, duke përfshirë dhe aspektin emocional (Byram, 2008:21)

Të mësosh një gjuhë të huaj do të thotë ta flasësh dhe ta kuptosh, por nuk mund të arrijmë një komunikim të mirë nëse nuk jemi në gjëndje ta përdorim këtë gjuhë në kontekstin e duhur kulturor. Këndvështrimet që ne kemi, janë të trashëguara nga familja, miqtë, komuniteti ku jetojmë, dhe ndikojnë në mënyrën sesi veprojmë dhe mendojmë. Ne asnjëherë nuk mendojmë për kulturën, pasi çdo gjë që bëjmë na duket brenda normales, deri në momentin kur hasim vështirësi kulturore dhe fillojmë të reflektojmë mbi kulturën tjetër dhe kulturën tonë. Kramersch-i thekson që ‘ Gjuha, kur përdoret në procesin e komunikimit, është e lidhur me kulturën në shumë mënyra komplekse.... Gjuha shpreh realitetin kulturor... Gjuha mishëron realitetin kulturor... Gjuha simbolizon realitetin kulturore.’ (Kramersch, 1998:3)

Duke qenë se kultura është një proces dinamik dhe jo statik, për ta përvetësuar atë si të tillë, mësimdhënia ndërkulturore e gjuhës ka përcaktuar këto aktivitete kryesore. (Liddicoat, 2001:52):

- përvetësimin e kulturave

- krahasimin e kulturave
- eksplorimin e kulturave
- pozicionimi në vendin e ‘tretë’ midis kulturave.

Liddicoat-i thekson, gjithashtu, se e vetmja mënyrë për të mësuar për një kulturë tjetër është krahasimit me kulturën amtare, pasi ne nuk jemi të vetëdijshëm për mënyrën sesi komunikojmë dhe sillemi, meqë është përcaktuar nga kultura jonë. Qëllimi i mësimdhënies ndërkulturor të gjuhës është të ndihmojë studentët ta vendosin veten në një pozicion ndërkulturor, që quhet ‘pozicioni i tretë’ (Cit. Liddicoat, 2001:53, Kramsch 1993, Crozet et al. 1999). Për të arritur këto qëllime, kjo mësimdhënie mbështetet tek disa parime të përdorimit të përqasjes, për mësimin e kulturës brenda gjuhës. Më poshtë paraqiten pesë parime të tilla, sipas Liddicoat-it:

1. Kultura është pjesë e aftësive të gjuhës dhe jo një aftësi më vete.

Kultura është aftësia e pestë, pas të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të dëgjuarit.

2. Kultura mësohet që në hapat e para të mësimin të gjuhës.

Kultura është themelore për mësimin e gjuhës, për këtë arsye duhet të mësohet që në hapat e para të përvetësimit të një gjuhe të huaj.

3. Standardi është - folës dygjuhësh.

Për realizimin e një përqasjeje në mësimin e gjuhës me synim ndërkulturor, ka një rëndësi të veçantë lloji i folësit, që dëshiron të krijosh. Mësimi i gjuhës ka pasur tendencë që të formonte folës shumë të ngjashëm me vendasit, çka është e pamundur. Synimi duhet të jetë që të krijohet një folës i përshtatshëm për një kontekst ndërkulturor.

4. Përvetësimi i gjuhës përfshin eksplorimin ndërkulturor.

Shumicës së studentëve nuk i është dhënë mundësia për të mësuar sesi funksionon kultura e tyre dhe sesi gjuha reflekton kulturën, çka e vështirëson pranimin e një kulture tjetër. Në mësimin e gjuhëve të huaja me synim ndërkulturor, duhet të nisemi nga pohimi shumë i rëndësishëm që kultura është relative dhe jo absolute.

5. Përvetësimi është proces i vazhdueshëm

Nuk mund të mësohet gjithçka mbi kulturën. Kultura është komplekse dhe ndryshon nga një person në tjetrin. Është e pamundur të transmetosh një gjë kaq dinamike dhe komplekse në klasë. Ajo që mund të bëjmë është të zhvillojmë tek studentët aftësitë për të mësuar më shumë mbi kulturën që po përvetësojnë, duke analizuar eksperiencat e tyre dhe duke zhvilluar vetëdijen. (Liddicoat, 2001:53-54)

Bennett.M.J., në artikullin e publikuar '*Intercultural competence for global Leadership*' shprehet që disa përkufizime të kulturës janë më të dobishëm se të tjerët për të arritur kompetencën ndërkulturore. Është e zakonshme të mendohet për kulturën si mbledhje informacioni për artifaktet, institucionet, zakonet. Pra, si pas autorit idea e kulturës objektive është e mirë për të njohur historinë e njerëzve dhe për të vlerësuar diversitetin e produkteve që kanë krijuar. Këto njohuri nuk janë të mjaftueshme për të menaxhuar grupet multikulturore. Atë që autori shpreh është që njohurit nuk janë të barabarta me kompetencën. Për këtë arsye autori mbështet idenë e një kulture subjektive që na jep një pasqyrim më të drejtpërdrejtë në botëkuptimin e grupeve të ndryshme të kulturës, dhe ky pasqyrim kthehet në një menaxhim më efektiv.

Në Shqipëri, studentët kanë shumë vështirësi për të mësuar kulturën e vendeve anglishtfolëse. Ndërkaq, ndryshimet kulturore që ekzistojnë mund të krijojnë probleme gjatë mësimi të gjuhës së huaj. Siç e dimë përdorimi i fjalëve në anglisht përcaktohet si nga konteksti lingvistik, ashtu edhe nga ai kulturor. Gjatë mësimi të një fjale duhet të mësojmë edhe njohuritë kulturore rreth asaj fjale për të dhënë një kuptim sa më të saktë.

Ndryshimet midis gjuhës shqipe dhe anglishtes, nuk janë vetëm në fjalor e në gramatikë, por edhe në mënyrat e të menduarit apo strukturimit të fjalive. Studentet duhet të mësojnë si të komunikojnë dhe të zbulojnë vetë veçoritë e ambientit, ku flitet kjo gjuhë. Për këtë arsye, çdo temë mësimore duhet të jetë e organizuar, për të zhvilluar aftësitë interpretuese dhe analizuese. Të mësosh kulturën do të thotë të ndihmohet studentët të familjarizohen me traditat, vlerat, normat e gjuhës së synuar. Njohja e kulturës së huaj na ndihmon të reflektojmë për kulturën tonë. Sipas Corbett-it 'është e pamundur t'i tregosh nxënësit gjithçka që ai duhet të dijë mbi kulturën e synuar... në fakt duhet të mësohet me praninë e ndryshimeve' (Corbett, 2003:24). Tashmë, mësuesi nuk është i vetmi përgjegjës për të nxitur të mësuarin e kulturës, por kërkohet një bashkëpunim midis studentëve dhe pedagogëve.

'Anglishtja, si një gjuhë lingua franca është në procesin e zgjerimit të kulturës së saj, duke përfshirë kultura të tjera, nëpërmjet përdorimit nga folës multikulturorë jovevendas. Në këtë rast, anglishtja ndërmjetëson midis kulturave të ndryshme dhe mësuesit e gjuhës angleze duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin e tyre si ndërmjetës ndërkulturorë. Për të luajtur këtë rol, mësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se çdo të thotë lingua franca, si variacion i anglishtes, dhe cili është funksioni i saj'. (Arabski, J., & Vojtaszek, 2011:19)

Një mënyrë e mirë është zhvillimi i dialogëve dhe debateve, për temat që ofrohen në tekstet shkollore ose mund të gjenden në materiale të tjera shtesë. Dialogët dhe debatet ndihmojnë për të parë këndvështrimin e studentëve, për të shkëmbyer eksperiencën. Është e

rëndësishme të mbajmë mend që gramatika dhe fjalori janë thelbësore dhe nuk duhen shmangur, por me përvetësimin e kompetencave ndërkulturore, komunikimi do të jetë më i thjeshtë. Gjuha mbetet mjet i komunikimit mes individëve dhe kultura ndihmon për ta kompletuar këtë proces. Nuk duhet harruar edhe fakti që të mësosh një gjuhë të huaj nëpërmjet kulturës është një sfidë për pedagogët. Me zhvillimin e teknologjisë dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies, nuk duhet të jetë më e vështirë të mësosh një gjuhë të huaj nëpërmjet kulturës.

Për të kuptuar rëndësinë e kulturës, është e domosdoshme të përmendet edhe ‘shoku kulturor’, i cili ndodh si rezultat i eksperiencës nga kontaktet me individë që kanë të kuptuar, vlera, stil jete të ndryshme. Shoku kulturor ndodh për shkak të kontaktit me kultura të panjohura. Është e rëndësishme që studentët të jenë në dijeni të shoku kulturor dhe të përgatiten sesi mund ta shmangin. Oberg thotë që ‘shoku kulturor paraprihet nga ankthi që vjen si rezultat i humbjes të të gjitha shenjave dhe simboleve tona të njohura të ndërveprimit social’ (Oberg, 1960:142). Sipas autorit këto shenja ose të dhëna na ndihmojnë ne sesi të orientohemi në situatat e jetës së përditshme si prsh. kur të japin dorën, se çfarë të themi kur takojm njerëz, kur të pranojmë dhe refuzojm ftesa etj., me pak fjalë si duhet individët të reagojnë. Të gjitha këto shenja që mund të jenë fjalë, gjeste, tradita ose norma ne i kemi përvetësuar gjatë procesit të rritjes dhe janë pjesë e gjuhës dhe vlerave që ne flasim. Autori mbron iden që individ i lindur me kulturën por ka vetëm aftësinë për ta mësuar dhe përdorur këtë. Ai thotë që nuk ka asgjë në genet e një fëmijë të sapo lindur që diktoj nëse duhet të flasi Anglisht apo Fërngjisht, të ushqehet me dorën e majtë apo të djathtë, me shkop apo me piru, por të gjitha këto janë të ushqyer nga

mjedisi social ku secili rritet. Kultura mësohet, nuk është e lindur. Pra, të gjitha këto gjera mësohen. Për të kaluar shokun kulturor autori sugjeron që të njihen njerëzit e kulturës pritës.

Pederson shprehet që shoku kulturor është eksperiencë personale, nuk i prek të gjithë njerëzit në të njëjtën mënyrë; dhe jo të gjithë e kuptojnë që po kalojnë një shok kulturor. Sipas tij, shoku kulturor: (1) është një proces, jo një ngjarje e vetme; (2) mund të ndodh në nivele të ndryshme në të njëjtën kohë, kur individi ndërvepron me një mjedis kompleks; (3) mund të bëhet më i fortë ose më i dobët ndërkohë që individi mëson si ta përballojë ose dështon në përballim; (4) i mëson individit strategji të reja, të cilat kontribuojnë në suksesin për të ardhmen; (5) vlen për çdo ndryshim radikal që paraqitin rrethana të papritura dhe jo të njohura (Pederson,1995:7). Sipas Douglas Brown, shoku kulturor është një eksperiencë e zakonshme për çdo person që mëson një gjuhë të dytë në një kulturë të dytë. Autori shprehet që shoku kulturor, siç është përmendur dhe më parë nuk është një fenomen që haste rrallë, vecanërisht sot në kohën e zhvillimit të teknologjisë së komunikimit, globalizmit etj. Sot sa vjen e bëhet më e lehtë kontakti me një gjuhë dhe kulturë tjetër. Shoku kulturor mund të vijoje nga një ndjenje irritueshmërie deri në një dhimbje dhe krize të rënde psikologjike. Shoku kulturor mund të karakterizohet nga ndjenja e pavendosmerise, frustrimit, mërzisë, vetmi, mungesa e shtëpisë etj. (Douglas Brown, 2002:35). Për të qënë me konkret mbi ndjenjat dhe pikepamjen e një personi i cili po kalon shok kulturor sjell si shembull Edward Hall (1959) (Cit. Douglas Brown,2002) i cili jep rastin hipotetik të një Amerikane i cili po jeton jashtëkufinjve të Amerikës për herë të parë

dhe gjendet në një tjetër kontinent, nga ky shëmbull mund të arrijmë të kuptojmë edhe fazat e kalimit të shokut ndërkulturor:

Në fillim gjerat nëpër qytete dukeshin pothuajse të ngjashme. Ka taksi, hotele me ujë të ftohtë e të ngrohtë 24 ore në ditë, teatro, dritat e neonit, madhe dhe ndërtesa të gjata me ashensore si dhe disa njerez që flasin gjuhën angleze. Por shumë shpejt Amerikani zbulon se nën atë petkun e ngjashëm të gjerave ekzistonin në fakt shumë ndryshime. Kur dikush të thotë “Po”, në fakt nuk ka dashur të thotë po aspak, dhe kur njerezit të buzeqeshin nuk nenkupton që ata janë kenakur. Kur vizitori amerikan bën një xhest të këndshëm ai mund të perballë me refuzimin; kur ai perpiqet të tregohet armiqësor dhe nga ana tjetër nuk merr asnjë reagim, nuk ndodh asgjë. Njerezit i thonë që do bëjnë gjëra kur në realitet nuk bëjnë asgjë. Sa më gjatë që vizitori Amerikan qëndron aty aq më i huaj dhe i panjohur fillon dhe i duket qyteti ku po qëndron. (Cit. Douglas Brown 2002:35)

Ndërkohë që Peter Adler e përshkruan shokun kulturor në terma më psikologjike dhe teknike:

Shoku kulturor rezulton në fakt një formë ankthi i cili lind si rezultat i humbjes së shënjavës dhe simboleve të komunikimit të cilat janë tashmë të familjarizuara për personin por që kërkojnë papritur skema të ndërtuar në psikologji të tyre nuk përputhet me realitetin. Personi i cili po kalon një shok kulturor reflekton anshin dhe nervozitetin e tij në lidhje me ndryshimin kulturor duke përdorur mekanizmat e vet mbrojtës: repression, regres, izolim dhe refuzim i të pranuarit të vërtetës. Përkundrazi ky mekanizëm mbrojtës ka shumë gjasa, që nga ana biologjike, tregojnë mbi një pasiguri të rrenjosur tek personi i cili mund të përfshijë dhe vetëmimin, frustrimin, vënie në diskutim të kompetencave të tij. Individit më pas korrientohet, tjetërsohet, frikësohet pasi përkundrazi pikat e referimit, simbolet, shenjat e njohura për të nuk janë më. (Cit. Douglas Brown, 2002:36)

Antropologu George M. Foster (1962) e përshkruan shokun kulturor me terma ekstreme: ‘Shoku kulturor është një sëmundje mendore, dhe, ashtu si në çdo sëmundje mendore, viktimat nuk e di që është i prekur. Ai/Ajo e gjen vetën agresivë, në gjendje depresioni, për shkak të mungesës së vëmendjes tek ai’ (Cit. Douglas Brown, 2002:36).

Shoku kulturor mbetet një pengesë e madhe drejt suksesit në kontakte ndërkulturore. Sipas akademikëve të ndryshëm, shoku kulturor kalon në faza të ndryshme, Lysgaard (1955) ishte ai që zhvilloi Hipotezën U ‘*U- Curve Hypothesis*’. Kjo hipotezë është modeli i parë i krijuar për përshkrim të kulturave. Ai mendon që ka katër faza të shokut kulturor, të cilat nuk janë të njëjta për çdo individ, ato ndryshojnë në varësi të individit.

Faza e parë, *Honeymoon stage* (Faza e muajit të mjalti) - në këtë fazë je i tërhequr nga kultura e re dhe i emocionuar për të gjitha gjërat e reja dhe interesante; Faza e dytë, *Culture Shock stage* (Faza e shokut kulturor) - periudha e zhgënjimit, pasi duhet të përballesh seriozisht me të jetuarit në një kulturë të re ditë për ditë. Faza e tretë, *Recovery stage* (Faza e përmirësimit) - fillon gradualisht të përshtatesh me kulturën e re dhe mëson sesi të veprësh në mënyrën e duhur. Faza e katërt, *Adjustment stage* (Faza e përshtatjes) - jeni më efektiv në përshtatjen me kulturën e re. Detyrat e jetës së përditshme kalojnë në fazën e dytë. (Lysgaard,S., 1955). Ekzistojnë edhe teori të tjera që përshkruajnë fazat e shokut kulturor si p.sh. S.O. Lesser dhe H.W.S. Peter (1957), që e ndanë shokun kulturor në tri faza: faza e parë është faza e spektatorit; faza e dytë është faza e përfshirjes, kur një person nuk mund të qëndrojë më jashtë kulturës pritëse dhe duhet të përfshihet; faza e tretë është ajo ku vizitori mëson sesi t'i bëjë ballë kulturës pritëse (Pederson, 1995:3). Pedagogët e gjuhëve të huaja duhet të jenë të vetëdijshëm për shokun kulturor dhe të ndihmojnë studentë që t'i kalojnë të gjitha këto faza, duke i lehtësuar pasojat që mund të shkaktojnë ky proces, për të kuptuar pse ndiejnë dhe reagojnë në këtë mënyrë gjatë këtyre fazave. Sipas autorit WA-MBALEKA ndërtimi i marrëdhënieve me antarë të një kulture të re është një ndër qëllimet kryesore, kur hyjmë në kontakt me një kulturë të huaj. Shoku kulturor ndikon në performancën e një individ dhe shpesh herë mund të përfundojë duke shfaqur ndjenja negative kundrejt kulturës pritëse. Kur një student hyn në kontakt me një kulturë të re, është në dorë të pedagogut për të dhënë shembullin e duhur dhe për të krijuar një atmosfere të rehatshme. Një ndër taktikat që mund të përdoren, është ajo nëpërmjet komunikimit të studentëve me anëtarë të gjuhës së synuar. (WA-MBALEKA; 2012:17).

Pederson nxjerr disa supozime të përgjithshme në lidhje me shokun kulturorë parqitur më poshtë:

Së pari, shoku kulturor nuk është një sëmundje, por një proces i të nxënit, pavarësisht sa i dhimbshëm ose i parehatshëm mund të jetë. Gjithësesi, shoku kulturor mund të lidhet me sëmundje dhe me gjendje patologjike.

Së dyti, nëse e marrim si metaforë, shoku kulturor mund të lidhet me krizat e jetës në një serë fushash, përveç eksperiencave të udhëtuarit në një vend tjetër. Çdo person që përjeton ndryshime radikale në jetën e tij, mund të përjetojë një proces të përshtatjes, që është paralel me kushtet e përshkruara për shokun kulturor.

Së treti, është shumë e vështirë për të matur shokun kulturor, për shkak të natyrës së tij komplekse ose shumëdimensionale, megjithëse leverdia heuristike e modelit U (U-curve) në karakterizimin e shokut kulturor ka gjasa më shumë ta trajtojë vazhdimësinë e tij si përshkruese e jo si një model shpjegues.

Së katërti, ka mënyra të veçanta për të përgatitur njerëzit që do të përjetojnë shokun kulturor, të cilat do të lehtësojnë të gjithë diskonfortin që vjen si rezultat i këtij procesi.

Së pesti, shoku kulturor është një fenomen i përjetuar shpesh, në një nivel më të ulët ose më të lartë, së paku çdo person e përjeton një herë në jetë. Për këtë arsye është e rëndësishme që të kuptohet shoku kulturor për të njohur më së mirë kulturat e tjera dhe veten tonë në marrëdhënie me kulturat e tjera. (Pederson,1995:11)

1.4. Vetëdija kritike kulturore

Vetëdija kritike kulturore është një term që është futur vetëm dekadën e fundit, dhe shënon diçka të rëndësishme për të kuptuar kulturën amtare dhe kulturën e synuar. Vetëdija kritike kulturore nuk është akoma synim i mësimi të gjuhës së huaj, edhe pse është e rëndësishme që studentët ta përvetësojnë, si një element bazik për komunikim ndërkulturor, për të shmangur vështirësitë në të kuptuar dhe ndërveprim dhe për të krijuar respekt për vlerat dhe veçantitë e çdo kulture, pa të cilat nuk mund të kemi përfshirje. Vetëdija kritike kulturor mbetet një objektive i rëndësishëm i zhvillimit të kompetencës ndërkulturore.

Autori Guilherme.M., theksohet: ‘Një qasje kritike për përvojat e dallimeve kulturore është e rëndësishme për zhvillimin e pedagogjisë kritike dhe për efektshmërinë e

gjuhës dhe edukimit ndërkulturore, duke çuar në zhvillimin e ‘vetëdijes kritike kulturore’, një nocion i zhvilluar nga Byram-i’ (Guilherme.M., 2012:360).

Vetëdija kritike kulturore është bazë për krijimin e kompetencës ndërkulturore. Për të përvetësuar ‘vetëdijen kritike kulturore’, Byram sugjeron krahasimin midis kulturës amtare dhe kulturës së huaj, aftësinë për të bërë një vlerësim kritik mbi bazën e kriterëve të qarta, dhe negociimin sipas kriterëve të vendosura. Ai e përkufizon ‘vetëdijen kritike kulturore’, *savior s’engager* si: “aftësi për vlerësuar në mënyrë kritike dhe mbi bazën e kriterëve të qarta perspektivat, praktikat dhe produktete kulturën në vendin respektiv dhe atë të huaj.” (Byam, 1997:53).

Objektivat (aftësia për):

- Identifikim dhe interpretim i vlerave të shprehura ose të nënkuptuara në dokumente ose ngjarjeve të kulturën amtare ose të synuar;
- Analizë vlerësuese e dokumenteve ose ngjarjeve që i referohen një perspektive me kriterë të mirëshprehura;
- Ndërveprim dhe ndërmjetësim në shkëmbimin ndërkulturor, në përputhje me kriterë të qarta, duke negociuar, aty ku është e nevojshme, një nivel pranimi të tyre, bazuar në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet përkatëse. (Byram, 1997:53)

Duke parë të gjithë *saviors* të emërtuar nga Byram-i, mund të themi që vetëdija kritike kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme për të krijuar qytetarë të denjë në shoqëri demokratike, duke ndihmuar kështu që të përmbushen qëllimet e Këshillit të Europës. Të gjitha këto objektiva të parashtruara ndihmojnë pedagogqë të reflektojnë mbi praktikat që duhet të ndjekin gjatë orës së mësimi. Byram-i sugjeron edhe disa aktivitete të tjera , që mund të ndiqen nga studentë dhe mësuesit:

- duke përdorur një gamë përfaqësues analitike, për të vendosur një dokument ose ngjarje në kontekst (të origjinës\burimit, kohës, vendit, dokumente ose ngjarje);
- duke qenë i ndërgjegjshëm për perspektivat ideologjike dhe vlerat personale, folësi ndërkulturor vlerëson dokumentet ose ngjarjet me një reference të qartë;
- duke qenë i ndërgjegjshëm për konflikte të mundshme ndërmjet ideologjisë së tij dhe asaj të tjerëve, folësi ndërkulturor është i aftë për të vendosur kritere të përbashkëta për vlerësimin e dokumenteve ose ngjarjeve, dhe, kur kjo nuk është e mundur për shkak të mospërputhjes në sisteme, besime dhe vlera, është në gjendje që të negociojë për hapësirat konfliktuale dhe për pranimin e ndryshimeve. (Byram, 1997:63)

Studentët duhet të jenë të vetëdijshëm për kulturën e tyre. Duhet të kuptojnë që nuk ekziston një kulturë e vetme. Ata të jenë të aftë për të kuptuar dhe analizuar kultura të ndryshme, të jenë në gjendje që t'u përshtaten, për të pasur një ndërveprim ndërkulturor të suksesshëm. Duke mësuar kulturën e gjuhës së synuar, jo vetëm që i ndihmon të veprojnë dhe reagojnë në mënyrë naturale me personat e kulturave të tjera, por mësojnë edhe si të përdorin fjalë dhe shprehje në mënyrë më autentike të mundshme, duke mësuar jo vetëm që të përdoren nga ana gramatikore në mënyrën e duhur por duke mësuar se kur ti përdorin këto fjalë dhe shprehje dhe në çfarë rrethanash. Sigurisht ky është një proces i gjatë dhe jo të gjithë studentët mund të jenë në njëjtin ritëm, dhe as nuk duhet të presim që të fitojnë aftësitë dhe sjelljet e një folësi vendasi. Rritja e vetëdijes kulturore do të thotë të shohësh si aspektet pozitive dhe negative të ndryshimeve kulturore, ngjashmërit dhe ndryshimet janë të dyja të rëndësishme. Duke u pajisur me vetëdijes kritike kulturore gjatë mësimit të gjuhës së huaj, studentët bëhen të aftë për të vlerësuar (Byram, 1997), ndihen më të lidhur me materialin, sepse mund të shohin sesi nocioni i vetëdijes lidhet me çështjet e botës reale, (Kramsch, 2004; Osborn, 2006), fitojnë eksperiencë për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik dhe stimulojnë rritjen e nivelit të stimulimit intelektual (Osborn, 2006) (Cit. Nugent, K

et al., 2015:3). Autorët Tomlinson & Masuhara (2004) bëjnë ndryshimin ndërmjet vetëdijes kulturore dhe njohurive kulturore. Autorëve e përkufizojnë vetëdijen kulturore si ‘zhvillon gradualisht ndjesin e brëndshme të barazisë së kulturave, një rritje në të kuptuarin e vetës dhe kulturave të njerëzve, dhe një interes pozitiv sesi kulturat lidhen dhe ndryshojnë’ (Cit. Newton.J, 2007:525) . Ndërsa njohuritë kulturor e përkufizojnë si statike dhe përgjithësimë stereotipike për normat kulturore që dallojnë kulturat e ndryshme prsh., Gjermanët janë të drejtëpërdrejtë, Anglezët janë të rezervuar (Cit. Newton, J, 2007:525). Sipas Tomlinson & Masuhara (2004) vetëdija kulturore përbehet nga këto perceptime: (Cit. Saniei. A, 2012:11)

1. të brëndshme : zhvillohen në mendjen tonë
2. dimanike: janë në ndryshim të vazhdueshëm
3. i ndryshueshëm: ndryshohen në bazë të eksperiencës
4. multi-dimensional: ata janë të përfaqësuar përmes imazheve shqisore, lidhjeve mendore, si dhe përmes zërit të brëndshëm
5. interaktiv : me atë që lidhen dhe informojnë njëri-tjetër

Ndëra njohuri kulturore përbëhet nga informacioni për karakteristikat e vetes dhe njerëzve të kulturave të tjera. Ky informacion është:

1. i jashtëm: na jepet nga të tjerët
2. statik: nuk e ndryshojmë atë nga eksperiencia
3. artikuluar: është i reduktuar në atë që fjalët mund të shprehin
4. stereotipike: i referohet normave të përgjithshme dhe jo rasteve të veçanta
5. reduktuar: është përzgjedhur nga të gjitha informacionet e disponueshme dhe nuk përfshin informacionin për variacionin dhe përjashtimet (Cit. Saniei. A, 2012:11-12)

Në Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët i njohur me akronimin CEFR shkruhet që ‘vetëdija ndërkulturore përfshin vetëdijen për diversitetin rajonal dhe social në ‘botën e orgjinës’ dhe në ‘botën e komuniteti të synuar’. Në Kuadrin e Përbashkët Evropian thuhet që ‘aftësitë dhe të ditur-bërit ndërkulturor’ duhet të përfshijnë: (Cit. Intercultural Experience and Awareness’ European Language Portfolio (August 2003/February 2011:5)

- aftësia për të sjell kulturën e orgjinës dhe atë të vendit të synuar në marrëdhënie midis njeri-tjetërit.
- ndjeshmëri kulturore dhe aftësia për të identifikuar dhe përdorur një sërë strategjis për kontakte me njerëz nga kultura të tjera.
- kapaciteti për të përmbush rolin e ndërmjetësit kulturor ndërmjet kulturës amtare dhe të synuar dhe për të zgjidhur në mënyrë efektive keqkuptimet dhe konfliktet ndërkulturore
- aftësia për të shmangur stereotipet

Këtu mund të shtohet

- vetëdija kritike kulturore: përfshirje për të kuptuar veten dhe të tjerët dhe të qenit i vetëdijshëm për bazat etike dhe morale në të cilën janë bërë gjykime
- multir prespektiva: aftësia për të parë gjerat nga shumë këndvështrime (Cit. Intercultural Experience and Awareness' European Language Portfolio (August 2003/February 2011:5)

1.5. Rëndësia e kompetencës ndërkulturore

'Nuk besoj se mund të bësh punën e sotme me metodën e djeshme dhe të jesh pjesë e biznesit ditën e nesërme' - Nelson Jackson
'Nuk mund t'i zgjidhim problemet me të njëjtën mënyrë që përdorëm për t'i krijuar ato.' – Albert Einstein

Të gjitha elementet e përmenduar në pjesën e parë mund të përvetësohen me eksperiencë dhe reflektim, me ndihmën e pedagogëve. Janë fakultetet që duhet të ndërtojnë programe për t'i përgatitur studentët që të jetojnë dhe punojnë në shoqërinë globale.

Ka shumë mendime në lidhje me kuptimin e kompetencës ndërkulturore nga autor dhe akademik të ndryshëm. Bortini & Motamed -Afshari., në Salto Cultural Diversity ndërmori një nismë për të mbështetur zhvillimin e kompetencave ndërkulturore tek të rinjtë. Kjo nismë kishte si qëllim t'i përgatiste ata të shihnin përtej kulturës së tyre, duke e zgjeruar atë gjatë ndërveprimit në jetën e përditshme. Ata mbështetnin mendimin se

kompetencat ndërkulturore ndihmojnë në analizën dhe rikrijimin e njohurive ekzistuese.
(Bortini,P & Motamed-Afshari,B, 2012:4)

Në këtë dokument paraqiten rezultatet e të rinjve gjatë fazës së trajnimit për përvetësimin e kompetencave ndërkulturore. Rezulton që të rinjtë kanë aftësi për të zhvilluar dhe praktikuar kompetencat ndërkulturore, falë aktiviteteve të zhvilluara nga trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim. Metodat e përdorura për përvetësimin e këtyre kompetencave ishin pyetje të hapura, duke i lënë që të ndajnë eksperiencën dhe mendime gjatë diskutimeve.

‘Kompetenca ndërkulturore e zhvilluar dhe demonstruar gjatë punës me të rinjtë evropianë u përqëndrua te cilësitë (njohuritë, aftësitë, vlerat, dhe qëndrimet) që i duhen një të riu për të jetuar në Evropën bashkëkohore pluraliste; që bëjnë atë të këtë një rol aktiv kundrejt padrejtësive sociale dhe diskriminimeve, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut..‘
(Bortini,P & Afshari,B, 2012:4)

‘Përvetësimi i kompetencave ndërkulturore është përshkruar nga ekspertët si një proces i gjatë që ndërtohet mbi njohuritë dhe ekperiencat e mëparshme, duke i rindërtuar ato e për të fituar njohuri të reja.‘ (Bortini,P & Motamed-Afshari,B., 2012:15)

Kompetencat ndërkulturore janë pranuar gjerësisht tashmë dhe, çdo ditë e më shumë, rritet rëndësia e përvetësimit të tyre. Sipas Bortini & Motamed -Afshari., në SALTO Cultural Diversity. përcaktohen cilësitë kryesore, për përvetësimin e kompetencave ndërkulturore:

1. të kesh një rol aktiv ndaj padrejtësive sociale dhe diskriminimit,

2. të nxitësh dhe të mbrosh të drejtat e njeriut,
3. të kuptosh kulturën si një proces dinamik shumëdimensional,
4. të krijosh ndjenjën e solidaritetit,
5. të përballosh pasiguritë,
6. të nxitësh të menduarin kritik,
7. të krijosh ndjenjën e empatisë,
8. të nxitësh tolerancën ndaj dykuptimësisë. (Bortini,P & Afshari,B, 2012:22)

Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore tek studentët është akoma më i rëndësishëm sot, kur kërkohen, çdo ditë e më shumë, njerëz që kanë fleksibilitet dhe aftësi t'u përshtaten mjediseve me individë të kulturave të ndryshme. Përpara se të mendojmë për rëndësinë që ka kompetencat ndërkulturore dhe pse duhet të futet në arsim duhet të bejmë pyetjen cilat janë problemet që vijnë si rezultat i mungesës së kompetencës ndërkulturore. Shaver & Grandouiller shprehen që mësim nëpërmjet prespektivës kulturore nuk kërkon vetëm përshtatjen nga ana mësuesit, por gjithashtu kërkon përshtatje edhe nga ana e studentit. Sipas autoreve, të mësosh kulturën me synim të integritit të kompetencës ndërkulturore mund të zhvillohet brenda kulturës së synuar dhe jashtë kulturës së synuar. Jashtë kulturës së synuar do të thotë që pedagogët duhet të jenë të aftë të sjellin në klasë kulturën e synuar. (Shaver & Grandouiller,2014:39)

Kompetenca ndërkulturore luan një rol të rëndësishëm në komunikim, dhe që karakteristikat e kompetencës ndikon në mënyrën sesi veprojmë në situata të ndryshme. Mungesa e kompetencës con në keqinterpretime dhe konflikte pasi vlerat, qëndrimet, besimet etj. varen nga mjedisi kulturor që jemi rritur. Në të shumtën e rasteve ne nuk e

vëjm re ndikimin që kemi tek të tjerët. Kjo është aryeja pse duhet të që kompetenca ndërkulturore të futet në kurrikula si një kompetence thelbësore.

Liddicoat et al. në një raport të bërë në një shkollë të Australisë, për ndërveprimin e gjuhës dhe kulturës në nxënien, mësimdhënien dhe vlerësimin e gjuhës, thekson se gjuha nuk mund të ndahet nga konteksti i saj social dhe kulturore (Liddicoat et al. 2003:50). Sipas tyre, të mësuarit ndërkulturore të gjuhës përfshin të kuptuarit e gjuhës dhe kulturës amtare në lidhje me një gjuhë dhe kulturë tjetër. Janë universitetet që duhet të krjojnë kushte, për t'i përgatitur studentet me këto aftësi. Kompetencë ndërkulturore nuk do të thotë të braktisësh identitetin ose përkatësinë tënde kulturore, dhe as të përshtatesh vetëm me praktikat kulturore, besimet, vlerat e një kulture tjetër. (Barret.M, et al. 2013:12)

Fantini shprehet që në momentin që fillon procesi i zhvillimit të kompetencës ndërkulturore është një proces i pandalshëm – shpesh një proces që na shoqëron gjithë jetës. Autori shprehet që individët mund të përjetojnë faza regresioni ose ndalimi, por nuk ka kurrë një pikë përfundimtare, individi është gjithmonë në procesin e të 'bërit' dhe asnjëherë nuk është totalisht i plotësuar si 'kompetent ndërkulturalisht' (Fantini,1995,b:29). Pavarësisht përpjekjeve tonë për të zhvilluar dhe zgjeruar kompetencën tonë, sfida të reja gjithmonë do të ekzistojnë.

1.6. Nga kompetenca komunikative te kompetenca ndërkulturore

Termat '*kompetenca komunikative*' dhe '*kompetenca ndërkulturore*' kanë qenë dhe vazhdojnë akoma të jenë pjesë e debateve në studimet gjuhësore. Në këtë kapitull ,do të bëhet një analizë e studimeve të kryera për këto kompetenca. Së pari, do të paraqitet

historia e evoluimit kuptimor të termit ‘kompetencës komunikative’. Kompetenca komunikative përcakton kur të flasësh, kur të mos flasësh, çfarë të thuash, më kë të flasësh etj. Sipas Cook.G, ‘kompetenca komunikative është një model i fuqishëm i gjuhësisë së aplikuar, jo vetëm në mësimdhënien e gjuhës, por në çdo fushë kërkimore. Ajo lëviz midis gjuhësisë teorike dhe mënyrës tradicionale të mësimdhënies së gjuhës, ndërsa vetë si një model i idealizuar, mund të ndihmojë procesin e kthimit të abstraksionit gjuhësor sërish në origjinë’ (Cook.G., 2003:48). Richard,J.C përpara se të japi një përkufizim të kompetencës komunikative, sqaron se çfarë është kompetenca gramatikore. Sipas autorit, kompetenca gramatikore i referohet njohurive që kemi për gjuhën për të ndërtuar fjali në gjuhën e huaj. Kompetence gramatikore i referohet përvetësimit të njohurive në lidhje me kohët e foljes, pjesët e ligjërates, shprehjet etj. Kompetenca gramatikore fokusin kryesor e ka në zotërimin e rregullave gramatikore dhe në aftësinë për ti venë në zbatim në ushtrime gramatikore. Autori shprehet që kompetenca gramatikore është një dimension i rëndësishëm i mësimi të gjuhës, por nuk është gjithcka, pasi një person mund të zotëroj të gjitha njohurit për të formuar fjali të sakta dhe mund të mos jetë i aftë për ta përdorur gjuhën për qëllime komunikative. Aspektet e tjera kryen nga kompetenca komunikative (Richard,J.C, 2006:2). Autori thotë që kompetenca komunikative përfshinë këto aspekte të njohurive gjuhësore: të dish si të përdorësh gjuhën për qëllime dhe funksione të ndryshme; të dish se kur të përdorësh gjuhë formal dhe joformale në bazë të vendodhjes dhe pjesëmarrësve; të dish si të prodhosh dhe të kuptosh lloje të ndryshme teksesh (prsh. narrative, biseda, intervista); të dish si të ruash komunikimin pavarësisht njohurive të limituar të gjuhës. (Richard,J.C. 2006:3)

Sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët e ndajnë kompetencën komunikative në disa komponent: linguistik, sociolinguistik dhe pragmatik. Kompetenca linguistik përfshijnë njohuri leksikore, fonologjike dhe sintaksore dhe dimensione të tjera të sistemit të gjuhës si i tillë, pavarësisht nga vlera sociolinguistike e varianteve të tij dhe funksionet pragmatike që realizon. Kompetenca sociolinguistike i referohet kushteve sociokulturore të përdorimit të gjuhës. Kompetenca pragmatike merret me përdorimin funksional të burimeve gjuhësore (prodhim i funksioneve gjuhësore, të folurit) duke u bazuar në modelet e bashkëveprimit. (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching and assessment, 2001:13)

Synimi i mësimit të gjuhës së huaj ka qënë përvetësimi i kompetencave komunikative, aftësia për të përdorur gjuhën sipas rregullave të mirëpërcaktuara, që nxënësit e studentët të mësojnë të flasin dhe të kuptojnë gjuhën e synuar. Me fjalë të tjera, kompetencë komunikative do të thotë të dish çfarë të thuash dhe si ta thuash në një situatë të caktuar. Kompetenca komunikative është një koncept bazë për të kuptuar ndërveprimin social. (Paulston B.Ch, 1992:39)

Kompetenca komunikative është një koncept që u zhvillua në botën anglofone nga Hymes. Trajtimi i tij u frymëzua nga idetë e Noam Chomsky-t për kompetencën gjuhësore, duke iu kundërvënë atij. Ideja e Hymens-it ishte që për folësit nuk mjafton të kenë aftësinë për të përdorur gjuhën në mënyrën e duhur, pra thjesht kompetenca gjuhësore, për të e rëndësishme është kompetenca sociolinguistike. (Cit.Byram,M, 1997:7)

Modelin e Hymes-it e përpunuan më tej nga gjuhëtarë të tjerë, si Canale dhe Swain (1980). Modeli që ata propozuan përbehet nga tre kompetenca kryesore, përveç *kompetencave linguistike dhe sociolinguistike*, të futura nga Hymes-i (1972), shtuan edhe *kompetencën strategjike* (aftësia për zgjidhur probleme që krijohen gjatë ligjërimit). Gjithashtu, termin kompetencë linguistike e zëvendësuan me termin *kompetencë gramatikore*. (Celce-Murcia, 2007:42)

Më vonë ky model u përpunua nga Canale (1983), duke shtuar edhe një kompetencë të katërt, që ishte *kompetencat e ligjërimit* (aftësia për të formuar ligjërata koherente dhe kohesive). Ky model i fundit përfshin katër kompetenca:

kompetenca gramatikore - njohuri mbi aspektet gramatikore, rregullat, fjalorin, shqiptimin etj.

kompetenca sociolinguistike - zotërimi i kodit sociokulturor të përdorimit të gjuhës (përdorimi i duhur i fjalori, regjistri, stili)

kompetenca e ligjërimit- aftësia për të kombinuar strukturat e gjuhës në lloje të ndryshme të teksteve kohesive (p.sh. fjalime politike)

kompetenca e strategjive - njohuri të strategjisë së komunikimit verbal dhe jo-verbal, që rrit efikasitetin dhe lejon folësin të tejkalojë vështirësitë e komunikimit. (Celce-Murcia et al., 1995:7)

Në vitin 1995, Celce-Murcia et. al zhvilluan modelin e tyre të kompetencave komunikative. Karahasuar me modelet e mëparshme, ky është i vetmi model që kërkon ndërveprimin e komponenteve të kompetencave komunikative, Modeli i tyre paraqitet në formën e një rrethi brenda një piramide, rrethuar nga një rreth tjetër. Figura 5.




Figura 5. Modeli i kompetencës komunikative Celce-Murcia et al. (1995:10)

Përveç modelet e kompetencës komunikative të paraqitura më parë, u shtua edhe një kompetencë e pestë, *kompetenca e veprimit* (është konceptuar si kompetencë për të transferuar dhe kuptuar qëllimin komunikative, duke realizuar dhe interpretuar ligjerime dhe kontekste ligjerimi, (Celce-Murcia 1995:9). Disa ndryshime janë bërë edhe në terminologji: së pari, termi ‘kompetenca linguistike’ është përdorur sërish, ndryshe nga Canale dhe Swain që përdorën termin ‘kompetenca gramatikore’; së dyti, është përdorur termi ‘kompetenca sociokulturore’, në vend të termit ‘kompetenca sociolinguistike’.

‘Përdorëm termin kompetenca sociokulturore më shumë se sociolinguistike, për ta dalluar më mirë nga kompetencat e të vepruarit (duke qene se dimension i sociolinguistik i kompetencave komunikative ka përfshirë tradicionalisht funksionet kontekstuale të gjuhës), si dhe për të nxjerrë në pah faktin se burimet e gjuhës gjenden në komponentet linguistikë, veprues dhe ligjerim, ndërsa njohuritë sociokulturore janë të nevojshme për shpërndarjen e duhur të burimeve.’ (Celce-Murcia et al. 1995:11)

Në këtë model, paraqitur në Figura 5, duket qartë se kompetencat komunikative janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, shigjetat tregojnë ndërveprimin e tyre. Në qendër të modelit është *kompetenca e ligjërimit*, më e rëndësishmja, që i jep formë modelit dhe përbëhet nga *kompetenca linguistike* (elementet bazë të komunikimit: struktura e fjalive,

elementet fonetikë, sistemi ortografik etj.; *kompetenca sociokulturore* (aftësia për të transmetuar mesazhe brenda kontekstit social dhe kulturor, në përputhje me faktorët pragmatikorë, të lidhur me variacionet në përdorimin e gjuhës; *kompetenca e veprimit* (që përcjell kuptimin dhe qëllimin e komunikimit). Së fundmi, *kompetenca strategjike* (njohuri të strategjive të komunikimit dhe si të përdorimit të tyre) lidh të gjithë komponentët së bashku (Celce-Murcia, 1995:11-26). Ky model u rindërtua nga Celce-Murcia (2007), duke përfshirë kompetencën e ndërveprimit. Kjo kompetencë është e përbërë nga tre nën-kompetenca: *kompetenca e veprimit* (Celce-Murcia et al. (1995); *kompetenca bisedore* (përkthyer nga Sachs et.al (1974); *kompetenca joverbale/paralingvistike*. Gjithashtu, këtij modeli iu shtua kompetenca *idiomatike dhe e shprehjeve*, e cila u referohet shprehjeve të ngulitura që përdoren gjatë ndërveprimit të përditshëm. (Celca-Murcia, 2007:48)




Figura 6. Skema e rishikuar e ‘kompetencave komunikative’ (Celca-Murcia., 2007:45)

Në vitin 1986, Van Ek, në ‘*Objectives of Foreign Language Learning*’ në kapitullin e 6 ‘*A framework for comprehensive FLL Objective*’, bën një ndarje të ‘aftësive komunikative’

Në modelin e tij ai paraqet aspekte si: kompetenca sociale, nxitja e autonomisë ose zhvillimi i përgjegjësiwe sociale. Në modelin e paraqitur nga Van Ek (1986), përfshihen elemente socialë dhe kulturorë. Në krahasim me modelet e mëparshme, është shtuar kompetenca sociokulturore dhe sociale. Modeli që prezanton ai, është i përbërë nga gjashtë kompetenca: kompetenca gjuhësore, kompetenca sociolinguistike, kompetenca e ligjërimit, kompetenca strategjike, kompetenca sociokulturore, kompetenca sociale (Cit.Byram,M., 1997:9)

1.7. Kompetenca ndërkulturore sipas Kuadrit evropian të referenacve për gjuhët

Në fushën e arsimit, edukimi ndërkulturor ka filluar të luajë një rol të rëndësishëm. Interesi për aspeketet ndërkulturore kanë qënë i pranishëm që nga viti 1980. Në vitin 1989, qeveria japoneze i vuri theksin rëndësisë për të thelluar të kuptuarin ndërkombëtar dhe për të zhvilluar respektin për kulturën dhe gjuhën vendit të tyre. Ligji i arsimit, i hartuar nga autoritet Spanjolle midis viteve 1990-1991, theksoi që përveç se studentët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe shkuajnë një gjuhë, duhet të jenë të aftë për ndërlidhje me individët, duke marrë pjesë në aktivitete në grup e duke mbajtur qëndrime tolerante dhe evituar paragjykimet. (Coperias A, 2007:66)

Janë publikuar një sërë dokumentesh, ndër të cilët më të rëndësishmet janë ato të publikuara nga Këshilli i Evropës. Ky Këshill, që në vitin 1999, ka pasur si synim një shoqëri demokratike, bazuar në mirëkuptimin midis vendeve dhe kulturave të ndryshme. Ai ka indentifikuar mësimin e gjuhës së huaj si një element themelor për civilizimin demokratik. Për këtë, në maj të vitit 1999, u miratua nga Këshilli i Ministrave *‘Deklarta dhe programi mbi arsimin për qytetari demokratike, bazuar në të drejtat dhe*

përgjegjshmëritë për këtë qytetari'. Në këtë dokument shprehen qartë këto synime : t'i bëjë të dyja gjinitë të luajnë një rol aktiv në jetën publike, të aftë të ndikojnë në mënyrë të përgjegjshme në fatin e tyre dhe të shoqërisë; të rrënjosë kulturën e të drejtave të njeriut; të përgatisë individë që të jetojnë në një shoqëri multikulturore dhe të pranojnë ndryshimet në mënyrë të ndërgjegjshme, të ndjeshme, tolerante dhe morale; të forcojë kohezionin social, mirëkuptimin reciprok dhe solidaritetin (Këshilli Evropës:1999).

Një mënyrë e mirë për të transmetuar këto njohuri mbi edukimin e civilizimit demokratik, është pikërisht gjuha e huaj, duke nxitur të kuptuarin ndërkulturor. Mësimi i gjuhës së huaj është një eksperiencë ndërkulturore, ku në mënyrë automatike bëjmë krahasime midis dy kulturave, të cilat shpeshherë janë krahasime paragjyquese, raciste etj. Duke synuar realizimin e katër detyravë të përmendura më sipër, i edukon studentët të pranojnë dhe të respektojnë kultura të tjera. Byram-i thotë: 'Nxënia dhe përdorimi i kompetencës ndërkutlurore janë të domosdoshme për kulturën demokratike dhe kohezionin social' (Byram, 2009:7).

Këshilli i Evropës ka si vizion zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në këto elemente: 1) Të drejtat e njeriut 2) Demokracia 3) Shteti i së drejtës. Të tria këto elemente së bashku ndihmojnë në krijimin e një qytetari demokrat. Të gjithë individët pavarësisht vendit, gjinisë, racës apo grupeve kulturore që u përkasin, duhet të mbrohen dhe respektohen sipas këtyre parimeve (Barret,M., et al., 2013:2). Këto vizione dhe qëllime mund të realizohen, kur njerëzit respektojnë dhe kuptojnë njëri-tjetrin. Për këtë arsye, kompetencat ndërkulturore do të ndihmojnë në arritjen e këtyre objektivave. Kompetencat

ndërkulturore plotësojnë realizimin e të drejtave të njeriut dhe shërbejnë si një katalizator për promovimin e një kulture të bashkëjetesës paqësore dhe harmonike. (UNESCO, 2013:9)

Në vitin 2008, Këshilli i Europës, në *‘White Paper on Intercultural Dialogue “Living Together As Equals in Dignity,”*, thekson që e ardhmja jonë e përbashkët varet nga aftësia për të mbrojtur dhe zhvilluar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës, për të nxitur mirëkuptimin reciprok. Në këtë dokument, duke përmendur kompetencat ndërkulturore si një element të rëndësishëm, që i duhet çdo individ, theksohet:

‘Kompetencat e nevojshme për dialog ndërkulturor nuk përfitohen në mënyrë automatike, ato duhet të mësohen, praktikohen dhe të mbahen gjatë gjithë jetës.’ (White Paper, 2008:29).

Në White Paper, argumentohet se suksesi i dialogëve ndërkulturorë varet nga plotësimi i disa kushteve, një nga të cilat është zotërimi kompetencave ndërkulturore (White Paper, 2008:4). Kuptohet qartë që arsimtarët luajnë një rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e këtyre kompetencave. Në këtë dokument shprehet qartë vendosmëria e Këshillit të Evropës, për të mbështetur zhvillimin e kompetencave ndërkulturore nëpërmjet arsimit. White Paper (2008) deklaron që për të pasur një kontakt dhe dialog ndërkulturor për të nxitur tolerancën, mirëkuptimin, respektin, qytetarin, kompetenca ndërkulturor është kusht bazë. Sipas studimit të kryer për Komisionin Europian *‘Sharing Diversity National Approaches to Intercultural Dialogue in Europe’* (European Commission, 2008:12) dialogu ndërkulturor

është një proces që përfshin një shkëmbim të hapur dhe të respektueshme ose ndërveprim midis individëve, grupeve, dhe organizatave me formim kulturor dhe botëveshtrim të ndryshëm. Midis qëllime kryesore është të zhvillohet një kuptim më të thellë të prespektivave dhe praktikave të ndryshme; për të rritur pjesëmarrjen dhe lirinë e aftësinë për të bërë zgjedhje; për të nxitur barazinë; për të përmirësuar proceset krijuese. (European Commission, 2008:13)

‘Këshilli i Evropës ka si synim të mbetet institucion referimi për nxënien dhe mësimin e kompetencave ndërkulturore dhe do të vazhdojë t’u japë rëndësi këtyre temave’(White Paper, 2008:45). Synimi i *Kuadrit të Përbashkët European* është të tejkalojë çdo pengesë gjuhësore dhe të ndihmojë në hartimin e politikave sa më efikase në lidhje me edukimin. Sot, zhvillimi i kompetencave ndërkulturore shihet si element shumë i rëndësishëm i shoqërisë bashkëkohore. Suksesi i një shoqërie varet shumë nga politikat arsimore që zhvillohen. Për shkak të ndryshimeve shoqërore që kanë ndodhur, nevojitet një sistem arsimor që të përgatisë qytetarë të denjë për të jetuar në një shoqëri multikulturore. Programet dhe ndërmarrjet e Këshillit të Evropës kanë si synim zhvillimin e të kuptuarit të përbashkët, duke i dhënë rëndësinë e duhur kompetencave ndërkulturore si një objektiv i rëndësishëm i reformave arsimore.

Mjedisi i sotëm multikulturor kërkon që kompetencat ndërkulturore të përvetësohen nga çdo individ. Një mjet e mirë është pikërisht gjuha e huaj, që të vë në kontakt direkt me kulturën e huaj. Janë pikërisht mësuesit e këtyre gjuhëve që kryejnë rolin e ndërmjetësuesit ndërmjet dy gjuhëve, duke zbatuar metoda dhe praktika të mësimdhënies në klasë. Roli i

mësuesit si ndërmjetës është themelor. Duke pasur parasysh dimensionin kulturor të gjuhës, mësuesit e gjuhës së huaj duhet të rrisin vetëdijen e studenteve për karakteristikat kulturore dhe t'i përgatitin ata për t'i përvetësuar në takime ndërkulturore (Zarate,G., et al., 2004:219). Mësimi i gjuhës i ndihmon studentët që të shmangin klasifikimin stereotipik të individëve, të pranojnë të tjerët dhe të rritin kuriozitetin për të zbuluar kultura të tjera (White Paper, 2008:29).

Në verën e vitit 2010, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, Thorbjorn Jagland, ngriti një grup të pavarur, 'Group of Eminent Persons', për të bërë hetim rreth rigjallërimit të intolerancës dhe diskriminimit në Europë. (*Living together: Combining diversity and Freedom in 21st –century Europe*). Raporti i komisionit theksoi se në një shoqëri të lirë mund të bashkëjetojnë individë të besimeve, racave, kulturave të ndryshme, nëse biem dakord në një sërë parimesh. Identifikohen edhe aktorët kryesorë që kanë kapacitet të ndryshojnë mënyrën sesi mendojnë njërëzit, për të bashkëjetuar në paqe me njëri-tjetër. Në këtë raport vihet në pah që arsimtarët dhe institucionet arsimore luajnë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e individëve për të qenë aktivë në shoqëri dhe u rekomandohet atyre që të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore si një element thelbësor i kurrikulave mësimore, të ketë rritje të programeve të shkëmbimit të studentëve dhe stafëve edukative. Këshilli i Evropës do të ndihmoj për të jetësuar këto rekomandime,

Komuniteti Evropian ofron programe shkëmbimi ndërmjet studentëve, si psh. programi ERASMUS, që është program shkëmbimi për studentët në universitet. Ekzistenca e programeve të tilla, tregon sesa i rëndësishëm është zhvillimi i kompetencave ndërkulturore, për të përgatitur studentët të aftë për kontakt multikulturor. Këto shkëmbime

kulturore ndihmojnë shumë për të vlerësuar ndryshimet në kulture dhe për të bërë krahasim me kulturën e tyre, duke çuar në krijimin e eksperiencave ndërkulturore. Qëllimet e këtyre programeve është të nxitin mirëkuptim, paqe, demokraci, nëpërmjet mësimit ndërkulturor.

Në dokumentin *‘Opening Conference for the 50th Anniversary of the European Cultural Convention; ‘Wroclaw declaration on fifty years of European Cultural Cooperation’*, theksohet rëndësia e dialogëve ndërkulturorë, shkëmbimeve dhe lëvizjes për mirëkuptim reciprok, duke përqendruar vëmendjen te studentët dhe të rinjtë.

Kuadri Evropian i Përbashkët i Referencës *‘Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment’* (2001:1) ofron një bazë të përbashkët për hartimin e silabulusit të gjuhës së huaj. Ky Kuadër ka një ndikim të madh në shumë vende. Jep orientime për, kurriukla, për programet lëndore, librat shkollore, arsimimin e mësuesve, provimet etj. Përshkruan qartë se çfarë aftësish dhe njohurish nevojiten për të komunikuar në mënyrë efektive, duke përfshirë këtu edhe kontekstin kulturor. Kultura është më shumë e trajtuar tek ‘kompetenca të përgjithshme’. Tsai & Houghton shprehen që të jesh në gjendje që të komunikosh në mënyrën e duhur dhe efektive kërkon që të përvetësosh njohuri-specifike kulturore si prsh. institucionet social, gjuhë, rregulla sociale të atij grupi kulturore etj. gjithashtu edhe njohuri kulturore të përgjithshme që përfshijnë njohuri si të kontrollosh një proces ndërveprim, duke përfshirë të qënurit i vetëdijshëm, të kuptosh pasojat e identifikimit social dhe kategorizimit social (Tsai & Houghton., 2010:42).

Përkufizimi i elementeve të kompetencës ndërkulturore, sipas Këshillit të Evropës, bazohet në modelin Byram. Elementet përbëres të kompetencës ndërkulturore janë njohuritë, aftësitë, qëndërimet së bashku me vlerat që mbart si rezultat i i përkatësisë në një grup social (Byram, et al. 2002). Sipas këndvështrimit të CEFR(2001), mësuesit ndihen kompetent në mësimin e njohurive kulturore (*savior etre*). Por mësuesit kanë nevojë për trajnime për të kuptuar të gjitha kompetencat dhe për t'i përfshirë në klasat e tyre edhe *saviors* të tjerë (Cit. Arabski,J. et al. 2012:29). Një trajtim më i gjerë sesi duhet të zhvillohen kompetencat ndërkulturore e paraqet (Lazar el al. 2007) në librin *Developing and Assessing Intercultural Communicative Competence- A guide to Language Teachers and Teacher Educators*

1.8. Role të reja për mesimin dhe të nxënë të gjuhës së huaj

Byram & Fleming pohon se mësimi i gjuhës është bërë edhe i vështirë edhe i lehtë, pasi ne jemi përmirësuar për të kuptuar natyrën e gjuhës, por kemi kuptuar, gjithashtu, që gjuha është shumë komplekse, si në aspektin e gramatikës, ashtu edhe në lidhje me ndërveprimin e njerëzve që përfshihen në përdorimin e saj. (Byram,M. & Fleming,M., 1998:11)

Metodat për mësimin dhe të nxënë të gjuhës së huaj kanë evoluar shumë. Për të kuptuar ndryshimet që kanë ndodhur, po japim një përmbledhje të metodave të përdorura që në fillim të shek 19-të.

Në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të përdorej metoda gramatikë-përkthim. Ajo përqëndrohej në mësimin e aspekteve gramatikore, në përkthimin e duhur dhe në lexim e letërsisë (Neuner, G., 2003:19) Kjo ishte metoda më e përhapur për mësimin

e gjuhës së huaj në shekullin e 19-të dhe kishte si qëllim kryesor që studentët të mësonin dhe të shkruanin gjuhën e huaj.

Sipas Richards, J.C., & Schmidt, R. metoda gramatikë-përkthim është ‘një metodë e mësimit të gjuhës së huaj ose gjuhës së dytë që përdor përkthimin dhe studimin e gramatikës si një bazë kryesore për mësimëdhënie dhe nxënie. Kjo ishte mënyra tradicionale për të mësuar latinishten dhe greqishten në Evropë. Në shekullin e 19-të, ajo filloi të përdorej për të mësuar gjuhët ‘moderne’, si fërngjisht, gjermanisht, anglisht dhe vazhdon akoma të përdoret në shumë vende. Një leksion tipik përmban paraqitjen e rregullave gramatikore, studimin e fjalëve të reja dhe përkthimin e ushtrimeve. Meqë kjo metodë fokusohej më shumë në lexim sesa në aftësinë për të komunikuar, në shekullin e 19-të, filluan ‘t’i japin më shumë rëndësi mësimit të gjuhës së folur’. (Richards, J.C., & Schmit, R., 2002:252)

Në këtë metodë, rregullat gramatikore shpjgoheshin në gjuhën amtare, fjalori mësohej vetëm me përkthimin në gjuhën amtare dhe fjalitë e ndërtuara përmbanin vetëm fjalorin dhe gramatikën e mësuar. (Cook, G., 2003:32)

Pas kritikës së kësaj metode filloi të përdorej *metoda natyrale* ose përqsja natyrale. Shumë linguistë besonin se gjuha duhet të mësohet në mënyrë natyrale ashtu siç mësojnë gjuhën fëmijët. Kjo metodë kishte si synim: përdorimin e gjuhës së folur; përdorimin e objekteve dhe veprimeve në mësimin e fjalëve dhe strukturave të reja; nevojën për ta bërë mësimdhënien e gjuhës së huaj që të ndjekë parimet natyrale të nxënies së gjuhës së parë (Cook, G., 2003:38).

Linguistët u orientuan në metoda të reja të mësimin të gjuhës. ‘Metoda direkte është një metodë e mësimdhënies së gjuhës së huaj, sidomos të gjuhëve moderne nëpërmjet dialogjeve, diskutimeve dhe leximeve, pa përdorimin e gjuhës amtare, pa përkthim dhe pa studim të gramatikës formale. Fjalët mësohen me objekte ose piktura ose duke kryer verpime’ (Cit. M.E.S Digumarti Bhaskara Rao, E., 2004:387).

Metoda direkte solli një koncept të ri për mësimin e gjuhës së huaj. Sipas Terell, kjo metodë ka këto përparrësi: vlerëson komunikimin natyral më shumë se studimin formal të gramatikës; është tolerante ndaj gabimeve të nxënësve; thekson rëndësinë e përvetësimit informal të rregullave të gjuhës. (Cit. Cook, G: 2003)

Ndërsa Richard & Rodgers (2001) (Cit. Brandl, 2008) e përshkruajnë parimet e metodës direkte si më poshtë: mësimi në klasë kryet vetëm në gjuhën e synuar; vetëm fjalor dhe fjali mësohej; aftësit e komunikimit oral ndërtohen me kujdes bazuar në pyetje-përgjigje midis mësuesve dhe nxënësve në klasa; gramatika mësohet në mënyrë induktive; pika të reja të mësimdhënies paraqiteshin me gojë; fjalori mësohet duke treguar objekte ose piktura; kurse fjalori abstrakt mësohej duke u shoqëruar me ide; të kuptuarit e të folurit dhe të dëgjuarit të gjuhës; shqiptim korrekt të folurit dhe fjali të sakta gramatikore. (Cit. Brandl, 2008:2-3)

Vite më parë teksti që përdorej në shkollat tona për mësimin e gjuhës angleze ishte *Essential English for Foreign Language Students*. Ky tekst e shumë të tjerë bazohen më shumë në mësimin e fjalorit dhe rregullave gramatikore. Duke ditur qëllimin e mësimin të gjuhës së huaj në atë kohe, mund të themi që kjo metodë ishte e suksesshme pasi i përmbushte kriteret e përcaktuara. Me anë të këtyre metodave nxënësve nuk mësonin të

komunikonin. Tashmë tekstet shkollore të mësimit të gjuhës së huaj janë brenda standarteve të përcaktuar nga Këshilli i Evropës.

Metodat që përdoren në universitet kanë pësuar ndryshime radikale, krahasuar me vitet e mëparshme. Ka rëndësi që në çdo tekst shkollos, në çdo mësim dhe çdo nivel duhet të bëhet krahasim kulturnor duke rritur aftësinë e reflektimit mbi dy kulturat. Pavarësisht ekzistencës së teorive dhe metodave të reja, mund të themi që në klasat tona akoma mbizotërojnë modelet e vjetra të mësimit të gjuhës së huaj. Mënyrat tradicionale të mësimit të gjuhës së huaj nuk nxitin zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Prandaj mbetet detyrë parësore të kërkojmë e të zbatojmë metoda të reja të suksesshme për mësimin e gjuhës së huaj, që të lehtësohet procesi i të nxënësve të studenteve.

Michael Byram (1997), në librin *‘Teaching and assessing intercultural communicative competence’*, jep sugjerime si të zhvillohen kompetencat ndërkulturore, që mund të ndihmojnë pedagogët për të vlerësuar përvetësimin e këtyre kompetencave nga nxënësit dhe studentët.

KAPITULLI II:

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Ky kapitull përmban metodologjinë e studimit. Ai është i organizuar në disa sytha.

2.1. Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë mundësitë e mësimit të gjuhës angleze për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore dhe të identifikojë metodat e suksesshme të mësimeve për zhvillimin e kësaj kompetence në arsimin e lartë.

2.2. Pyetje kërkimore dhe hipotezat

Pyetjet kërkimore:

1. Si konceptohet kompetenca ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze si një gjuhë e huaj në Shqipëri?
2. Cilat janë mundësitë e mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
3. Cilat janë metodat e mësimeve që zhvillojnë kompetencën ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze?
4. Cilat janë metodat e vlerësimit të zhvillimit të kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj?
5. Cilat janë problemet dhe vështirësitë që ndeshin pedagogët në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?

Hipoteza:

1. Kurrikula e gjuhës angleze nuk e parashikon si një rezultat të pritshëm të nxënësve zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.
2. Mësimi i gjuhës angleze është i përqendruar më tepër në zhvillimin e aftësive gjuhësore, sesa në aftësimin për të kuptuar kultura të tjera.
3. Pedagogët e gjuhës angleze nuk janë kualifikuar dhe trajnuar për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

2.3. Metodatat e kërkimit

Studimi bazohet në një metodologji të përzier. Ky është një studim i tipit eksplorues. Ai trajton zhvillimin e kompetencës ndërkulturore nëpërmjet mësimin të gjuhës angleze. Në fakt, kemi të bëjmë me një studim që përshkruan perceptimin e studentëve dhe të pedagogëve për kompetencën ndërkulturore si dhe mënyrat sesi zhvillohet ajo në shkollën e lartë.

Për kryerjen e studimit u përdorën metodatat sasiore dhe cilësore dhe këto teknika: anketimi, fokus grupi, vëzhgimi dhe esetë e studentëve. Përdorimi i këtyre teknikave është parë i nevojshëm për të përballuar gjerësinë e opinioneve, përvojave, dhe praktikave. Përdorimi i disa llojeve të metodave, teknikave dhe i dy grupeve të subjekteve, pedagogë dhe studentë, synon të garantojë vlefshmërinë e rezultateve të studimit.

2.4 Popullata dhe kampioni i pjesëmarrësve në studim

Popullata e studimit përbëhet nga pedagogë dhe studentë të tre institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, që ofrojnë programe për mësimin e gjuhës angleze.

Kampioni i pedagogëve

Pët të përgjedhur kampionin e pedagogëve është përdorur kampionimi jo-probabilitar i volitshëm kjo për disa arsye: 1) studimi është i një shkalle të vogël; 2) kërkuesi kishte burime të kufizuara për të kryer studimin; 3) nga një sondazh paraprak doli se gatishmëria e pedagogëve për të qenë pjesë e studimit ishte e ulët; a) një pjesë e personelit ishte jostabël. Kampioni i volitshëm u gjet si i përshtatshëm edhe pasi synimi i kërkimit ishte të studiohej çështja në thellësi.. Kampioni i pedagogëve përbëhet nga 30 pedagogë, prej të cilëve 23 (76.7%) femra dhe 7 (23.3%) meshkuj. Pjesa më e madhe, 21 pedagogë (70%), kanë gradën master dhe 9 (30%) kanë marrë gradën shkencore "Doktor". Shumica e pedagogëve (40%) kanë 11 deri në 20 vjet punë, 26.7% kanë 6-10 vjet pune, 20% kanë 1 deri në 5 vjet pune, dhe 13.3% punojnë si pedagog mbi 20 vjet (Tabela 1)

Tabela 1. Frekuencat e kohës së punës të pedagogëve të gjuhës angleze

	Frequency	Percent
1-5 vjet	6	20.0
6-10 vjet	8	26.7
11-20 vjet	12	40.0
mbi 20 vjet	4	13.3
Total	30	100.0

Trajtime profesionale kanë marrë vetëm 9 pedagogë. Prej tyre 5 kanë marrë një trajnim 10 orësh dhe 4 mbi 20 orë.

Kampioni i studentëve

Kampioni i studentëve është formuar si një kampionimi jo-probabilitar i volitshëm kjo për disa arsye: 1) studimi është i një shkalle të vogël; 2) kërkuesi kishte burime të kufizuara për të kryer studimin; 3) pjesë e kampionit u bënë studentët që mund të kontaktoheshin. Popullata e këtij studimi, ishin studentët e viteve të para, të dyta dhe të treta të Shkollës së Lartë Private „Hëna e Plotë“ Beder, Universitetit „Aleksandër Moisiu“ Durrës dhe Universitetit „Aleksandër Xhuvani“ Elbasan. Kampioni përbëhet prej 124 studentësh, 96 femra-(77.4%) dhe 28 meshkuj-(22.8%). P Pjesa më e madhe, 47.2%, (42 femra dhe 16 meshkuj) ishin studentë të vitit të parë, 45.5% (47 femra dhe 9 meshkuj) vazhdonin vitin e tretë të studimeve, dhe 7.3% (6 femra dhe 3 meshkuj) ishin studentë të vitit të dytë.

2.5. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave parësore

Ky syth përfshin përshkrimin e instrumenteve të përdorur për mbledhjen e të dhënave. Në studim kemi përdorur pesë instrumente.

Pyetësor për pedagogë

Pyetësor për studentë

Fokus grup me pedagogë

Skedë vëzhgimi

Ese të studentëve

2.5.1. Pyetësor për pedagogë

Pyetësori është përshtatur nga **Sercu,L.** (*Foreign Language Teachers and Intercultural Competence, An international Investigation,2005*). Ky pyetësor është përdorur në shumë vende si Belgjike, Bullgari, Greqi, Meksike, Poloni, Spanjë, Suedi, për të hetuar gatishmërinë që kanë mësuesit për të mësuar kompetencat ndërkulturore. Sercu (2005), pohon se mësuesit janë të gatshëm për ta përfshirë kompetencën ndërkulturore në mësimdhënie, por nuk janë të përgatitur për ta mësuar atë

Pyetësori për pedagogët përmban gjashtë seksione:

Seksioni 1: Të dhënat e përgjithshme

Seksioni 2: Perceptimi i pedagogut për kompetencën ndërkulturore

Seksioni 3: Studentët, gjuha dhe kultura e huaj.

Seksioni 4: Njohja e tyre me kulturën që lidhet me gjuhën angleze.

Seksioni 5: Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj.

Seksioni 6: Mësimdhënia ndërkulturore në gjuhë të huaj.

Seksioni i parë ,‘Të dhënat e përgjithshme’, jep informacion për gjininë, nivelin e arsimimit të pedagogëve, kohëzgjatjen në mësimdhënie, trajnimet për kompetencën kulturore. Ky seksion përmban 6 pyetje.

Seksioni i dytë i pyetësorit, i përqendruar në perceptimin e pedagogut për kompetencën ndërkulturore, përmban 25 pyetje, të cilat kërkojnë informacion për

perceptimin e objektivave në mësimin e gjuhës së huaj, për konceptimin e ‘mësimin të kulturës’ në kontekstin e mësimin të gjuhës së huaj, për shpërndarjen e kohës së mësimdhënies për ‘mësimin e gjuhës’ dhe ‘mësimin e kulturës’..

Seksioni i tretë përmban 12 pyetje për aspekte të ndryshme të të nxënës të gjuhës angleze, më konkretisht për motivimin, për lidhjen e kulturave me gjuhën angleze, për vendet dhe popujt që janë të lidhur më tepër me gjuhën angleze, për kontaktet që kanë studentët me vendin e gjuhës angleze.

Seksioni i katërt ka si objekt njohjen që ka pedagogu për kulturën që lidhet me gjuhën angleze. Ky seksion e kërkon informacionin nëpërmjet 20 pyetjeve për njohjen e vendit, kulturës dhe njerëzve të lidhur me gjuhën angleze, për udhëtimet në vendet ku fitet kjo gjuhë, për kontaktet me kulturën dhe njerëzit e ktyre vendeve.

Seksioni i pestë, nëpërmjet 26 pyetjeve mbledh të dhëna për llojin e aktiviteteve mësimore për kulturën që përdoren gjatë mësimdhënies, për gjerësinë që u jepet aspekteve të veçanta kulturore në të.

Seksioni i gjashtë i kushtohet mësimdhënies ndërkulturore në gjuhën e huaj dhe përmban 12 deklaratë që lidhen me të, për të cilat kërkohet qëndrimi i pedagogut.

2.5.2. Pyetësor për studentë

Pyetësori për studentë përmban gjashtë seksione :

Seksioni 1: Të dhënat e përgjithshme

Seksioni 2: Perceptimi i studentit për kompetencën ndërkulturore

Seksioni 3: Studentët, gjuha dhe kultura e huaj.

Seksioni 4: Njohja e tyre me kulturën e huaj që lidhet me gjuhën angleze.

Seksioni 5: Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj.

Seksioni 6: Mësimdhënia ndërkulturore në gjuhë të huaj.

Të dhënat e përgjithshme kërkohen në *seksionin e parë* dhe japin informacion për gjininë, për vitin e studimit, për për vitet e studimit të gjuhës angleze, për arsyet e studimit të saj. Ky seksion përmban 5 pyetje.

Seksioni i dytë i pyetësorit, i përqendruar në perceptimin e studentit për kompetencën ndërkulturore, përmban 10 pyetje të cilat kërkojnë informacion rreth perceptimit të objektivave për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj dhe për kohën mësimore në dispozicion të mësimin të gjuhës dhe të mësimin të kulturës.

Seksioni i tretë përmban 12 pyetje për aspekte të ndryshme të të nxënies të gjuhës angleze, më konkretisht për motivimin, për lidhjen e kulturave me gjuhën angleze, për vendet dhe popujt që janë të lidhur më tepër me gjuhën angleze, për kontaktet që kanë studentët me to.

Seksioni i katërt trajton njohjen që zotëron studenti për kulturën që lidhet me gjuhën angleze. Ky seksion e kërkon informacionin nëpërmjet 20 pyetjeve për njohjen e vendit, kulturës dhe njerëzve të lidhur me gjuhën angleze, për udhëtimet në këto vende, për kontaktet me kulturën dhe njerëzit e këtyre vendeve.

Seksioni i pestë, nëpërmjet 26 pyetjeve mblidhen të dhëna për llojin e aktiviteteve mësimore për kulturën që përdoren gjatë mësimdhënies, për gjerësinë që u jepet aspekteve të veçanta kulturore në të.

Seksioni i gjashtë i kushtohet mësimdhënies ndërkulturore në gjuhën e huaj dhe përmban 12 deklarata që lidhen me të, për të cilat kërkohet qëndrimi i studentit.

2.5.3. Fokus grup me pedagogë

Fokus grupi me pedagogë është një instrument tjetër i përdorur në studim. Përmes fokus grupit është synuar të mblidhet informacion lidhur me metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimin dhe problematikat në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

Për zhvillimin e fokus grupit është hartuar një pyetësor i përbërë nga dy seksione. Seksioni i parë përmban 7 pyetje që lidhen me metodologjinë e mësimdhënies për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore, ndërsa seksioni i dytë përmban 10 pyetje për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

U organizuan fokus grupe me 10 pedagogë, përkatësisht në secilin institucion.

2.5.4. Skedë vëzhgimi

Skeda e vëzhgimit është një instrument që na ndihmon të vëzhgojmë në kontekstin real veprimtarinë e pedagogut dhe të studentëve për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

2.5.5. Ese të studentëve

Studenteve u është kërkuar të bëjnë një ese me temën “Vështirësitë që kanë në të mësuarit e kulturës së gjuhës angleze”. Studentët e anglishtes duhet të shkruanin atë që mendonin për

vështirësit që kanë pasur gjatë mësimit të kulturës. Në studim paraqiten mendimet më të dobishme, për të ndihmuar pedagogët të njohin se cilat janë vështirësitë që hasin studentët. Kjo vlen gjithashtu për t'i ndihmuar studentët që të kapërcejnë këto vështirësi.

2.6. Realizimi i kërkimit

Pyetjet kërkimore	Metoda e kërkimit	Instrumenti	Realizimi
1.Si konceptualizohet kompetenca ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze si një gjuhë e huaj në Shqipëri?	Anketim	Pyetësor për pedagogun Pyetësor për studentin	Anketimi i pedagogëve Anketimi i studentëve
2.Cilat janë mundësitë e mësimin të gjuhës angleze si gjuhë e huaj për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?	Anketim	Pyetësor për pedagogun Pyetësor për studentin	Anketimi i pedagogëve Anketimi i studentëve
3.Cilat janë metodat e mësimdhënies që zhvillojnë kompetencën ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze?	Fokus grup Vëzhgim Anketim	Skedë e fokus grupit Skedë e vëzhgimit Pyetësor për pedagogun Pyetësor për studentin	Fokus grup me pedagogë Vëzhgimi në orë mësimi
4.Cilat janë metodat e vlerësimit të zhvillimit të kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj?	Fokus grup	Skedë e fokus grupit	Fokus grup me pedagogë
5.Cilat janë problemet dhe vështirësitë që ndeshin pedagogë në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?	Fokus grup	Skedë e fokus grupit	Fokus grup me pedagogë
Hipotezat	Metoda e kërkimit	Instrumenti	Realizimi
1.Kurrikula e gjuhës angleze nuk e parashikon si një rezultat të pritshëm të të nxënës zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.	Anketim	Pyetësor për pedagogun Pyetësor për studentin	Anketimi i pedagogëve Anketimi i studentëve
2.Mësimi i gjuhës angleze është i përqendruar më tepër në zhvillimin e aftësive gjuhësore sesa në aftësimin për të kuptuar kultura të tjera	Anketim Vëzhgim Ese e studentëve	Pyetësor për pedagogun Pyetësor për studentin Skedë e vëzhgimit Ese e studentëve	Anketim i pedagogëve Anketim i studentëve Analizë e esëve të studentëve Vëzhgimi në 10 orë mësimi
3.Pedagogët e gjuhës angleze nuk janë kualifikuar dhe trajnuar për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.	Anketim Fokus grup	Pyetësor për pedagogun Skedë e fokus grupit	Anketim i 10 pedagogëve Fokus grup me pedagogë

2.7. Kufizimet

Para se të prezantojmë gjetjet e këtij studimi, duhen marrë në konsideratë kufizimet e tij.

Së pari, duke qenë se kampioni është i vogël, rezultatet e studimi mund të kenë rendësi vetëm për popullatën e studiuar.

Së dyti, kampioni i pedagogëve është i kufizuar, gjë që kufizon mjaft krahasimin e gjetjeve të studimit me rezultate të tjera jashtë vendit.

Së treti, lidhja e metodave të mësimdhënies me përceptimin e kompetencës ndërkulturore u krye vetëm përmes analizës korrelacionale. Në këto kushte, studiohet vetëm lidhja mes faktorëve, por nuk konstatohen lidhjet shkakësore. Për këtë do të duhet një studim afatgjatë dhe një kampion më i madh.

KAPITULLI III:

GJETJE TË KËRKIMIT DHE ANALIZA E GJETJEVE

3.1 Gjetjet për pedagogët

Për realizimin e qëllimeve të studimit, u aplikuan tre instrumente për pedagogët.

Instrumenti i parë është *pyetësor për pedagogë* i cili mat: (a) përceptimin e objektivave të mësimin të gjuhës angleze nga ana e pedagogëve, (b) përceptimin e pedagogut për kompetencën ndërkulturore, (c) rolin e gjuhës dhe kulturës së huaj në të nxënësit, (d) njohjen me kulturen e huaj dhe rolin e saj në të nxënësit, (e) mësimin e kultures në lëndën e gjuhës së huaj, dhe (f) mësimdhënien ndërkulturore në gjuhën e huaj. Ai përmban 6 seksione.

Përceptimi i pedagogut për kompetencën ndërkulturore përfshin tre faktorë: *informacionin e ofruar në lidhje me kulturën e huaj, zhvillimi i aftësive ndërkulturore dhe kultivimi i tolerancës.*

Seksioni I, *"Studentët, gjuha dhe kultura e huaj"*, mat motivacionin për të mësuar gjuhën e huaj, me 4 pyetje dhe kontaktin me vendin e gjuhës së huaj, me 5 pyetje.

Seksioni II, *"Njohja me kulturen e huaj dhe rolin e saj në të nxënësit"* përbëhet nga tre faktorë: "kultura dhe arsimit", me tre pyetje; "letërsi-histori", me katër pyetje; "vlerat dhe besimet", me tre pyetje. Njëkohësisht, përfshin dhe dy shkallë: shkalla e parë, me katër pyetje, u referohet udhëtimeve për në shtetin që lidhet me gjuhën e huaj, dhe shkalla e dytë, me pesë pyetje, mat kontaktin e studentit me kulturën e huaj.

Seksioni III, "*Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj*", përfshin dy shkallë:

Shkalla "*Aktivitetet mësimore për të njohur kulturën e huaj*" grupon 16 pyetjet për pesë faktorë: (a) tregime në lidhje me kulturën e huaj; (b) komente në lidhje me mënyrën e përfaqësimit të kulturës së huaj në librat e gjuhës; (c) ilustrimi i mësimi me objekte, video, role që lidhen me kulturën e huaj; (d), imazhi gjatë mësimi të gjuhës angleze; (e) komunikimi i përvojave personale gjatë orës së mësimi.

Shkalla "*Aspekte të veçanta kulturore që lidhen me mësimin e gjuhës së huaj*" përmban tre faktorë: "kultura dhe arsimi", "letërsi-histori" dhe "vlerat dhe besimet".

Seksioni IV, "*Mësimdhënia ndërkulturore në gjuhë të huaj*" përbëhet prej katër faktorësh: (a) identiteti kulturor dhe toleranca, me katër pyetje; b) pamundësia e integritetit të mësimdhënies ndërkulturore, me tre pyetje; c) zotërimi i gjuhës së huaj si kusht për mësimdhënien kulturore, me dy pyetje; d) *imazhi pozitiv* i kulturës së huaj. Nuk u përfshi ndër faktorët pohimi "në kontaktet ndërkombëtare keqkuptimet lindin në mënyrë të barabartë si nga dallimet gjuhësore ashtu dhe ato kulturore", pasi vetëm një pyetje për këtë faktor do të kishte shumë pak vlerë.

Të dhënat e shkallës "Përceptimi i objektivave të mësimi të gjuhës së huaj" që dalin prej 8 pyetjesh dhe shkalla Likert, nga 1 deri në 8 (1=aspak i rëndësishëm, 8=shumë i rëndësishëm), pasqyrohen tek seksioni "Rezultatet".

Instrumenti i dytë i përdorur me kampionin e pedagogëve ishte *skeda e vërtetimit*, e cila përshkruan: (a) veprimtarinë e pedagogëve, (b) veprimtarinë e studentëve. Veprimtaria e pedagogëve vërtetohet përmes 17 pyetjeve që vlerësohen në 4 nivele, (1=nuk

demonstrohet dhe... 4=demonstrohet shkëlqyeshëm). Veprimtaria e studentëve vërohet me 13 pyetjesh, me shkallën Likert, (1=nuk demonstrohet dhe... 4=demonstrohet shkëlqyeshëm).

Intrumenti i tretë i përdorur janë *fokus grupet* që janë kryer me pedagogët, të cilat përshkruajnë informacion të mbledhur në lidhje me metodologjin e mësimdhënies dhe me problemet për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

Përpunimi i të dhënave është kryer me paketën statistikore për shkencat sociale (SPSS). Për të përcaktuar vlerat mesatare në perceptimin e pedagogut për objektivat e mësimin dhe kompetencën ndërkulturore, motivacionin e studentit për gjuhën dhe kulturën e huaj sipas mendimit të pedagogut, njohjen e studentit me kulturën e huaj, mësimin e kulturës në lëndën e gjuhës së huaj, dhe mësimdhënien ndërkulturore në gjuhën e huaj, u krye analiza One-sample t-test.

Qëllimi ishte të verifikohet diferenca mes vlerës mesatare të kampionit të pedagogëve dhe vlerës që shënon mesin e shkallës Likert. Gjithashtu, për të studiuar lidhjen e praktikave të mësimin në gjuhën e huaj me kërkesat e renditura më sipër, u krye analiza korrelacioni me kriterin Pearson r.

3.1.1. Përceptimi i pedagogut për kompetencën ndërkulturore

Për të kuptuar sesi pedagogët përceptojnë objektivat e mësimin të gjuhës së huaj u aplikua analiza faktoriale në 8 pyetjet e shkallës "Përceptimi i objektiveve të mësimin të gjuhës së huaj". Konkretisht, sipas kësaj analize del se përceptimi i objektiveve të mësimin të gjuhës së huaj përcaktohet nga tre faktorë, të cilët shpjegojnë 49.6% të variacionit.

Faktori i parë, "Kuptimi i identitet dhe i kulturës së tyre" , me besueshmëri $\alpha=0.60$, përbëhet nga dy pyetje, që shpjegojnë 20.82% të variancës faktoriale.

Faktori i dytë, " Zhvillimi i prirje pozitive drejt kulturave te panjohura", me besueshmëri $\alpha=0.60$, përbëhet nga dy pyetje, që shpjegojnë 15.11% të variancës faktoriale.

*Faktori i tretë, "Familjarizimi me kulturën e huaj", shpjegon 13.69% të variancës, përfshin 3 pyetje dhe ka besueshmëri $\alpha=0.61$. Pyetjet, *Ndihmoj studentët e mi të zotërojnë gjuhën e huaj në atë nivel që do të mund të lexojnë materialet profesionale në atë gjuhë, Ndihmoj studentët e mi të fitojnë jo vetëm aftësi që do të jenë të dobishme në lëndë të tjera dhe në jetë (të tilla si aftësi për të ruajtur në kujtesë, për të sintetizuar, për të bërë formulime të sakta, për të bërë prezantime etj)", por dhe i nxit ata të zotërojnë aftësi të tilla të nxënësve që do t'u mundësojnë të përdorin gjuhën e huaj për qëllime praktike, kishin drejtim negativ gjatë kryerjes së analizës faktoriale, prandaj u bë renditja në drejtim të kundërt, ashtu si pasqyrohet në Tabelën 16. Pyetja 'I nxit studentët të fitojnë aftësi të nxënësve që do të jenë të dobishme për të mësuar gjuhë të huaja të tjera,' nuk u përfshi në tre faktorët pasi vlera eigenvalue që duhet të jetë mbi 40, është e ulët, -0.21**

Tabela 2. Analiza faktoriale e shkallës "Përceptimi i objektivave të mësimit të gjuhës së huaj"

	Faktorët		
	Identiteti	Prirje ndaj kulturave të huaja	Familjar izimi me kulturën e huaj
Ndihmoj studentët e mi të zhvillojnë dhe të kuptojnë më mirë identitetin dhe kulturën e tyre	0.99	0.009	-0.14
Ndihmoj studentët e mi të <i>(jo vetëm)</i> zotërojnë gjuhën e huaj në atë nivel që do të mund të lexojnë materialet profesionale në gjuhë të huaj	0.43	-0.12	0.14
I nxit studentët të jenë mendjehapur dhe të kenë prirje pozitive drejt kulturave të panjohura	0.14	0.98	-0.16

Ndihmoj studentët e mi të fitojnë *(jo vetëm)* aftësi të cilat do të jenë të dobishme në lëndë të tjera dhe në jetë (të tilla si aftësi për të ruajtur në kujtesë, për të sintetizuar, për të bërë formulime të sakta, për të bërë prezantime etj)

-0.21 0.43 -0.26

I nxit studentët të fitojnë aftësi të të nxënit që do të jenë të dobishme për të mësuar gjuhë të huaja të tjera

0.13 -0.21 -0.16

I nxit studentët e mi për të mësuar gjuhë të huaja

0.43 0.14 0.65


Nxit familjarizimin e studentëve të mi me kulturën, qytetërimin e vendeve ku flitet gjuha që ato janë duke mësuar

-0.08 0.38 0.60

I nxit studentët të zotërojnë aftësi të tilla të të nxënit që do t'u mundësojnë të përdorin gjuhën e huaj *(jo vetëm)* për qëllime praktike


0.09 0.08 0.46

Grafiku 1 paraqet vlerat mesatare të faktorëve të shkallës "Përceptimi i objektivave të mësimit të gjuhës së huaj". Analiza me one-sample t-test tregoi që vlera mesatare e faktorit "Identiteti kulturor i studentit" $M=3.1$, $t(29)=2.90$, $p<0.01$ është më e ulët se vlerat mesatare të faktorëve "Prirje pozitive për njohjen e kulturës së huaj" $M=3.78$, $t(29)=-0.73$, $p<0.05$ dhe "Familjarizimi me kulturën e huaj", $M=4.18$, $t(29)=0.59$, $p<0.0$



Grafiku 1. Vlerat mesatare të faktorëve të shkallës " Përceptimi i objektivave të mësimit të gjuhës së huaj

Vlerat mesatare të shkallës "*Mësimi i kulturës*" në kontekstin e mësimit të gjuhës së huaj pasqyrohen në Grafikon 2. Vlera mesatare më e madhe pasqyrohet tek faktori "*Ofrimi i informacionit*" $M=6.14$, $t(n=29)=4.51$, $p<0.001$, një vlerë mbi mesin (5) e shkallës 1 deri në 9, kurse faktorët "*Zhvillimi i aftësisë ndërkulturore*" $M=4.43$, $t(n=29)=-2.04$, $p=0,05$ dhe "*Kultivimi i tolerancës*" $M=4.43$, $t(n=29)=-2.04$, $p=0,05$ kanë një vlerë statistikore më të ulët, nën nivelin mesatar të shkallës renditëse.



Grafiku 2. Vlerat mesatare të faktorëve të shkallës " Përceptimi i objektivave të mësimin të gjuhës së huaj" sipas referimeve të pedagogëve

Të dhënat që paraqiten në grafikun 2, tregojnë që profesorët janë më shumë të përqendruar në ofrimin e informacionit për fusha të ndryshme të kulturës. Ndërkaq, ofrimi i informacionit mbi vendin anglishtfolës nuk ndikon në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Mësimi përmendësh i fakteve mbi këtë vend, nuk çon në zhvillimin dhe rritjen e kompetencës ndërkulturore. Siç pohon edhe Sercu (2005), nuk është ndonjë habi që preferojnë më shumë ofrimin e këtij informacioni, tek studentët, ndoshta kjo është edhe mënyra e vetme me të cilën mund të jenë trajnuar. Pedagogët duhet t'u japin studentëve materiale shtesë për të lexuar dhe të përfshijnë kulturën në provime, në këtë mënyrë studentët do të jenë të motivuar për të kryer kërkime në mënyrë të pavarur. Me ndihmën e pedagogëve, studentët duhet të mësojnë si të reagojnë në situata të ndryshme sociale. është detyrë e pedagogëve të nxitin kuriozitetin e studentëve për gjuhën e synuar, duke përdorur teknika të ndryshme si: dialogje, lojë më role etj.

Liddicoat-i thotë që shumica e studentëve nuk kanë pasur mundësi për të mësuar sesi funksionon kultura e tyre dhe sesi gjuha e pasqyron këtë kulturë, por pa pasur njohuri mbi kulturën amtare është e vështirë të kuptosh një kulturë tjetër.... kontakti me një kulturë tjetër të jep mundësinë e krahasimit me kulturën amtare (Liddicoat,2002:54). Studentët kanë më shumë tendencë të kuptojnë natyrën e gjuhës së huaj, duke bërë krahasim me gjuhën e tyre.

Sipas referimeve të pedagogëve, shumica (80%) deklaroi se mësimi i gjuhës ka përparësi (80% -20% dhe 60%-20%). Prej tyre, 16.7% (5 veta) mendojnë se mësimi i gjuhës zë 100% të kohës në mësimin e gjuhës së huaj. Vetëm një pedagog deklaroi integrim të gjuhës me kulturën (Tabela 3).

Tabela 3. Si është shpërndarë koha e mësimdhënies për "mësimin e gjuhës" dhe "mësimin e kulturës" në lëndën e gjuhës angleze sipas referimeve të pedagogëve

	Frequency	Percent
100% mësim gjuhe - 0% mësim culture	5	16.7
80% mësim gjuhe - 20% mësim kulture	15	50.0
60% mësim gjuhe - 40% mësim kulture	9	30.0
100% integrim i mësimin të gjuhës me kulturën	1	3.3
Total	30	100.0

Shumica e pedagogëve (56.7%) kanë ndjesinë se duhet t'i kushtojnë deri në një farë mase më shumë kohë kulturës së huaj, 6.7% - shumë kohë, 3.3% - paksa dhe një pedagog deklaron "aspak" (Tabela 4).

Tabela 4. Frekuencat e pyetjes "A keni ndjesinë se ju do të donit t'i kushtonit më shumë kohë "mësimit të kulturës" gjatë orëve të mësimit të gjuhës së huaj, por që në njëfarë mënyre ju nuk e keni realizuar atë"?

	Frequency	Percent
Po shumë	2	6.7
Po, deri në një masë të caktuar	17	56.7
Valid Paksa	10	33.3
Jo, aspak	1	3.3
Total	30	100.0

Pyetja e fundit e këtij seksioni është një pyetje e hapur për të shpjeguar arsyet pse nuk i dedikojnë më shumë kohë kulturës. Përgjigjet ishin nga më të ndryshmet. Disa nga më të rëndësishmet janë:

- Kufizime në programin mësimor të lëndës.
- Nuk kam problem në menaxhimin e planit mësimor, por më duhet më shumë kohë për mësimin e gjuhës.

- Një nga arsyet është shpjegimi i gramatikës, ku studentët shqiptarë hasin vështirësi dhe shembujt për ilustrim, nuk kanë në të gjitha rastet elemente që lidhen me kulturën.
- Programi i kurrikulës është menduar të organizohet në aq module që nuk mjafton për një trajtim më të gjerë.
- është e vështirë të mësojnë kulturën, nëse nuk kanë një nivel të mirë të anglishtes.
- Mendoj se studentët e mi mund mos e pëlqejnë mësimin e kulturës.

Këto ishin disa nga problemet që përmendën për vështirësitë e ‘mësimin të kulturës’:

1. *Kufizimi në kurrikula.*, Pedagogët kanë kurrikula që duhet t’i ndjekin dhe në to nuk i jepet shumë kohë trajtimit të aspekteve kulturore. Programet janë të limituar dhe është e vështirë të përfshihet një komponent të ri në program, brenda një kohë sërish të limituar. Kur kanë kohë të lirë, ata dëshirojnë ta përdorin për të përmirësuar ato aspekte ku studentët hasin vështirësi, si p.sh. gramatika, fjalori etj. Në këtë pikë, ndikojnë edhe mangësitë e pedagogëve në organizimin e kohës, në zgjedhjen e metodave dhe zbatimin e programit mësimor të lëndës . Për këtë aspekt mund ta arrijmë në këtë përfundim:
 - a. Pedagogët nuk kanë trajnim të mjaftueshëm për të organizuar një orë mësimi, ku të synohet edhe zhvillimi i kompetencës ndërkulturore.
2. *Mungesë e kohës.*: Pedagogëve u duhen orë shtesë për të gjetur materiale dhe që t’i paraqitin në klasë, pasi materialet e tekstit nuk janë të mjaftueshme.

3. Një tjetër arsye tetër është se në nivelet fillestare dhe mesatare, pedagogët janë më shumë të fokusuar në zhvillimin e aftësive për të folur dhe lexuar gjuhën sipas rregullave gramatikore përkatëse.
4. *Mungesë e interesit* të studenteve për të mësuar kulturën e vendeve anglishtfolëse. Kjo mund të lidhet me frikën e profesorëve për t'u përballuar me qëndrimet negative të studentëve në lidhje me kulturat e tjera, apo mund të shihet nga studentët si kërcënim të kulturës amtare, por edhe me metodologjinë joefikase që mund të përdoret me studentin, duke mos e bërë tërheqës këtë aspekt.

Sipas përgjigjeve të marra, pedagogët arrijnë të kuptojnë rëndësinë e trajtimit të kulturës në klasë, por nuk e integrojnë në programin lëndor për arsyet e përmendura më sipër. Përvoja na bën të mendojmë që studentët nuk kanë vështirësi në mësimin e fjalorit apo gramatikës së gjuhës angleze, vështirësia më e madhe është formimi i fjalive dhe komunikimi brenda kontekstit kulturor. Disa pedagogë janë shprehur që *'studentët duhet të kenë një nivel të kulturës për të filluar mësimin e anglishtes'*, mbështetur në mendimin e autorëve të ndryshëm që kultura duhet të jetë e pranshme që në nivelet fillestare të gjuhës.

'Kultura duhet të mësohet që nga fillimi, sepse është themelore për mësimin e gjuhës së huaj. Nëse kulturën e lemë për më vonë, ata do të kenë krijuar një të kuptuar të kontekstit të gjuhës që po përvetësojnë, një e kuptuar që duhet ta heqin më vonë nga njohuritë që kanë formuar.' (Liddicoat, J., 2001:53)

Nëse studentët nuk kuptojnë kulturën e gjuhës që ata po mësojnë, do të jetë e vështirë për të zgjedhur fjalët sipas kontekst të duhur kulturor. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore nuk është ndonjë listë rregullash që duhet ta mësosh përmendësh, por përvetësohet me trajnimet e duhura.

3.1.2. Studentët, gjuha dhe kultura e huaj sipas referimeve të pedagogëve

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes që lidhet me motivacionin e studentëve për mësimin e gjuhës së huaj, mbi bazën e referimeve të tyre, u kryen analizat e krahasimit të mesatareve me vlerën mesatare të shkallës së renditjes nga një deri në dhjetë (vlera 5), nëpërmjet sample t-testit. Vlera mesatare në total tregon motivacion deri diku mesatar, në nivel statistikor më të lartë se pesa, $M=5.74$, $t(28)$, $t=3.08$, $p<0.01$. Vlera të larta kanë pyetjet "Studentët e mi janë shumë të i motivuar për të mësuar gjuhën angleze", $M=6.87$, $t(28)$, $t=5.36$, $p<0.001$ dhe "Studentët e mi kanë një qëndrim shumë pozitiv ndaj njerëzve të lidhur me gjuhën angleze" $M=6.07$, $t(28)$, $t=2.46$, $p<0.05$ (Tabela 5).

Tabela 5. Vlera mesatare e motivacionit të studentëve për mësimin e gjuhës angleze mbi bazën e referencave të pedagogëve

Pyetjet	Test value=5		
	M	df	t-vlera
1. Studentët e mi janë shumë të i motivuar për të mësuar gjuhën angleze	6.87	29	5.36***
2. Studentët e mi mendojnë se mësimi i gjuhës angleze është shumë i vështirë	4.80	29	-0.47
3. Studentët e mi kanë shumë njohuri në lidhje me kulutrën e gjuhës angleze	5.13	29	0.40
4. Studentët e mi kanë një qëndrim shumë pozitiv ndaj njerëzve të lidhur me gjuhën angleze	6.07	28	2.46*

5. Motivacioni total	5.74	28	3.08**
----------------------	------	----	--------

*Shënim:** $p < 0.05$, ** $p < 0.01$, *** $p < 0.001$, 1=aspak dakord, 10=plotësisht dakord

Sipas referencave të pedagogëve, del që studentët janë mjaft të motivuar për mësimin e gjuhës së huaj.

Në lidhje me kontaktin me vendin e gjuhës së huaj, sample t-testit me vlerë krahasimi $t\text{-test}=2$ del se studentët kanë pak kontakt me vendin e gjuhës angleze. Kontaktit me i pakët u takon udhëtimeve në vendin e huaj, $M=1.63$, $t(29)$, $t=-3.00$, $p < 0.01$ dhe leximit të gazetave e revistave të atij vendit $M=1.77$, $t(29)$, $t=-2.04$, $p < 0.05$. Vlera me e lartë e kontaktit për të mësuar më shumë për vendin e huaj, ka të bëjë me përdorimin e internetit, $M=2.67$, $t(28)$, $t=7.62$, $p < 0.001$. Pyetjet e tjera kanë e vlerësimin "pak herë" (Tabela 6).

Tabela 6. Vlera mesatare në lidhje me kontaktin e studentëve me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e referencave të pedagogëve

Pyetjet	Test value=2		
	M	df	t-vlera
Udhëtojnë në vendin e huaj (pushime me familjen)	1.63	29	-3.00**
Shikojnë një nga kanalet televizive të vendit	2.10	29	1.00
Lexojnë një prej gazetave apo revistave të vendit	1.77	29	-2.04*
Lexojnë literaturë të shkruar nga autorë që jetojnë në vendin e huaj që lidhet me gjuhën angleze, ose me origjinë nga vendi i huaj përkatës	2.33	29	1.88

Përdorin internetin për të mësuar më shumë në lidhje me vendin e huaj	2.67	29	7.62***
KONTAKTI-TOTAL	2.08	29	1.28

*Shënim: *p<0.05, **p<0.01, ***p<0.001, 1=asnjëherë, 3=shpesh herë*

Pedagogët mendojnë që udhëtimet në vendet anglishe janë shumë të pakta. Kjo përgjigje përlligjet edhe ng fakti që Shqipëria nuk është vend i BE-së dhe studentët kanë vështirësi për të marrë vizë në ambasadën amerikane apo angleze. Sipas referimeve të pedagogëve, leximi i gazetave apo revistave të vendit, është në një nivel shumë të ulët 1.77 (gati asnjëherë). Gazetat janë një burim shumë i mirë i informacioneve kulturore, duke na përditësuar me jetën e përditshme në qytet. Përdorimi i internetit, shfaqet me një vlerë më të lartë, pasi studentët shpenzojnë orë të tëra në internet dhe e kanë më të lehtë për të gjetur informacione dhe për të qenë në kontakt me botën e huaj. O'Dowd. R thekson që, ndërpërmjet ndërveprimit online, studentët bëhen të vetëdijshëm që komunikimi në gjuhën e huaj nuk përfshin vetëm shkëmbimin e informacionit, por shpreh edhe identitetin e folësit gjatë zhvillimit të marrëdhënieve në situata të kontaktit ndërkulturor. (O'Dowd. R ,2007:4),

3.1.3. Njohja e pedagogëve me kulturën e huaj

Ky seksion është i rëndësishëm për të kuptuar njohuritë që kanë pedagogët mbi kulturën që lidhet me gjuhën angleze. Sa më shumë informacione të kenë për këtë kulturë, aq më të prirur do të jenë për të pranuar dhe zhvilluar kompetencat ndërkulturore tek studentët. Pedagogëve iu ofruan një serë temash për të zgjedhur alternativën e përshtatshme (1. Shumë, 2. Mjaftueshëm 3. Pak 4. Aspak). Ata njohin më shumë se mjaftueshëm kulturën-

dhe arsimin e vendit të huaj, $M=3.52$, $t(n=30)=17.48$, $p<0,001$ dhe thuajse mjaftueshëm letërsinë, $M=3.32$, $t(n=29)=19.44$, $p<0,001$ dhe vlerat kulturore e besimet, $M=3.23$, $t(n=29)=14.01$, $p<0,001$ (Tabela 7).

Tabela 7. Vlera mesatare e faktorëve në lidhje me njohjen e pedagogëve me vendin e gjuhës angleze

Faktorët	Test value=2		
	M	df	t-vlera
1. Kultura-arsimi	3.52	30	17.48***
2. Letërsia	3.32	29	19.44***
3. Vlerat-besimet	3.23	29	14.02***

Shënim: *** $p<0.001$, 1=aspak, 4=shumë

Nga të dhënat e mbledhura del që pedagogët kanë më shumë se mjaftueshem informacion për: historinë, gjeografinë, sistemin politik, jetën e përditshme, jetën profesionale dhe rutinat, kushtet e jetesës, ushqimin, pijet etj. Kjo është e rëndësishme, sepse tregon që ata janë në gjendje të nxitin debate midis studenteve. Ndërkaq, Liddicoat pohon se nuk mund të mësojmë gjithçka për kulturën, është gati e pamundur të transmetosh diçka kaq komplekse dhe dinamike në klasë. Por ajo që mund të bëjmë është të ndihmojmë studentët për të zhvilluar aftësitë që të gjejnë më shumë për kulturën e synuar. (Liddicoat,2001:45). Të njëjtin mendim kanë edhe autorët Byram dhe Fleming (1995:9) që pedagogët nuk duhet të presin që të dinë dhe të mësojnë gjithçka për një shoqëri specifike dhe kulturën e saj, por të zhvillojnë vetëdijen, aftësitë dhe kompetencat e studenteve në lidhje me ndërveprimin ndërkulturor.

Kjo do të thotë që pedagogët nuk duhet të dinë gjithçka për kulturën e synuar, por të kenë informacione të mjaftueshme për diskutime. Sidoqoftë, nuk duhet harruar që kompetenca ndërkulturore nuk përbehet vetëm nga njohuri, por edhe nga elemente të tjerë, siç e përshkruan Byram-i.

Për sa u përket udhëtimeve për në shtetin e gjuhës së huaj, pedagogët deklarojnë se, në një nivel më të ulët se "pak herë", udhëtojnë në kuadrin e programeve të mobilitetit profesional, $M=1.77$, $t(n=30)=-2.04$, $p=0.05$. Pak herë shkojnë për vizita në vendin e gjuhës së huaj, qofshin ato turistike ($M=2.10$), tek të afërmit ($M=1.83$), ose për kurse gjuhe ($M=2.20$) (Tabela 8).

Tabela 8. Vlera mesatare në lidhje me udhëtimet e pedagogëve për në shtetin e gjuhës së huaj

Pyetjet	Test value=2		
	M	df	t-vlera
1. Për vizitë turistike (që zgjat më shumë se dy ditë) në vend të huaj	2.10	30	0.83
2. Për vizita te të afërmit apo miqtë	1.83	30	-1.72
3. Për pjesëmarrje në një kurs gjuhe	2.20	30	1.99
4. Në kuadrin e programeve të mobilitetit të studentëve	1.77	30	-2.04*
5. Udhëtime total	1.98	30	-.320

Shënim: * $p=0.05$, 1=asnjëherë, 3=shpesh herë

Duke jetuar në një vend me standard të ulët jetese, udhëtimet në vendet anglishtfolëse nuk janë të shpeshta dhe herë herë gati të ralla. Vizita pune, në kuadër të një projekti mobiliteti janë të pakta. Kjo ka të bëjë edhe me politikat arsimore në vendin tonë, që nuk ofrojnë shumë projekte mobiliteti. Pra, në kushtet tona, pedagogët nuk kanë shumë mundësi të udhëtojnë jashtë për të marrë eksperiencën e duhur për kulturën e synuar. Studimet jashtë, trajnimitet, programet e shkëmbimit u ofrojnë mundësi atyre, jo vetëm të mësojnë për kultura të tjera, por edhe të ‘shohin’ kulturën e tyre me sy krahasues. (Stacy,J., 2014:188). Pjesëmarrja në këto aktivitete do t’i ndihmonte shumë pedagogët të bënin analiza dhe të reflektonin, duke arritur në përfundime që t’i përdornin në punë dhe të rritnin kështu zhvillimin e tyre profesional.

‘Mësuesve të gjuhëve të huaja nuk u nevojiten më shumë njohuri për vendin apo kulturën, por aftësi për të krijuar një atmosferë në klasë që lejon studentët që të diskutojnë për tema të jetës së vendit të gjuhës që studiojnë. Këto aftësi zhvillohen më së miri në praktikë dhe reflektim mbi eksperiencën. Mund të gjejnë gjëra të përbashkëta me mësues të tjerë dhe të marrin pjesë në mësimin e eksperiencave që përfshijnë reflektim. (Byram,M., et al. 2002:9)

Përsa u takon kontakteve kulturore shkencore me shtetin e gjuhës së huaj, pedagogët deklarojnë se vlerën më të madhe për ta e ka kontakti me median (shpesh herë), $M=2.79$, $t(n=29)=8.69$ $p<0.001$. Pak herë ky kontakti realizohet mes vizitave në institucione kulturore të vendit të huaj në Shqipëri, mes takimeve me njerëz nga vendi i huaj që jetojnë në Shqipëri, me pedagogë ose studentë të huaj që vijnë në universitet ose me asistentë anglezë që vizitojnë universitetin (Tabela 9).

Tabela 9. Vlera mesatare në lidhje kontakte kulturore-shkencore të pedagogëve me shtetin e gjuhës së huaj

Pyetjet	Test value=2		
	M	df	t-vlera
1. Kontakt me median (nepërmjet gazetave,televizionit,radios)	2.79	29	8.69****
2. Vizitë në institutin kulturor që përfaqëson shtetin e huaj në vendin tim	2.07	29	0.70
3. Kontakte me njerëz me origjinë nga vendi i huaj që jetojnë në vendin tim	2.24	29	1.89
4. Kontakte me asistentë anglezë të gjuhëve të huaja në shkollën time	2.03	29	0.23
5. Kontakte me pedagogë apo studentë të huaj që vizitojnë shkollën time	2.07	29	0.49
6. Kontakte shkencore-kulturore total	2.24	29	3.13**

*Shënim: **p<0.01, ***p<0.001, 1=asnjëherë, 3=shpesh here*

Si rezultat i zhvillimit të teknologjisë, kontaktet me median sot janë lehtësuar shumë. Në rast të munges së udhëtimeve në vendet anglishtfolëse kontakti me gazetatat, televizionet, radiot e mbush këtë boshllëk. Me anë të internetit, informacioni sot mund të merret në kohë rekord nga të gjitha vendet e botës. Ndërkaq, institucionet kulturore që përfaqësojnë vendet anglishtfolëse në Shqipëri janë të pakta.

3.1.4. Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj, sipas pedagogëve

Përsa u përket aktiviteteve për mësimin e kulturës së huaj, pedagogët japin në një nivel të afërt me "shpesh herë" përdorimin e tregimit, $M=2.59$, $t(n=29)=9.96$ $p<0.001$, thuhetse "pak

herë" përvojën personale, $M=2.22$, $t(n=30)=3.07$ $p<0.01$ dhe komentin, $M=2.26$, $t(n=30)=3.97$ $p<0.001$. Në një nivel më të ulët se 'pak herë" përdoret ilustrimi, $M=1.67$, $t(n=30)=-4.49$ $p<0.001$ dhe imazhi, $M=1.84$, $t(n=29)=-2.17$ $p<0.01$ (Tabela 10).

Tabela 10. Vlera mesatare e aktiviteteve të pedagogut për mësimin e kulturës së huaj mbi bazën e referimeve të pedagogëve

Faktorët	Test value=2		
	M	df	t-vlera
1. Tregimi	2.59	29	9.96***
2. Komenti	2.26	30	3.97***
3. Ilustrimi	1.67	30	-4.49***
4. Imazhi	1.84	30	-2.17**
5. Përvoja	2.22	30	3.07**

Shënim: ** $p<0.01$, *** $p<0.001$, 1=asnjëherë, 3=shpesh herë

Nga të dhënat rezulton që tregimi është më i shpeshtë sesa komenti, kurse aktiviteti që nuk zhvillohet gati asnjehere, me 1.67, është ilustrimi (si p.sh përdorimi i videos, internetit, apo sjellja e objekteve me origjinë nga kultura e huaj, pajisjen e klases me objekte te vecanta që i referohen kulturës). Videot/CD janë një burim i mirë vizual i informacioneve kulturore dhe në të njëjtën kohë është edhe më tërheqëse për studentët.

Për aspektet e veçanta kulturore që pedagogët shfrytëzojnë në klasë, analizat t-test me vlerë krahasuese 2 (pak) tregojnë se arsimit, $M=3.53$, $t(n=30)=3.53$, $p<0.001$, dhe

letërsia $M=3.47$, $t(n=30)=3.47$, $p<0.001$, trajtohen më shumë se mjaftueshëm, kurse vlerat dhe besimet drejt nivelit "mjaftueshëm", $M=3.03$, $t(n=30)=10.58$, $p<0.001$ (Tabela 11).

Tabela 11. Vlera mesatare e aspekteve të veçanta kulturore që pedagogu trajton në mësim sipas referimeve të pedagogëve

,Faktorët	Test value=2		
	M	df	t-vlera
1. Kultura-arsimi	3.53	30	27.03***
2. Letërsia	3.47	30	23.67***
3. Vlerat-besimet	3.03	30	10.58***

Shënim: *** $p<0.001$, 1=aspak, 4=shumë

3.1.5. Mësimdhënia ndërkulturore në lëndën e gjuhës së huaj, sipas pedagogëve

Në lidhje me mësimdhënien kulturore, pedagogët janë pjesërisht dakord me identitetin ndërkulturore që arrin tolerancën $M=4.40$, $t(n=29)=20.33$, $p<0.001$, i përcaktuar mirë është mendimi i tyre për imazhin pozitiv, $M=3.30$, $t(n=30)=3.28$, $p<0.01$. Njëkohësisht, deklarojnë se janë pjesërisht kundër mendimit për pamundësinë e integritit të mësimdhënies ndër/re, $M=2.26$, $t(n=30)=-3.28$, $p<0.01$ dhe me faktin që zotërimi i gjuhës së huaj është kusht bazë për mësimdhënien ndërkulturore $M=2.46$, $t(n=30)=-3.90$, $p<0.01$ (Tabela 12).

Tabela 12. Vlera mesatare në lidhje me mësimdhënien kulturore në mësim mbi bazën e referimeve të pedagogëve

Faktorët	Test value=3		
	M	df	t-vlera
1. Identiteti ndërkulturore	4.40	29	20.33***
2. Pamundësia e integritit të mësimdhënies ndër/re	2.26	29	-4.93***
3. Zotërimi i gjuhës së huaj	2.46	30	-3.90**
4. Imazhi pozitiv	3.30	30	3.28**

*Shënim: **p<0.01. ***p<0.001, 1=plotësisht kundër, 5=plotësisht dakord*

Kjo pjesë e pyetësorit është e rëndësishme për të kuptuar sa të predisposuar janë pedagogët për të integruar mësimdhënie ndërkulturore në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Nga përgjigjet shikojmë që pjesa më e madhe e tyre nuk e sheh të vështirë integrimin e kompetencës ndërkulturore, gjë që i bën të jenë të hapur për pranimin e teorive të reja në mësimdhënien ndërkulturore. Përsa i përket imazhit pozitiv ata kanë më shumë një qëndrim të papërcaktuar, ndoshta sepse preferojnë më shumë që studentët të krijojnë një imazh të tyre sesa të ndikojnë me mendimet e tyre tek studentët.

3.1.6. Lidhja e praktikave të mësimin në gjuhën e huaj me perceptimin e pedagogut për kompetencën ndërkulturore.

Praktikat dhe perceptimi i aspekteve të veçanta kulturore në mësimin e gjuhës së huaj. Për të studiuar marrëdhëniet që ekzistojnë midis praktikave të mësimdhënies dhe aspekteve të veçanta kulturore të aplikuara në mësim u krye analiza korrelacionale Pearson r. Nga të

dhënat e tabelës 13, evidentohen koeficientët e korrelacionit midis tre faktorëve, të cilët nuk kanë lidhje statistikore me metodat e mësimdhënies.

Tabela 13. Marrëdhëniet mes praktikës së mësimi të gjuhës së huaj dhe aspekteve të veçanta kulturore (sipas raportimeve të mësuesve)

Aspektet kulturore	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Kultura-arsimi	-0.07	0.32	0.21	0.11	0.11
2. Letërsia	-0.18	-0.08	-0.04	-0.08	0.12
3. Vlerat-besimet	0.01	0.09	0.23	0.17	0.33

Praktikat dhe perceptimi i objektivave të mësimi të gjuhës së huaj. Tregimi, si praktikë e mësimi, ka një lidhje pozitive substanciale me formimin e identitetit kulturor si objektiv e mësimi ($r=0.49$, $p<0.05$). Nuk u konstatuan lidhje të tjera substanciale mes praktikave dhe objektivave të mësimi (Tabela 14).

Tabela 14. Marrëdhëniet mes praktikave të mësimi të gjuhës së huaj dhe perceptimit të objektivave të mësimi të gjuhës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve)

Objektivat e mësimi	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Identiteti kulturor	0.41*	0.23	0.09	0.21	0.04
2. Prirje pozitive ndaj kulturave të huaja	0.24	0.13	0.16	0.19	-0.05
3. Familjarizimi me kulturën e huaj	-0.07	-0.03	0.23	-0.30	-0.18

* $p<0.05$

Praktikat në mësimin e gjuhës së huaj dhe përceptimi i mësimin të kulturës. Praktikat në mësimin e gjuhës së huaj nuk lidhen substancialisht me faktorët që i referohen konceptit të mësimin të kulturës (Tabela 15).

Tabela 15. Marrëdhëniet mes praktikave të mësimin dhe mësimin të kulturës në gjuhën e huaj (sipas raportimeve të pedagogëve)

Mësimi i kulturës	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Ofrimi i informacionit	-0.02	0.02	-0.003	-0.01	0.03
2. Zhvillimi i aftësisë ndërkulturore	0.07	0.05	0.08	0.12	-0.03
3. Kultivimi i tolerancës	0.07	0.05	0.23	0.12	-0.03

Praktikat në mësimin e gjuhës së huaj dhe gjuha-kultura e huaj. Ilustrimi lidhet në mënyrë domethënëse nga ana statistikore me motivacionin e studentit për mësimin e gjuhës së huaj ($r=0.46$, $p<0.05$). Faktorët e tjerë nuk kanë lidhje pozitive mes tyre (Tabela 16).

Tabela 16. Marrëdhëniet mes praktikave të mësimin dhe gjuhës dhe kulturës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve)

Gjuha-kultura e huaj	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Motivacioni	0.12	-0.02	0.46*	-0.07	0.004
2. Kontakti	0.10	0.16	0.21	0.06	0.10

* $p<0.05$

Praktikat e mësimin të gjuhës së huaj dhe njohja me kulturën e huaj.

Kontakti me vendin e gjuhës së huaj lidhet në mënyrë domethënëse pozitivisht nga ana statistikore me përdorimin e tregimit, ($r=0.57$, $p<0.01$), të komentit, ($r=0.40$, $p<0.05$) dhe

ilustrimit, ($r=0.47$, $p<0.01$), në gjuhën e huaj. Gjithashtu, vlerat dhe besimet, ($r=0.45$, $p<0.01$), si dhe udhëtimet, ($r=0.47$, $p<0.01$), lidhen pozitivisht në shkallë mesatare me përvojën. Faktori i njohjes me kulturën e huaj lidhet pozitivisht, në nivel mesatar me tregimin, ($r=0.38$, $p<0.05$), imazhin ($r=0.37$, $p<0.05$) dhe përvojën ($r=0.41$, $p<0.05$), si praktika të mësimin të gjuhës së huaj. Faktorët e tjerë nuk kanë lidhje të rëndësishme statistikore mes tyre (Tabela 17).

Tabela 17. Marrëdhëniet mes praktikave të mësimin dhe njohjes së kulturës së huaj (sipas raportimeve të pedagogëve)

Njohja me kulturën e huaj	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Kultura-arsimi	-0.21	-0.04	-0.27	-0.02	-0.11
2. Letërsia	0.38*	-0.08	-0.14	0.37*	0.41*
3. Vlerat-besimet	-0.15	0.21	0.10	0.05	0.47**
4. Udhëtime	0.11	0.13	0.04	0.14	0.45**
5. Kontakte	0.57**	0.40*	0.47**	0.25	0.28

* $p<0.05$, ** $p<0.01$

Praktikat e mësimin të gjuhës së huaj dhe mësimdhënia ndërkulturore. Të kuptuarit e identitetit ndërkulturore lidhet pozitivisht nga ana statistikore me përdorimin e komentit ($r=0.40$, $p<0.05$). Nga ana tjetër, pamundësia e integritit të mësimdhënies ndërkulturore ($r=-0.40$, $p<0.01$) dhe përparësia në zotërimin e gjuhës së huaj ($r=-0.44$, $p<0.05$) lidhen negativisht në nivel mesatar me komentin. Gjithashtu, krijimi i një imazhi pozitiv të vendit të gjuhës së huaj lidhet negativisht në një nivel mesatar me tregimin ($r=-0.39$, $p<0.05$). Faktorët e tjerë nuk kanë lidhje esenciale statistikore mes tyre (Tabela 18).

Tabela 18. Marrëdhëniet mes praktikave të mësimit dhe gjuhës dhe mësimdhënies ndërkulturore (sipas raportimeve të pedagogëve)

Mësimdhënia ndërkulturore	Tregimi	Komenti	Ilustrimi	Imazhi	Përvoja
1. Identiteti ndërkulturore	0.15	0.40*	0.04	0.12	-0.19
2. Pamundësia e integritit të mësimdhënies ndërkulturore	0.04	-0.40*	-0.16	0.006	0.07
3. Zotërimi i gjuhës së huaj	-0.25	-0.44*	-0.11	-0.15	0.14
4. Imazhi pozitiv	-0.39*	-0.23	-0.30	-0.13	-0.30

* $p < 0.05$, ** $p < 0.01$

3.2. Gjetje nga pyetësi për studentët

Instrumenti për studentët mat: (a) përceptimin e studentit për kompetencën ndërkulturore, (b) rolin e gjuhës dhe kulturës së huaj në të nxënësit, (c) njohjen me kulturen e huaj dhe rolin e saj në të nxënësit, (d) mësimin e kultures në lëndën e gjuhës së huaj, dhe (e) mësimdhënien ndërkulturore në gjuhën e huaj.

Përceptimi i studentit për kompetencën ndërkulturore. "Përceptimi i kompetencës ndërkulturore" nga ana e studentëve matet me 9 pyetje që përdorin shkallën Likert nga 1-9, ku numri 1 i referohet një deklaratë aspak të rëndësishme dhe numri 9 një deklaratë shumë të rëndësishme.

Analiza faktoriale për këtë shkallë konfirmoi ekzistencën e tre faktorëve.

Faktori i parë i referohet informacionit të ofruar në lidhje me kulturën e huaj. Përfshin tre pyetje dhe realibiliteti është $\alpha=.60$.

Faktori i dytë "Zhvillimi i aftësive ndërkulturore" përfshin tre pyetje dhe realibiliteti është $\alpha=.64$. për fleksibilitetin.

Faktori i tretë "Kultivimi i tolerancës" ka realibilitet $\alpha=0.54$ dhe përbehet prej tre pyetjesh (Tabela 19).

Tabela 19. Analiza faktoriale e shkallës "*Përceptimi i kompetencës ndërkulturore*" (N=124)

	Faktor		
	Informacioni	Aftësia ndër/re	Toleranca
Ofron informacion në lidhje me historinë, gjeografinë dhe kushtet politike të kulturës/kulturave të huaja?	0.95	-0.23	0.10
Ofron informacion në lidhje me jetën e përditshme.	0.51	0.09	0.06
Prezanton përvoja me një paraqitje të shumëllojtit kulturore	0.37	0.09	0.09
Zhvillon aftësinë për të trajtuar situatat e kontaktit ndërkulturore	-0.10	0.68	0.00
Nxit të kuptuarit e studentëve për kulturën e tyre.	0.23	0.62	0.04
Nxit ndjenjen e simpatisë për njerëzit e kulturave të tjera	-0.058	0.58	0.06
Kultivon qëndrime të hapjes dhe tolerancës ndaj kulturave të tjera	0.05	0.11	0.77

Ofron informacion për vlerat dhe besimet e përbashkëta	0.40	-0.20	0.48
Nxit reflektim për dallimet kulturore	0.11	0.24	0.25

Nga të dhënat del që edhe për studentët, ashtu si për pedagogët, ofrimi i informacionet mbetet parësor. Siç është përmendur edhe më parë, ofrimi i informacionit konsiderohet më i rëndësishëm se kultivimi i tolerancës.

Roli i gjuhës dhe kulturës së huaj në të nxënit. Seksioni "Studentët, gjuha dhe kultura e huaj" mat motivacionin për të mësuar gjuhën e huaj me 4 pyetje (p.sh. *mësimi i gjuhës angleze nuk është i vështirë, jam i motivuar për të mësuar gjuhën angleze*) dhe besueshmëri $\alpha=.63$. Në këtë seksion matet me 5 pyetje dhe kontakti me vendin e gjuhës së huaj (p.sh. *udhëtoj në vendin e gjuhës së huaj, shikoj kanalet televizive*). besueshmëria ishte $\alpha=.63$.

Njohja me kulturen e huaj dhe rolin e saj në të nxënit. Ky seksion përfshin tre shkallë.

Shkalla e parë i referohet njohjes me vendin dhe kulturën që lidhet me gjuhën e huaj. Analiza faktoriale për këtë shkallë bëhet për tre faktorë:

Faktori i parë "Kultura dhe arsimi" përfshin tre pyetje dhe realibiliteti është $\alpha=.77$.

Faktori i dytë "Letërsi-histori" ka realibilitet $\alpha=0.58$ dhe përbehet prej katër pyetjesh.

Faktori i tretë "Vlerat dhe besimet" përfshin tre pyetje dhe realibiliteti është $\alpha=.54$.

Tabela 20. Analiza faktoriale e shkallës "Sa a njihni vendin e lidhur me gjuhën angleze?"

	Faktorët		
	Kultura	Letërsi	Vlerat
Kultura e rinisë	0.80	0.02	0.14
Arsimi, jeta profesionale	0.63	0.39	0.11
Jeta e përditshme dhe rutinat, kushtet e jetes, ushqimi etj	0.63	0.23	0.22
Letërsi	0.18	0.80	0.25
Histori, gjeografi, sistemi politik	0.05	0.36	0.23
Traditat, folklori, atraksionet turistike	0.27	0.33	0.30
Aspekte të tjera kulturore (letërsi,muzikë,art)	0.18	0.28	0.13
Grupe të ndryshme etnike dhe sociale	0.06	0.21	0.64
Vlerat dhe besimet	0.14	0.22	0.53
Marrëdhëniet ndërkombëtare (politike,ekonomike dhe kulturore) të studentëve të atij vendi me studentët e vendeve të tjera	0.16	0.10	0.33

Nga përgjigjet e studentëve kuptojmë që jeta e përditshme, kultura e rinisë dhe arsimi janë temat më të përmendura në leksion, kjo ndoshta për arsyen se janë temat që gjenden më shumë në librat akademikë.

Shkalla e dytë përmban katër pyetje që u referohen udhëtimeve për në shtetin që lidhet me gjuhën e huaj (p.sh. vizitë turistike, tek të afërmit). Realibiliteti i shkallës është $\alpha=.64$.

Shkalla e tretë, me pesë pyetje dhe realibilitet $\alpha=.60$, mat kontaktin e studentit me kulturën e huaj.

Seksioni V: *Mësimi i kulturës në lëndën e gjuhës së huaj*. Dy shkallët e këtij seksioni që lidhen me mësimin e gjuhës së huaj, janë "*Aktivitetet mësimore për të njohur kulturën e huaj*" dhe "*Aspekte të veçanta kulturore*".

Analiza faktoriale e shkallës "*Aktivitetet mësimore për të njohur kulturën e huaj*" grupon 16 pyetjet në pesë faktorë (Tabela 21).

Faktori i parë, me tre pyetje dhe realibilitet $\alpha=.70$, përshkruan *tregime* në lidhje me kulturën e huaj (p.sh. u tregon studentëve atë që ka lexuar, ose diçka interesante).

Faktori i dytë, me katër pyetje, $\alpha=.71$, u referohet *komenteve* për mënyrën e përfaqësimit të kulturës së huaj në librat e gjuhës angleze.

Faktori i tretë përfshin katër pyetje, $\alpha=.65$, të cilat matin *ilustrimin* e mësimin me objekte, video, role që lidhen me kulturën e huaj.

Faktori i katërt, me tre pyetje, i referohet përdorimit të *imazhit* gjatë mësimin të gjuhës angleze, $\alpha=.55$.

Faktori i pestë me dy pyetje, $\alpha=.50$, i referohet komunikimit të *përvojave* personale gjatë orës së mësimin.

Tabela 21. Analiza faktoriale e shkallës " Aktivitetet mësimore për të njohur kulturën e huaj"

	Faktorët				
	Tregime	Komente	Ilustrime	Imazhi	Përvoja
U tregon studentëve atë që ka dëgjuar ose lexuar në lidhje me vendin apo kulturën e huaj	0.73	0.08	0.06	-0.05	0.12
I pyet studentët të përshkruajnë një aspekt të kulturës së tyre në gjuhën angleze	0.58	0.30	0.14	0.27	0.06
U tregon studentëve diçka interesante ose të çuditshme për kulturën e huaj	0.52	0.26	-0.09	0.16	0.15
Bën komente për mënyrën me të cilën është përfaqësuar kultura e huaj në materialet e gjuhës angleze që përdor në mësim	0.09	0.68	0.18	0.08	0.05

Flet me studentët rreth sterotipave të kulturës, njerëzve të vendit të huaj	0.20	0.61	0.03	0.28	0.02
U kërkon studentëve të krahasojnë një aspekt të kulturës së tyre me atë të kulturës së huaj	0.36	0.49	0.28	0.07	0.22
U kërkon studentëve që në mënyrë të pavarur të hulumtojnë një aspekt të kulturës së huaj	0.32	0.39	0.11	0.10	0.16
Sjell objekte me origjinë nga kultura e huaj në klasë	0.04	0.06	0.70	-0.04	0.25
E dekoron klasën me postera që ilustrojnë aspekte të veçanta të kulturës së huaj	-0.02	0.20	0.53	0.13	0.01
U kërkon studentëve të luajnë role takimi të njerëzve nga kultura të ndryshme	0.27	0.30	0.47	0.12	-0.14
Përdor video, cd room, apo internetin për të ilustruar një aspekt të kulturës së huaj	0.35	-0.17	0.45	0.31	0.05
Fton një person me origjinë nga vendi i huaj në klasë	-0.11	0.13	0.40	0.52	0.03

I nxit studentët të imagjinojnë sikur do jetonin në vendin e huaj	0.21	0.21	-0.02	0.49	0.17
I pyet studentët të mendojnë për imazhin që promovojnë mediat për vendin e huaj	0.36	0.15	0.22	0.43	-0.11
Flet me studentë rreth përvojave personale në vendin e huaj	0.31	0.20	0.15	-0.15	0.66
I pyet studentët për përvojat e tyre në vendin e huaj	0.02	0.11	0.04	0.29	0.51

Aspekte të veçanta kulturore që lidhen me mësimin e gjuhës së huaj. Kjo shkallë përmban tre faktorë: "*Kultura dhe arsimi*", "*Letërsi-histori*" dhe "*Vlerat dhe besimet*".

Seksioni "*Mësimdhënia ndërkulturore në gjuhë të huaj*" është përbërë prej katër faktorësh për të matur disa aspekte të mësimdhënies ndërkulturore (Tabela 22) si: a) *identiteti kulturor* dhe toleranca me katër pyetje, $\alpha=.60$, (p.sh. mesimi i gjuhës së huaj duhet të rritë të kuptuarit e studentëve për identitetin e tyre kulturor, sa më shumë studentë të dinë në lidhje me kulturën e huaj, aq me tolerantë janë ata); b) *pamundësia e integritetit të mësimdhënies* ndërkulturore, me tre pyetje dhe besueshmëri $\alpha=.50$, (p.sh. arsimi rkulturor nuk ka asnjë lloj efekti në qëndrimin e studentëve, është e pamundur të mësohet gjuhën e huaj dhe kulturën e huaj në një mënyrë të integruar); c) *zotërimi i gjuhës së huaj* si kusht për mësimdhënien kulturore me dy pyetje dhe besueshmëri $\alpha=.50$, (p.sh. para se të mësohet kultura apo dimensionin ndërkulturor, studentët duhet të kenë një nivel mjaft të lartë të zotërimit të gjuhës së huaj); d) *imazhi pozitiv* i kulturës së huaj, me dy pyetje dhe besueshmëri $\alpha=.52$, (p.sh. një pedagog i gjuhës së huaj duhet të paraqesë një imazh pozitiv për kulturën dhe shoqërinë e huaj). Pyetja "Në kontaktet ndërkombëtare keqkuptimet lindin në mënyrë të barabartë si nga dallimet gjuhësore ashtu dhe ato kulturore" nuk u përfshi në katër faktorët, pasi vlera që përshin kjo pyetje në faktor është shumë e ulët.

Tabela 22. Analiza faktoriale e shkallës "Mësimdhënia ndërkulturore"

	Faktorët			
	Identiteti kulturor	Mungesa ndërkulturore	Zotërimi i gjuhës	Imazhi pozitiv
Mësimi i gjuhës së huaj duhet të rritë të kuptuarit e studentëve për identitetin e tyre kulturor	0.53	0.01	0.19	0.17
Sa më shumë studentët të dinë për kulturën e huaj, aq më tolerantë janë	0.50	0.10	-0.02	0.09
Çdo lëndë, jo vetëm gjuha e huaj, duhet të zhvillojë kompetencën ndërkulturore	0.49	-0.11	-0.13	0.07
Unë do të doja të zhvilloja aftësitë ndërkulturore me anë të të nxënës	0.42	-0.04	0.19	0.09
<i>Në kontaktet ndërkombëtare keqkuptimet lindin në mënyrë të barabartë, si nga dallimet gjuhësore, ashtu dhe ato kulturore</i>	.270	.072	.237	.230
Arsimi ndërkulturor nuk ka asnjë lloj efekti në qëndrimin e studentëve	0.05	0.58	-0.08	-0.11
është e pamundur të mësohet gjuhën e huaj dhe kulturën e huaj në një mënyrë të integruar	-0.08	0.54	0.13	0.17

Kur numri i orëve të mësimi është i kufizuar, duhet t'i jepet përparësi mësimi të gjuhës, jo të kulturës	0.10	0.30	0.19	- 0.27
Para se të mësohet kultura apo dimension i ndërkulturor, studentët duhet të kenë një nivel mjaft të lartë të zotërimit të gjuhës së huaj	0.10	-0.03	0.61	0.02
Aftësitë ndërkulturore nuk mund të fitohen në shkollë	-0.05	0.37	0.48	- 0.04
Në një klasë të gjuhës së huaj mësimi i kulturës është po aq i rëndësishëm sa mësimi i gjuhës	0.22	-0.04	- 0.01	0.58
Një pedagog i gjuhës së huaj duhet të paraqitë një imazh pozitiv për kulturën dhe shoqërinë e huaj	0.29	0.05	0.08	0.44

Për përpunimi e të dhënave, është përdorur paketa statistikore për shkencat sociale (SPSS). U kryen analiza deskriptive për të përcaktuar vlerat mesatare në: 1. Perceptimin e studentit për kompetencën ndërkulturore, 2. Motivacionin e studentit për gjuhën dhe kulturën e huaj, 3. Njohjen e studentit me kulturën e huaj, 4. Mësimin e kulturës në lëndën e gjuhës së huaj, 5. Mësimdhënien ndërkulturore në gjuhën e huaj. Për të krahasuar variablet e mësipërme mbi bazën e gjinisë, u krye Testi-t për grupet e pavarura. Për të verifikuar se të dhënat plotësonin kushtet për shpërndarjen normale dhe homogjenitetin e variacioneve mes dy grupeve, u përdor Testi i Levene.

3.2.1. Përceptimi i studentit për kompetencën ndërkulturore sipas gjinisë

Për përgjigjen e pyetjes lidhur me konceptin "*mësim i kulturës*", në kontekstin e mësimin të gjuhës së huaj, u kryen analizat e krahasimit të mesatareve nëpërmjet *t-testit*. Vlerat mesatare të notave të vajzave janë në të njëjtin nivel me ato të djemve, si në total, $t(n=124)=-0.86$, $p>0,05$, ashtu dhe në faktorët "*Ofrimi i informacionit*", $t(n=124)=0.04$, $p>0,05$, "*Zhvillimi i aftësisë ndërkulturore*", $t(n=124)=-0.36$, $p>0,05$ dhe "*Kultivimi i tolerancës*", $t(n=124)=1.84$, $p>0,05$. (Tabela 23).

Tabela 23. Vlera mesatare e përceptimit ndërkulturore mbi bazën e gjinisë së studentëve

Faktorët	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Ofrimi i informacionit	5.56	5.55	5.56	0.04
2. Zhvillimi i aftësisë ndërkulturore	5.25	5.36	5.22	-0.36
3. Kultivimi i tolerancës	5.12	4.57	5.29	1.84
4. Total	4.70	4.85	4.65	-0.86

Shënim: 1=aspak e rëndësishme, 9=shumë e rëndësishme

Sipas referimeve të studentëve, vetëm 17.7% e pedagogëve integrojnë mësimin e gjuhës me kulturën, shumica e studentëve deklarojnë se mësimi i gjuhës ka përparësi (80% & 60%). Vetëm 10.5% e studentëve mendojnë se mësimi i kulturës zë 60% të kohës në mësimin e gjuhës së huaj. Nuk u gjetën dallime statistikore në lidhje me gjininë e studentëve (Tabela 24).

Tabela 24. Si është shpërndarë koha e mësimdhënies për "mësimin e gjuhës" dhe "mësimin e kulturës" në lëndën e gjuhës angleze që ju zhvillonin në këtë vit akademik?

	Frequency	Percent
100% mësim gjuhe - 0% mësim kulture	6	4.8
80% mësim gjuhe - 20% mësim kulture	41	33.1
60% mësim gjuhe - 40% mësim kulture	41	33.1
40% mësim gjuhe - 60% mësim kulture	13	10.5
100% integrim i mësimin të gjuhes me kulturën	22	17.7
Total	123	99.2
Missing System	1	.8
Total	124	100.0

3.2.2. Studentët, gjuha dhe kultura e huaj, sipas gjinisë

Për përgjigjen e pyetjes lidhur me motivacionin e mësimin të gjuhës së huaj, u kryen analizat e krahasimit të mesatareve nëpërmjet t-testit. Vlerat mesatare në total tregojnë motivacion të lartë ($M=7.64$) dhe qëndrim pozitiv ($M=7.73$) të studentëve, për të mësuar gjuhën angleze. Njëkohësisht, studentët e konsiderojnë mësimin e gjuhës angleze mjaft të vështirë dhe pohojnë se kanë njohuri të një niveli mesatar njohjeje për kulturën e gjuhës angleze. Nuk ka ndryshime statistikore në të gjitha pyetjet në lidhje me gjininë e studentëve (Tabela 25).

Tabela 25. Vlera mesatare e motivacionit për mësimin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve

Pyetjet	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Unë jam shumë i motivuar për të mësuar gjuhën angleze	7.64	7.79	7.59	-0.33
2. Unë mendoj se mësimi i gjuhës angleze është shumë i vështirë	7.02	7.00	7.03	0.05
3. Unë kam shumë njohuri në lidhje me kulturën e gjuhës angleze	6.03	5.54	6.18	1.41
4. Unë kam një qëndrim shumë pozitiv ndaj njerëzeve të lidhur me gjuhën angleze	7.73	7.82	7.70	-0.23
5. Motivacioni total	7.10	7.04	7.13	0.23

Shënim: 1=aspak dakord, 10=plotësisht dakord

Për sa i takon kontaktit me vendin e gjuhës së huaj, vlerat mesatare tregojnë se studentët përdorin shpesh herë internetin ($M=2.77$) dhe pak herë shikojnë kanale televizive të vendit të gjuhës së huaj ($M=2.47$), lexojnë gazeta ($M=2.19$) ose autorë të huaj ($M=2.29$). Më pak përmendin vizitat në vendin e huaj ($M=1.80$). Analizat e krahasimit të mesatareve nëpërmjet t-testit, tregojnë se femrat kanë kontakt me vendin e gjuhës së huaj më shumë se meshkujt, $t(n=124)=-2.90$, $p<0,01$, udhëtojnë më shumë se ata në vendin e gjuhës së huaj, $t(n=124)=1.97$, $p<0,05$, shikojnë më shumë kanale televizive, $t(n=124)=2.56$, $p<0,05$,

lexojnë më shumë autorë të huaj, $t(n=124)=2.22$, $p<0,05$ dhe përdorin më shumë internetin për të mësuar për vendin e huaj, $t(n=124)=1.97$, $p<0,05$ (Tabela 26).

Tabela 26. Vlera mesatare në lidhje me kontaktin me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve

Pyetjet	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Udhëtoj në vendin e huaj (pushime me familjen)	1.80	1.57	1.86	1.97*
2. Shikoj një nga kanalet televizive të vendit	2.49	2.21	2.57	2.56*
3. Lexoj një prej gazetave apo revistave të vendit	2.16	2.25	2.14	-0.81
4. Lexoj literaturë të shkruar nga autorët që jetojnë në vendin e huaj që lidhet me gjuhën angleze, ose me origjinë nga vendi i huaj përkatës	2.29	2.04	2.35	2.22*
5. Përdor internetin për të mësuar më shumë në lidhje me vendin e huaj	2.77	2.57	2.82	1.97*
6. Kontakti total	1.71	1.66	1.87	-2.90**

Shënim: * $p<0.05$, ** $p<0.01$, 1=asnjëherë, 3=shpesh herë

Udhëtimeve në vendin e huaj (vendet anglishtfolëse) janë shumë e pakta ($M=1.80$), gjë që shpjegohet nga arsye të përmendura pak më parë. Në një nivel të lartë mbetet shikimi i kanaleve TV dhe përdorimi i internetit.

Në një studim të kryer nga Lee (1999), për përdorimin e gazetave dhe chateve online, pohohet se leximi i gazetave në gjuhën e huaj, jo vetëm që ndihmon studentët në

përmirësimin e njohurive për terminologji dhe idioma, por rrit edhe aftësinë për të interpretuar, analizuar dhe vlerësuar tekstin përtej fakteve të thjeshta. Sipas Lee, seksione të ndryshme të gazetës, si 'sporti, ekonomia, arti, argëtim' ofrojnë një mundësi shumë të mirë të krahasimit me gjuhën amtare. (Cit. Tanriverdi,B., & Apak.O., 2008:6)

Në pyetësin që u është shpërndarë studenteve, është parashtruar një pyetje e hapur: *Si do të përshkurani perceptimet dhe idetë tuaja për vendin\vendet dhe njerëzit që lidhen zakonisht me gjuhën angleze?* Studentët kanë dhënë përgjigje si: *njerëz gjakftohtë, mot i zyrtarë, kulturë ndryshe, të shfrenuar etj.* është shumë e rëndësishme të kuptojmë nga u vijnë këto ide studenteve; nga librat, nga tekstet që kanë në librat shkollorë, dhe më pas të shohim mundësinë t'u vëmë përballë situata konkrete.

3.2.3. Njohja me kulturën e huaj, sipas gjinisë

Studentët deklarojnë se vendin e gjuhës angleze, e njohin "mjaftueshëm" mes kulturës-arsimit ($M=2.91$) e letërsisë ($M=2.75$) dhe "pak" mes vlerave kulturore dhe besimeve. Vajzat, më shumë se djemtë njohin vendin e huaj mes kulturës-arsimit $t(n=124)=4.53$, $p<0,001$ dhe letërsisë $t(n=124)=2.90$, $p<0,01$ (Tabela 27).

Tabela 27. Vlera mesatare e faktorëve për njohjen me vendin e gjuhës angleze, mbi bazën e gjinisë së studentëve

Faktorët	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	

1. Kultura-arsimi	2.91	2.51	3.03	4.53***
2. Letërsia-Histori	2.75	2.48	2.83	2.90**
3. Vlerat-besimet	2.51	2.42	2.54	0.93

*Shënim: **p<0.01, ***p<0.001, 1=aspak, 4=shumë*

Duket qartë që vajzat kanë njohuri më shumë se djemtë për vendet e gjuhës angleze, kjo mund të vijë edhe sepse vajzat janë më shumë të predispozuara për të mësuar në krahasim me djemtë.

Për sa u takon udhëtimeve për në shtetin e gjuhës së huaj, studentët deklarojnë pak vizita, ato turistike (M=1.67), tek të afërmit (M=1.84), për kurse gjuhe (M=1.54) ose në kuadrin e mobilitetit të studentëve. Nuk u pasqyruan ndryshime të rëndësishme statistikore në lidhje me gjininë (Tabela 28).

Tabela 28. Vlera mesatare në lidhje me udhëtimet për në shtetin e gjuhës së huaj, mbi bazën e gjinisë së studentëve

Pyetjet	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Për vizitë turistike (që zgjat më shumë se dy ditë) në vend të huaj	1.67	1.64	1.68	0.24
2. Për vizita tek të afërmit apo miqtë	1.84	1.61	1.91	1.87
3. Për pjesëmarrje në një kurs gjuhe	1.54	1.46	1.56	0.62
4. Në kuadrin e programeve të mobilitetit të	1.59	1.57	1.59	0.15

studentëve

5. Udhëtime total	1.66	1.69	1.57	1.17
-------------------	------	------	------	------

Shënim: 1=asnjëherë, 3=shpesh herë

Lidhur me kontaktet kulturore shkencore me shtetin e gjuhës së huaj, studentët deklarojnë pak herë, kontakt me median (M=2.34), me njerëz nga vendi i huaj që jetojnë në Shqipëri (M=2.23), me pedagogë ose studentë të huaj që vijnë në universitet (2.22) ose me asistentë anglezë që vizitojnë universitetin (M=2.0). Nuk u pasqyruan ndryshime të rëndësishme statistikore në lidhje me gjininë (Tabela 29). Shkëmbimi apo mobiliteti i studenteve në kuadër të programeve të mobiliteti i ofron studenteve mundësi për të përjetuar eksperiencë të formave të ndryshme të ndryshimeve kulturore në jetën e përditshme. Ata përballen me këto ndryshime që në momente e para.

Tabela 29. Vlera mesatare në lidhje me kontakte kulturore-shkencore me vendin e gjuhës angleze mbi bazën e gjinisë së studentëve

Pyetjet	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Kontakt me median (nëpërmjet gazetave,televizionit,radios)	2.34	2.36	2.34	-0.14
2. Vizitë në institutin kulturor që përfaqëson shtetin e huaj në vendin tim	1.63	1.71	1.60	-0.78
3. Kontakte me njerëz me origjinë nga vendi i huaj që jetojnë në vendin tim	2.23	2.11	2.26	1.26

4. Kontakte me asistentë anglezë të gjuhëve të huaja në shkollën time	2.03	2.14	2.00	-0.88
5. Kontakte me pedagogë apo studentë të huaj që vizitojnë shkollën time	2.22	2.04	2.27	1.58
6. Kontakte shkencore-kulturore total	2.09	2.07	2.09	0.24

Shënim: 1=asnjëherë, 3=shpesh herë

3.2.4. Mësimi i kulturës në lendën e gjuhës së huaj sipas gjinisë

Rreth aktiviteteve të pedagogut në klasë, për mësimin e kulturës së huaj, studentët përmendin më shumë tregimin (M=2.47), përvojën personale (M=2.35) dhe komentin (M=2.24). Më pak përdoret ilustrimi (M=1.80) dhe imazhi (M=1.88). Nuk u pasqyruan ndryshime të rëndësishme statistikore në lidhje me gjininë (Tabela 30).

Tabela 30. Vlera mesatare në lidhje me aktivitete e pedagogut për mësimin e kulturës së huaj mbi bazën e gjinisë së studentëve

Faktorët	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Tregimi	2.47	2.50	2.47	-0.32
2. Komenti	2.24	2.25	2.23	-0.16
3. Ilustrimi	1.80	1.87	1.78	-0.91
4. Imazhi	1.88	1.87	1.89	0.21

5. Përvoja	2.35	2.20	2.39	0.76
------------	------	------	------	------

Shënim: 1=asnjëherë, 3=shpesh here

Ndër aspektet e veçanta kulturore, që pedagogu trajton në klasë, studentët deklarojnë në shkallën "mjaftueshëm" ato të kulturës së rinisë (M=3.03) dhe letërsisë (M=2.71). Vlerat dhe besimet shkojnë drejt nivelit "pak" (M=2.50). Nuk u pasqyruan ndryshime të rëndësishme statistikore në lidhje me gjininë (Tabela 31).

Tabela 31. Vlera mesatare e aspekteve të veçanta kulturore, që pedagogu trajton në mësim, mbi bazën e gjinisë së studentëve

Faktorët-aspektet kulturore	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Kultura	3.03	2.87	3.07	1.72
2. Letërsi	2.71	2.58	2.75	1.27
3. Vlerat-besimet	2.50	2.51	2.49	-0.19

Shënim: 1=aspak, 4=shumë

3.2.5. Mësimdhënia ndërkulturore në lendën e gjuhës së huaj, sipas gjinisë

Lidhur me mësimdhënien kulturore, studentët janë pjesërisht dakord me indentitin ndërkulturor që përfshin tolerancën (M=4.03) dhe imazhin pozitiv (M=4.37). Njëkohësisht, deklarojnë se janë pjesërisht dakord me mendimin që zotërimi i gjuhës së huaj është kusht bazë për mësimdhënien ndërkulturore (M=3.62). I papërcaktuar është mendimi për pamundësinë e integritit të mësimdhënies ndërkulturore në mësim (M=3.29). Vajzat më

shumë se djemtë janë dakord me imazhin pozitiv në mësim $t(n=124)=3.77$, $p<0,01$ (Tabela 32).

Tabela 32. Vlera mesatare në lidhje me mësimdhënien kulturore në mësim mbi bazën e gjinisë së studentëve

Faktorët-aspektet	Gjinia			t-vlera (n=124)
	Total	Mashkull	Femër	
	M	M	M	
1. Identiteti ndërkulturor	4.03	3.92	4.06	1.40
2. Pamundësia e integritit të mësimdhënies ndër/re	3.29	3.12	3.34	1.39
3. Zotërimi i gjuhës së huaj	3.62	3.48	3.66	0.95
4. Imazhi pozitiv	4.37	3.92	4.51	3.77**

Shënim: ** $p<0.01$, 1=plotësisht kundër, 5=plotësisht dakord

3.3. Skedat e vrojtimit

Qëllimi i këtij sythi është vlerësimi i mësimit ndërkulturor me burim informacioni skedat e vrojtimit të pedagogëve dhe të studentëve. Skedat e vrojtimit do të përdoren për të shpjeguar dhe interpretuar nivelin e zhvillimit të kompetencës ndërkulturore në klasë. Janë kryer 10 skeda vrojtimi. Qëllimi i këtyre skedave është të vëzhgojmë nëse ato që thonë pedagogët, aktualisht përputhen me atë që realizohet në klasë. Do të paraqesim aktualisht një imazh të qartë sesi zhvillohet në klasa. Skedat e vrojtimit janë subjektive dhe vrojtimi varet nga interpretuesi. Theksojmë këtë fakt, pasi informacioni që vëzhgojmë, mënyra sesi

e interpretojmë dhe e analizojmë na ofron një liri më të madhe krahasuar me pyetësoret. Në realitetin tonë, klasa mbetet ambienti kryesor që krijon mundësitë më të mëdha për të përvetësuar aftësitë nën mbikëqyrjen e pedagogëve dhe për të reflektuar mbi njohuritë dhe aftësitë, vendi ku studentët mund të përvetësojnë njohuri për kompetencën ndërkulturore.

3.3.1. Skeda e vërtetimit të pedagogëve

Skeda e vërtetimit të pedagogëve përbëhet nga 17 lloje veprimtarish , të cilat paraqesin zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në gjuhën angleze. Do të fillojmë me analizën e veprimtarive të skedave të vërtetimit të pedagogëve. Pyetjet maten me shkallën nga 1-4 (Nuk demonstron - Demonstrim i shkëlqyer).

Së pari, do të fokusohem tek veprimtaritë (*Pedagogu korrekton modelet e të folurit*, *Pedagogu korrekton modelet e të shkruarit*), pasi kishin vetëm vlerën katër (demonstrim i shkëlqyeshëm). Në klasë kam vënë re një reagim shumë të mirë nga ana e pedagogëve për të korrigjuar si modelet e të folurit, ashtu edhe të të shkruarit. Këto dy veprimtari lidhen me zhvillimin e kompetencës gjuhësore, dhe, në këtë pikë, niveli i zhvillimit të kompetencës gjuhësore është në shkallën më të lartë. Sigurisht, nuk duhet të harrojmë që të shkruarit dhe të folurit e gjuhës së synuar është dhe ka për të qenë gjithnjë bazë për mësimin e gjuhës së huaj.

Së dyti, do të fokusohem në veprimtaritë që prezantojnë: (a) nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Këto veprimtari përqendrohen në nxitjen e imagjinatës dhe hulumtimit, në role të takimit të njerëzve nga kultura të ndryshme

dhe në përvojën personale. Këto veprimtari i kam vlerësuar me vlerën 3 (demonstrim i mirë)

Pedagogu u kërkon studentëve të luajnë role të takimit të njerezve nga kultura të ndryshme. Pedagogu u kërkon studentëve që në mënyrë të pavarur të hulumtojnë një aspekt të kulturës së huaj.

Pedagogu i pyet studentët për përvojat e tyre në vendin e huaj.

Pedagogu përdor materiale autentike.

Pedagogu u kërkon studentëve të imagjinojnë sikur do të jetonin në vendin e huaj.

Në bazë të vlerësimit të demonstrimit të këtyre veprimtarive arrihet në përfundimin se pedagogët kanë një demonstrim të mirë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve. Nxitja e pjesëmarrjes së studenteve është një element i rëndësishëm për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Për t'i bërë të aftë që të përballojnë eksperiencat ndërkulturore në jetën e përditshme, duhet që pedagogët, nëpërmjet orëve të mësimi, të nxisin imagjinatën e studenteve dhe të hulumtojnë në mënyrë të pavarur për aspekte të ndryshme të kulturës. Të mësuarit ndërkulturore përfshin vëzhgime dhe përshkrime të sjelljeve të kulturës së synuar. Në këtë pikë sugjerohet që pedagogët të fokusohen në 'nxitjen e imagjinatës'. Loja me role është një ndër aktivitetet e rëndësishme, që sugjerohet nga shumë akademikë, dhe një ndër elementet kryesore nga Këshilli i Europës. Loja me role i vë përballë studentët me situata që ata që ndoshta nuk do i kishin imagjinuar më parë. Ajo zhvillon ndjenjën e empatisë dhe përshtatjetes ndërkulturore. Gjatë orëve të mësimi u vu re që pedagogët jepnin tema kulturore për diskutim, që nuk ishin të lidhura me kulturën tonë. Pra, nuk përdorej metoda e krahasimit të gjuhës amtare me gjuhën e synuar. Shumicës së studentëve nuk u është

dhënë më parë mundësia të njohin sesi funksionon kultura e tyre, jo më kultura e synuar. Vihet re mungesa e një elementi shumë të domosdoshëm për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore siç është aftësia për të interpretuar dhe krahasuar një kulturë me një tjetër. Metodatat e krahasimit të kulturës amtare dhe asaj të synuar duhet të jenë më të shpeshta gjatë orëve të mësimi. Është rëndësishme për t'u përmendur që studenteve duhet t'u krijohet mundësia për të reflektuar mbi përvojat e tyre personale, të cilat mund të jenë pozitive apo negative. Gjithashtu, gjetja e materialeve shtesë ndihmon në paraqitjen e dinamikave të reja në klasë, duke ndikuar edhe në rritjen e motivimit të studentëve. Janë pedagogët ata që duhet të jenë në kërkim të materialeve autentike, në mënyrë që t'ua ofrojnë studentëve për të qënë sa më afër kulturës së synuar. Duke qënë se anglishtja ka statusin e gjuhës 'lingua franca', duhet që materialet që sigurohen të mos jenë vetëm për Mbretërinë e Bashkuar, por edhe për vendet e tjera anglishtfolëse dhe, për më tepër, duhet të fokusohen në tema që prekin më së shumti studentët. (Lochtman,K., & Kappel,J., 2008:54)

Së treti, veprimtaria në vijim vlerësojnë 'nxitjen e identiteti kulturore'. Këto veprimtari janë vlerësuar me nivel më të ulët, një demonstrim i zbehtë. Gjatë orëve të mësimi vihet re një tendencë e pedagogëve për të nxitur studentët që të shprehin mendimin e tyre , duke i lënë studentët që të jënë të lirë në dhënien e gjykimeve. Këto veprimtari i kam vlerësuar me vlerën 2 (demonstrim i zbehtë)

Pedagogu nxit ndjenjën e simpatisë me njerëzit te kulturave të tjera

Pedagogu e vë theksin në identitetin kulturor

Pedagogu nxit studentët të jenë mendjehapur dhe të kenë prirje pozitive drejt kulturave të panjohura

Pedagogu mbështet lidhjen linguistike dhe kulturore

Do të sugjeroja këto pika për nxitjen e identitetit kulturore. Një nga elementet e kompetencës ndërkulturore është zhvillimi i qëndrimeve, të qenurit kurioz dhe mendjehapur (Byram, 1997). Do të rekomandoja në lidhje me këto aspekte nxitjen e kuriozitetit dhe pranimin e kulturave të tjera, duke u përqendruar më shumë në krahasimin dhe analizimin e aspekteve pozitive të kulturës së synuar. Një mënyrë e mirë është edhe zhvillimi tek studentë i ndjenjës së empatisë.


Së katërti, veprimtarit e grupuara në ‘familjarizimin me kulturën e huaj’. Është venë re se pedagogët kanë tendence që të transmetojnë njohuri në lidhje me kulturën, qytetërimin e vendeve ku flitet gjuha angleze. Këto dy veprimtari i kam vlerësuar me shkallën 3.

Pedagogu lehtëson ndërveprimin e studentëve

Pedagogu nxit familjarizimin e studentëve me kulturën, qytetërimin e vendeve ku flitet gjuha angleze

Mendoj që këtu është shumë i rëndësishëm roli që merr pedagogu. Roli i pedagogut mund të ndryshojë në varësi të aktiviteteve që kryhen në klasë, në mënyrë që të lehtësojë sa më shumë të jetë e mundur procesin e zhvillimit të kompetencës. Rolet e pedagogut mund të varrojnë si (a) autoritar, (b) nismëtar të aktiviteteve, (c) ndërmjetës etj. Të gjitha këto duhet të synojnë që studenti të analizoj dhe të interpretojë, të kuptojë ndryshimet, të ketë një sens

analitik dhe kritik. Pedagogu duhet të nxisë tek studentët situata me të cilat ata janë të pafamiljarizuar.



Grafiku 3. Skedat e vërtetimit të pedagogëve

3.3.2 Skeda e vërtetimit të studentëve

Skeda e vërtetimit të studentëve përbëhet nga 13 veprimtari që kryejnë studentët, të cilat vërtetohen lidhur me zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në gjuhën angleze. Interpretimi i të dhënave është bërë në grupe si më poshtë:

Së pari, "*Identifikimi i vlerave kulturore*" është grupuar në veprimtari. Niveli i identifikimit i vlerave kulturore është në një shkallë të ulët (Shkalla 2). Për sa u përket materialeve autentike, vihet re që interneti mbetet burimi kryesor për të gjetur informacione. Studentët mund të përdorin burime parësore dhe dytësore në gjuhën e tyre amtare, gjithnjë duke synuar që të sigurojnë njohuri specifike për kulturën tjetër. P.sh. mund të mblidhen fakte

dhe statistika që mund të gjenden në gazeta, në revista periodike për sociologji, në studime kulturore, historike, etj (Nyegorodcew. A., et al. 2011:49). Pra, përveç punës së pedagogut, edhe studenti duhet të kryejë punë individuale.

Studentët identifikojnë vlerat kulturore. Studentët përdorin materiale autentike. Studentët shprehin qëndrim pozitiv ndaj kulturës së huaj.

Së dyti, *'Identifikimi i dallimeve kulturore'* është grupuar në tre pyetje. Në këtë seksion jemi të përqendruar tek njohja e stereotipave. Çdo student në klasë vjen me një imazh të caktuar për kulturën e synuar, ky imazh mund të jetë pozitiv ose negativ. Shumica e imazheve që ata kanë vijnë nga filmat ose nga mediat online, dhe nuk bazohen në burime të sigurta. Për këtë arsye i kam vlerësuar me një demonstrim të zbehtë (shkalla 2).

Studentët bëjnë dallimet kulturore Studentet e demonstrojnë lidhjen e gjuhës me kulturën përkatëse Studentët i njohin stereotipat për kulturën e huaj

Së treti, *'Mendimi në gjuhën e huaj'*,

Në lidhje me këto dy veprimtari, kam vërejtur një përpjekje nga ana e studenteve për t'u shprehur në gjuhën e huaj. Ky është një element i mirë, pasi studentët përpiqen që të përvetësojnë sa më shumë të jetë mundur nga gjuha e huaj. Në këtë seksion i vlerësoj me shkallën 3. Do të sugjeroja zhvillimin e aftësive (skills), që janë: të analizosh, interpretosh dhe të ndërlidhësh (metoda krahasimore); të mendosh në mënyrë kritike (të shohësh dhe interpretosh botën nga një këndvështrim tjetër).

Studentët e shohin veten si përdorues të gjuhës angleze.

Studentët mendojnë në gjuhën angleze.

Së katërti, "*Komentimi i dallimeve kulturore*" Studentët kanë nevojë për zotërimin e disa mënyrave që të jenë në gjendje të analizojnë, të komentojnë dhe të zbulojnë dallimet kulturore. Vura ra që këto elemente ishin të zbehta gjatë orëve të mësimi. Në këtë seksion i vlerësoj me vlerën 2 (demonstrim i zbehtë). Për këtë pjesë do të rekomandoja zhvillimin e qendrimeve, të cilat, siç i kam përmendur edhe tek pjesa teorike më sipër përbehen nga respekti (eliminimi i paragjytimeve); kurioziteti (të kërkojnë në mënyrë të pavarur ndërveprim kulturor dhe ta shohësh si një mundësi shumë të mirë mësimi); që qenë i hapur (të shmangësh gjykimet dhe të kuptosh e të pranosh ndryshimet kulturore); zbulimi (të eksplorojnë përtej zonës tënde kulturore.)

Studentët mbajnë një qëndrim për dallimet kulturore.

Studentët e pranojnë ndryshimin në veten e tyre nëpërmjet ndikimit të gjuhës angleze.

Studentët komentojnë praktikën kulturore.

Së pesti, "*Njohuri lidhur me kulturën e huaj*", në këtë pikë do ta vlerësoj nëse studentët kanë njohuri të përgjithshme mbi kulturën e vendit të gjuhës angleze. Nuk mjafton të kesh disa njohuri mbi jetën e përditshme apo disa informacione faktike mbi kulturën e gjuhës angleze. Kurse, përsa u përket dallimeve kulturore ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës angleze janë në nivel të zbehtë. Në këtë seksion i vlerësoj me vlerën 3. Arsyeja pse i vlerësoj me vlerën 3, nuk është se ata nuk kanë njohuri për kulturën apo nuk njohin

dallimet ndërmjet kulturës amtare dhe gjuhës së synuar, por diskutimet që bëhen në klasë janë të një niveli sipërfaqësor.

Studentët kanë njohuri për kulturën e vendit të gjuhës angleze
 Studentët i njohin dallimet ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës angleze



Grafiku 4. Skedat e vrojtimit të studenteve

3.4. Gjetjet nga fokus grupet

Në këtë fazë të mbledhjes së të dhënave, u është kërkuar 12 pedagogëve të përgjigjen për disa nga pyetjet e mëposhtme. Me anë të këtyre pyetjeve është synuar të njihet më mirë këndvështrimi i pedagogëve për kompetencën ndërkulturore. Në pjesën e parë, në fokusi ka qenë metodologjia e mësimdhënies, ndërsa në pjesën e dytë në fokus kanë qenë problemet për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

Metodologjia e mësimdhënies

1. A keni ndonjë motiv që ju nxit të punoni për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
2. Cilat janë sipas përvojave tuaja metodat më të efektshme për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore? Pse?
3. Cilat nga llojet e detyrave që ju u keni dhënë studentëve, janë më të përshtatshme për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore? Pse?
4. Cilat janë tekstet dhe mjetet mësimore që ju përdorni për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore?
5. Si e vlerësoni zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj?
6. Në ç'raport është vlerësimi i kompetencës ndërkulturore me kompetencën gjuhësore?
7. Cilat janë vështirësitë që ndeshni në vlerësimin e kompetencës ndërkulturore?

Problemet për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore

1. Cilat janë problemet që ju ndeshni në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
2. Cilat janë shkaqet e këtyre problemeve?
3. Çfarë bëni për të kapërcyer problemet dhe vështirësitë që ju ndeshni në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
4. Cilat janë problemet që vëreni te studentët ndaj zhvillimit të kompetencës ndërkulturore?
5. Cilat janë shkaqet e këtyre problemeve?

6. Çfarë bëni që të kapërceni problemet e studentëve për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
7. Përveç punës suaj individuale, nga kush do të prisnit mbështetje për të kapërcyer vështirësitë dhe problemet për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore? Të ç'lloji?
8. Si e vlerësoni trajnimin e deritanishëm për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore?
9. Cilat janë problemet e trajnimit për kompetencën ndërkulturore?
10. Çfarë do të donit të përmbante programi i trajnimit për kompetencën ndërkulturore

Në këtë pjesë të analizës është më e rëndësishme të ndalemi në problemet dhe vështirësitë që hasin pedagogët për kompetencën ndërkulturore. Disa nga vështirësitë, që janë përmendur edhe me parë në pyetësin e pedagogëve, renditen në vijim..

Problemet e pedagogëve

1. Kufizimi në kurrikulat mësimore dhe mungesë e kohës, i kushtohet më shumë mësimi të gjuhës.
2. Mospasja e informacionit të duhur sesi zhvillohet kompetenca ndërkulturore dhe si vlerësohet në klasë. Kjo vjen si rezultat i mospasjes së trajnimit të duhur për kompetencën ndërkulturore. Pedagogët vetë kanë referuar që nuk kanë marrë trajnimin e duhur në lidhje me kompetencën ndërkulturore.
3. Klasa mbetet e vetjma mënyrë e kontaktit me kulturën e huaj dhe nuk ka mundësi të tjera, si prsh. kontakt i drejtpërdrejt me individë të kulturës së synuar.

4. Nevoja e një plani mësimore, ku të përfshihet kompetenca ndërkulturore dhe mungesa e materialeve mësimore. Pedagogët thonë që përgatitja dhe gjetja e materialeve kërkon kohë.

5. Mungon bashkëpunimi me insitucionet e vendeve anglishfolëse.

Problemet e studenteve, sipas referimeve të pedagogëve:

1. Tendenca e përdorimit të njohurive të gjuhës amtare edhe në gjuhën e synuar.
2. Mundësi të limituar për të komunikuar dhe ndërvepruar me individë që u përkasin vendeve anglishtfolëse
3. Mungesa e aftësive praktike; nuk e perceptojnë dot si duhet të reagojnë në një situatë të caktuar, pasi nuk kanë jetuar në ato vende.
4. Materialet shkollore nuk janë të mjaftueshme për të mësuar dhe zotëruar kompetencën ndërkulturore.

Eliminimi i problemeve:

1. Bashkëpunim me institutionet angleze dhe amerikane që ndodhen në Shqipëri.
2. Marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, në kuadër të shkëmbimit të personelit akademik dhe, gjithashtu, edhe programe shkëmbimi për studentët.
3. Akses në përdorimin e bibliotekave të ambasadave për pedagogë dhe studentë.
4. Trajnime specifike për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencës ndërkulturore.

5. Materiale në formën e një libri me tema të ndryshme kulturore, ku të jepej qartë edhe një strukturë vlerësimi.

3.5. Gjetjet nga esetë

7 studentëve iu kërkua që të kryenin një ese me temën *‘Vështirësit që ata hasnin në mësimin e kulturës angleze’*. Me anë të këtyre esëve synohej që studentët të reflektonin mbi të gjitha vështirësitë që ata kanë hasur në mësimin e kulturës së gjuhës së huaj. Bazë për këto reflektime do të ishin situata të ndryshme kulturore që mund të kenë përjetuar ose situata të njohura nga leximi, që mund t’i kenë çuar në paragjykime ose stereotipizime.

Më poshtë paraqiten disa nga mendimet që kanë dhënë studentët, të cilat mund t’u shërbejnë pedagogëve të reflektojnë për këto aspekte dhe të ndihmojnë studentët, duke përdorur metodat e duhura.

Disa pjesë të shkëputura nga esetë e studenteve për vështirësitë kulturore, të cilat mund t’i ndihmojnë pedagogët që të kuptojnë se çfarë mendojnë studentët, po i paraqitim më poshtë.

Eseja 1. ‘Ne jemi një popull konservator, kemi norma dhe vlera të rrënjosura thellë. Shumë aspekte ne nuk arrijmë t’i pranojmë, kjo mund të vijë edhe për shkak se nuk kemi lirinë për të shprehur atë që mendojmë dhe ndiejmë, duke na bërë të varur nga opinioni i të tjerëve. Shpeshherë ne jetojmë dhe bejmë atë që dëshirojnë të tjerët dhe jo atë që duam ne. Ndërsa popullin amerikan e imagjinoj, në bazë të informacioneve që më janë përcjellë, si një popull që respekton kulturat e tjera, më të lirshëm në komunikimi. I imagjinoj njerëz të

lirë për të jetuar dhe vepruar. Kjo më bën të dua të jetoj në një vend të tillë, atë që s'mund ta kemi këtu'

Eseja 2. 'Kur unë flas anglisht kam tendencë të mendoj dhe të formoj fjali duke u nisur nga struktura e shqipes. Anglishtfolësit kanë tendencë të përdorin shumë idioma ose shprehje frazeologjike dhe nuk di si të reagosh në situata të tilla, nëse nuk i di kuptimin. Më kujtohet një rast kur isha me pushime dhe njoha një angleze ...me tha një shprehje 'Break a leg'..nuk arrita ta kuptoj se çfarë donte të më thoshte dhe reagova me habi....pas kësaj situatë më bëri të mendoj që ndoshta situata të tilla do ndeshim në jetë dhe nuk duhet të reagojmë me habi '

Eseja 3. 'Për sa i përket aspekteve kulturore gjithmonë kam qënë e intersuar të di më shumë mbi kulturën e gjuhës që po mësoj. Jam shumë kurioze të di mbi tradita , sjellet, norma etj. Nëse gjatë orës së mësimi do i dedikohej më shumë kohë mësimi të kulturës, do të keni gjithmonë vemendjen dhe dëshirën time për të zbuluar dhe mësuar më shumë'

Eseja 4. 'Të mësosh kulturën e gjuhës angleze më është dukur gjithmonë e vështirë, ndoshta për vetë faktin që gjuha angleze është gjuha mëmë e shumë vendeve si SHBA, Angli, Zelandë e Re etj. Kjo e bën të vështirë të mësosh pasi secili vend ka traditën dhe zakonet e veta që ndryshojnë nga njëri tjetri.'

Eseja 5. 'Çdo vend ka traditat dhe zakonet e tij, shumica e tyre mund të vijnë nga besimi fetar që ne kemi dhe orgjina jonë. Ne kemi shumë ndryshime me vendet anglishtfolëse, ato festojnë festa të cilat ne nuk i kemi në Shqipëri, ndjekin rituale të cilat ne na duken të çuditshme. Të gjitha ato zakone që kanë ata, nuk pranohen nga të gjithë

njerëzit. Mendoj se, sado të përpiqesh që t'i përshtatesh vendit të gjuhës, do mbetet gjithmonë një sfidë e vështirë që mund edhe të çojë në humbjen e zakoneve apo rituleve të kulturës tënde.'

Eseja 6. 'Kultura angleze më është dukur gjithmonë e pasur si në aspektet e letërsisë, muzikës apo artit. Sa më shumë të dimë e të lexojmë, do të na ndihmonte që të bëhemi mendje hapur dhe të edukuar për shoqërinë e sotme'

Eseja 7. 'Sado që ne mësojmë anglisht dhe përpiqemi të flasim si personat që e kanë gjuhë mëmë, përsëri është e vështirë t'i formosh fjalitë si në gjuhën angleze pa iu dhënë atyre format e gjuhës shqipe. Theksi është një tjetër vështirësi, sidomos kur flitet për theksin anglez. Kurse për kulturën angleze vetëm kam lexuar. Më duket e vështirë të flasësh për një kulturë të cilën nuk e ke prekur nga afër apo nuk ke njohur njerëz që vijnë nga ajo kulturë. Më duket një koncept shumë i gjërë e gjithëpërfshirës ky i kulturës.'

Analiza e Eseve: Këto ishin disa nga eset të cilat u zgjodhën për t'u paraqitur në këtë disertacion. Kjo ishte një mënyrë shumë e mirë për t'i vënë studentët të reflektojnë mbi kulturën. Në esen e parë shfaqet që studenti ka një imazh pozitiv për kulturën e gjuhës së synuar dhe bazuar në *Modelin e vazhdimësisë të zhvillimit ndërkulturor* (Hammer 2012) kuptoj që studenti është në fazën e polarizimit duke marrë rolin e gjykuesit për kulturën tonë, duke e konsideruar kulturën e gjuhës së synuar më të mirë. Në këtë pikë roli i pedagogut është të ndihmoj studentin të kaloj dy fazat e polarizimit, të kuptojnë që çdo kulturë është unike, dhe që të shmangin opinionin negativ që kanë për vendin e tij. Në esën e dytë, kuptoj që studenti nuk e ka të mirë formuar 'mendimin në gjuhën angleze'. Një

aspekt i mirë që shfaqet në këtë ese është se studenti tregon nga eksperiencia e tij personale për kulturën e huaj dhe kjo gjë e ka bërë të reflektoj që situata me dallime kulturore mund të ndeshim përditë në jetën tonë. Kjo tregon që studenti është mendjehapur drejt ndryshimeve kulturore që mund të hasi. Eseja e tretë, shoh një interes nga ana e studentit për të mësuar për kulturën e gjuhës së synuar, duke dëshiruar që ti kushtohet më shumë kohë kulturës gjatë orëve të mësimi. Kjo është një pikë pozitive për pedagogët, sa më shumë të interesuar të jenë studentët aq më të lehtë do e kenë për zhvillimin e kësaj kompetence. Eseja e katërt, studentit i duket shumë e vështirë mësimi i kulturës së gjuhës së huaj, në këtë fazë mund të punohet për eliminimin e vështirësive të studentit, duke i mësuar teknika të ndryshme për mësimin e kulturës së gjuhës së synuar. Por, nga ana tjetër shikojmë që studenti është i përgatitur që ekzistojnë ndryshime kulturore ndërmjet dy vendeve. Eseja e pestë, shohim që studenti është në gjendje të dallojë ndryshimet midis kulturës amtare dhe kulturës së synuar, një hap i mirë drejt kompetencës ndërkulturore. Eseja e gjashtë, duke e konsideruar shumë të pasur kulturën e gjuhës së synuar tregon disponibilitet për të mësuar më shumë për kulturën e synuar. Eseja e shtatë, shoh që studenti vetëm ka lexuar mbi kulturën e synuar por nuk është në gjendje të flas. Në këtë aspekt shohim që ka informacion sipërfaqësor në lidhje me kulturën e gjuhës së synuar. Shohim që studenti përpiqet të mendojë në gjuhën e huaj, por e ka të vështirë. Gjithashtu vëjmë re që studenti shpreh mungesë të kontaktit nga afër me kulturën e synuar . Kjo është një disavantazh për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore. Vetëm me anë të këtyre pjesëve të shkëputura nga këto ese arrijmë të kuptojnë mendimet, nëse kanë filluar apo jo procesin e zhvillimit të kompetencës ndërkulturore, nëse po në çfarë fazë janë. Bazuar në këtë informacion të përvetësuar mund të përdorim metoda efektive për studentët

KAPITULLI IV:

MODELE TË ZHVILLIMIT TË KOMPETENCËS

NDËRKULTURORE NËPËRMJET MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE

Bazuar në gjetjet sipas të cilave pedagogët dëshmuar se nuk i referoheshin ndonjë modeli për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore, e gjykoj me vend që të prezantoj disa modele të huaja bashkëkohore që mund të përdoren për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në kontekstin shqiptar. Mendoj se vendosja e këtij kapitulli pas gjetjeve dhe analizës krijon një vijimësi logjike. Gjithashtu, besoj se këto modele do t'u shërbejnë pedagogëve si modele për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore.

4.1. Kuptimi i modeleve të reja

Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore është kuptuar si një proces gradual dhe i pafund, prandaj metodat e nxënies duhet të mundësojnë efekte holistike dhe komplekse. (*Handbook of methodology for Development of Intercultural Competence*)

Zbatimi i kompetencës ndërkulturore nuk do të thotë përdorimi i një metodologjie krejtësisht të re në klasë; mund të përdoren po të njëjtat mënyra dhe praktika që janë përdorur edhe më parë si loja me role, projekte në grup apo në mënyrë individuale, por ajo që do të ndryshojë është roli që i jepet gjuhës në ndërtimin e identiteteve, për të kuptuar dhe ndërmjetësuar ndryshimet kulturore (Coperias, A., 2007:65). Në këtë rast, pedagogu kthehet në rolin e ndërmjetësuesit dhe nuk duhet t'i japë përparësi sasisë së përvetësuar të njohurive të përgjithshme, por zhvillimit të qëndrimeve, aftësive dhe vetëdijes kritike tek

studenti. Detyra e pedagogut nuk është të ofrojë informacion gjithëpërfshirës apo të sjellë në klasë ‘shoqërinë e huaj’ që studentët ta vëzhgojnë, por të zhvillojë tek studentët aftësitë që të rimendojnë për kulturën, vlerat, besimet dhe sjelljet e tyre dhe t’i zbulojnë vetë mbi të tjerët (Coperias, A., 2007:69). Duhet të kuptojmë se metoda më e efektshme është ajo që në qendër studentin.

Materialet akademike nuk duhet të sigurojnë vetëm modele të mira të mësimi të gjuhës, por duhet të nxisin eksplorimin e praktikave kulturore (p.sh. kur janë të përshtatshme ose jo shtrëngimet e duarve ose puthjet. Në Universitet studentët vijnë me një formim të gjithanshëm, ata janë në gjendje të flasin dhe të komunikojnë në gjuhën angleze, sigurisht ata kanë edhe një formim kulturor të përgjithshëm. Synimi i pedagogut është të bëjë një ndërlidhje të këtyre dy njohurive.

Për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore kërkohet që pedagogët të jenë të përditësuar me teknika dhe metoda të reja të edukimit. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore kërkon që pedagogët të ndërmarrin një rol të ri, për kryerjen e të cilit kërkohet që të: zotërojnë aftësi të reja në lidhje me kompetencën ndërkulturore, pedagogu të jetë në rolin e ndërmjetësuesit, të përdorin teknika të reja të vlerësimit të kompetencës ndërkulturore. Këto ndryshime që ndodhin në ditën e sotme, e vijnë pedagogët përballë sfidave të reja.

‘Misioni ynë si mësues të gjuhës së huaj është tashmë më i rëndësishëm se kurrë dhe qëllimi ynë nuk duhet të jetë vetëm të ndihmojmë studentët për të zhvilluar kompetencat linguistike ose komunikative. Kurrikula e gjuhës së huaj duhet të zgjerohet, jo vetëm të përfshijë kompetencën ndërkulturore, por edhe ta bëjë atë objektivin kryesor të gjuhës së huaj’ (Cit. Sadler, 2014:144; Furstenber (2010))

Metodat e reja të mësimit të gjuhës së huaj na bëjnë të reflektojmë se çfarë duhet të futet në një program lëndor të gjuhës së huaj. Sipas Valdes (kultura është e pranishme që në ditën e parë të mësimit të gjuhës së huaj, në mënyrën sesi njerëzit përshëndeten, si takojnë njëri-tjetrin, si i japin dorën apo në gjeste, si përkuljet etj. (Cit. Corbett, 2003:33).

Corbett-i (2003) sugjeron që hartimi dhe ndjekja i këtyre modeleve kërkon njohuri të disa strategjive. Një ndër modelet që mund të zbatohet për krijimin e një klase ndërkulturore, është modeli Nunan (Cit.Corbett, 2003:41), të cilin po e paraqitim më poshtë. Këto ‘detyrë’ ai e ndan në gjashtë përbërës kryesor që janë:

Objektivi – i referohet qëllimit pedagogjik të detyrës. Objektivat e detyrave kulturore përfshijnë një kombinim të zbulimit ndërkulturore dhe zhvillimi gjuhësor. Autori ka dhënë disa shembuj të objektivave që mund të përmbushen nga detyra specifike ndërkulturore. Këto objektiva duhet të fokusohet tek analiza e bidesave që ndodhin në jetën e përditshme, analiza e statusit të një individi, githashtu aftësia për të vëzhguar role të ndryshme gjatë bisedave me gjuhën e synuar; të shqyrtojë sesi pritshmëritë e komuniteti akademik në gjuhën e synuar ndikojnë në gjuhën e përdorur në artikujt kërkimorë dhe ti krahasojë këto pritshmëri; aftësi për të përshkruar dhe shpjeguar karaktersitikat e sjelljes të një komuniteti të caktuar; aftësi për të kuptuar mesazhet që përcillen nëpërmjet imazheve vizuale, tekstet letrare dhe mediat. (Corbett, 2003:41-42)

Input – Input është tekst i shkruar ose i folur i paraqitur për diskutim, ose një imazh për interpretim dhe vlerësim, ose një tekst i medias për analizë. Një formë e input-it në klase janë materialet autentike, si burime të vlefshme për procesin e mësimdhënies. Këto

materiale nuk përdoren në të njëjtën mënyrë nga anëtarët e kulturës mëmë, krahasuar me antarët e kulturës së synuar, por shërbejnë si një dëshmi sesi vepron një kulturë. Nuk është e domosdoshme që të gjitha materialet të jenë autentike. Vete inputi mund të nxitet nga pedagogët, duke bërë një propozim për debat etnografik. (Corbett, 2003:42-43)

Aktivitet – për arritjen e qëllimeve të detyrave ndërkulturore, mund të përdoren aktivitetet komunikative. Studentët tregojnë informacionet e mbledhura në grupe ose në mënyrë individuale dhe mund të diskutojnë e vlerësojnë vëzhgimet dhe gjetjet e tyre. (Corbett, 2003:43)

Roli i studentit\ nxënësit – Ky rol do të ndryshojë nga njëri aktivitet në tjetrin dhe nga njëra fazë në tjetrën. Në hapat e para studentët kanë nevojë për ofrimin e disa udhëzimeve nga mësuesit, ndoshta modele ose shembuj të caktuar për t'u ndihmuar në detyrat e tyre. Pasi fitojnë besimin e duhur, kalojnë në një nivel më të lartë, duke kontribuarit në mënyrë më aktive në zbatimin e detyrave kulturore. (Corbett, 2003:43)

Roli i mësuesve\ pedagogëve – Në fazat e para është detyrë e pedagogut të gjejë materiale, të japë sugjerime dhe të demonstrojë sesi mund të rritet kompetenca ndërkulturore, të sigurojë modele vlerësimi, të tregojë që gjuha mund të përdoret për të zbuluar sjelljet njerëzore. Pozicioni i mësuesit më vonë mund të ndryshojë në varësi të situatës, duke u kthyer thjesht në një ndërmjetës, gjë që varet edhe nga kultura e vendit ku mësuesi punon. (Corbett, 2003:44)

Cilësimet - Detyrat ndërkulturore bëjnë të mundur përfshirjen e një sërë përcaktimesh, si p.sh.: punë individuale, punë në çifte, punë në grupe deri në përfshirjen e

gjithë klasës. Studentëve u ofrohet mundësia për të mësuar si në mënyrë të pavarur, ashtu edhe në grup (Corbett, 2003:45).

Procesin e përvetësimit të kompetencave ndërkulturore, Byram-i e ndan në tri kateogori: klasa, puna në terren dhe të mësuarit në mënyrë të pavarur (Byram, 1997:64-70). Coperias shprehet që në klasë pjesëmarrja e mësusit është e lartë, në punën me terren roli i tij, si një tutor ose udhëzues është më i zbehtë dhe të mësuarit në mënyrë të pavarur është përgjegjësia e studentit. (Coperias, A., 2007:69).

Siç e kemi përmendur edhe më lart, udhëtimet, kurset e gjuhëve të huaja ose programet e shkëmbit janë të limituara, sidomos në Shqipëri. Kjo nuk bën të mundur kontaktin me folës vendas të gjuhës angleze. Të mësuarit ndërkulturore përfshin edhe elementet etnografike, nëpërmjet të cilave vëzhgohen dhe përshkruhen sjelljet e komunitetit. (Corbett, 2003:34).

Autorë të ndryshëm mbështesin idenë që për të mësuar kompetencën ndërkulturore duhet të përvetësohen edhe aftësitë etnografike. Corbett-i sugjeron disa teknika për të nxitur ‘imagjinatën etnografike’. Si të tilla mund të shërbejnë përshkrimet e një antropologu apo të dikujt rjetër, që ka jetuar midis komunitetit si një ‘vëzhgues’ me muaj ose edhe me vite (Corbett,2003:9). Qëllimi nuk është që studentët të bëhen antropologë profesionistë, por të fitojnë disa njohuri mbi teknikat etnografike, të rritin aftësitë zbuluese dhe të mësojnë të vëzhgojnë e të mbledhin të dhëna, duke përfituar, kështu, edhe procesi i mësimi të gjuhëve (Coperias, A., 2007:70). Përfaqja etnografike përmbush disa synime në të mësuarit e gjuhëve nëpërmjet:

- integritet të nxënies linguistike dhe kulturore, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin;
- krahasimit të vetës dhe të tjerëve, për të nxitur reflektimin dhe për të vënë në dyshim kulturën mbizotëruese, në të cilën nxënësit janë socializuar.
- ndryshimit të prespektivës, duke përfshirë procesin psikologjik të socializimit;
- potencialit të mësimdhënies së gjuhës, për të përgatitur student që të komunikojnë me kultura dhe shoqëri të tjera, përveç asaj specifike, që, zakonisht, lidhet me gjuhën që ata po mësojnë. (Cit. nga Corbett, 2003:35, Byram & Fleming, 1998)

Trajnim i konceptit- është një aktivitet për zhvillimin e observimit sistematik, në të cilit caktohet një ngjarje ose një situatë e përditshme për t'u vëzhguar. Aktiviteti duhet të zgjojë tek vëzhguesi sensin për pyetje dhe përgjigje. (Corbett, 2003:107-109)

Lidhjet kulturore – Ky është një aktivitet për të nxitur ndërgjegjësimin kulturor. Në këtë rast, studentët gjejnë informacion sa më të pasur për një temë të caktuar, duke bërë krahasim midis kulturave. Corbett jep një shëmbull mbi një kërkim për ushqimet në Skoci, SHBA dhe Brazil. (Corbett, 2003:109-110)

Etika negative - një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin e karakteristikave kulturore, duke u përqendruar tek 'sjellet që nuk duhet të bësh', pra një udhëzim për 'etikën negative' (Corbett, 2003:110-111)

Incidentet kritike- vijnë si rrjedhojë e ndryshimeve në karakteristikave të komunikimit. Studentëve u parqitet një situatë e imagjinuar ose një eksperience personale, e cila mund të shkaktojë një incident kritik, për këto arsye: krijohet një konflikt mbi vlerat, qëllimet apo kuptimet; zgjidhja e konfliktit nuk është e dukshëm menjëherë, ose është e kundërt; konteksti kulturor i konflikt është i qartë dhe i paraqitur në mënyrë koncize. (Corbett, 2003:111-113)

Disa nga aktivitetet që sugjerohen nga autorët Barrett et al. *Developing Intercultural Competence through Education, Pestalozzi series No. 3, Council of Europe Publishing* (Barrett et al. 2014:41)

Loja me role, stimulimet dhe drama- Të gjitha këto mund të ndihmojnë në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. P.sh. mësuesi mund t'i angazhojë studentët në lojë me role, ku ata duhet të veprojnë dhe reagojnë ndryshe nga normat e standardet e tyre, të zgjidhin probleme, të diskutojnë në grupe nën 'identitetin e ri'. Mund të përforcojnë idenë që, pavarësisht se njerëzit mund të jenë të ndryshëm në çdo aspekt, janë njësoj të vlefshëm si qenie njerëzore. (Barrett et al., 2014:41-42)

Teatri, poezia dhe shkrimet- leximi i literaturës në gjuhën e huaj i ndihmon studentët që të mësojnë shumë, të zbulojnë përvoja që ndoshta nuk do ti ndeshin kurrë, dhe të reflektojnë mbi to. Nga këto aktivitete, bazuar mbi leterësinë, mund të fitojnë njohuri për njerëz që kurrë nuk i kanë takuar e mbi jetë që kurrë nuk i kanë imagjinuar. (Barrett et al., 2014:42)

Filmat dhe tekstet- Shikimi i filmave mund të jetë një vetëreflektim dhe për të zbuluar vende të tjera, si edhe të shkaktojë konflikte dhe tension lidhur me ngjarje të ndryshme, që mund t'i referohen të shkuarës ose të tashmes. Mësuesit mund t'i pyesin studentët për këndvështrimin e tyre në lidhje me ngjarjet. (Barrett et al., 2014:44)

Media sociale dhe mjete të komunikimit online- Interneti është një mundësi shumë e mirë për të shkëmbyer këndvështirje dhe opinione me një grup të madh dhe divers.

Mediat sociale edhe mjete të tjera të komunikimit online ndihmojnë në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. (Barrett et al. 2014:45-47)

4.2. Metodat e mësimdhënies dhe kompetenca ndërkulturore

Në procesin e mëimit të gjuhëve të huaja metodat që përdoren kanë një rëndësi të veçantë. Në mësimdhënien e këtyre gjuhëve, janë bërë ndryshime, duke iu përshtatur më shumë kërkesave të kohës. Synimi është që pedagogët të jenë të përditësuar dhe trajnuar me këto metoda të reja të mësimdhënies. Metodat tradicionale të përdoruar deri më sot kanë rezultuar shumë pak të suksesshme. Në këto metoda në qendër të vëmendjes është mësuesi, ndërsa studenti ka një rol pasiv. Sot, më të suksesshme janë metodat e bashkëpunimit, ku studenti është në qendër të vëmendjes dhe kontribuon për përvetësimin dhe thellimin e njohurive të tij. Pyetja që kanë shumë pedagogë është si të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore. Siç e kemi përmendur, kompetenca ndërkulturore nuk do të thotë transmetim njohurish faktike për vendin tjetër. Nëse pedagogët mendojnë që duke përvetësuar sa më shumë njohuri të përgjithshme mbi kulturën e gjuhës së huaj zhvillohet kompetenca ndërkulturore, atëherë duhet të jenë pedagogët që duhet të ndryshojnë këtë koncept.

Sipas Byram-it, teoria më e mirë është teoria e identitetit social, që shpjegon sesi të kuptojmë të tjerët, sesi njerëzit e një grupi social ndërveprojnë dhe reagojnë ndaj njërezve që u përkasin grupeve sociale të ndryshme. Kjo teori është me shumë interes dhe mund të përdoret me dobi nga pedagogët e gjuhëve të huaja (Byram, 2000:17). Të gjithë studentët, kur mësojnë një gjuhë, kanë në mendjen e tyre një stereotip të vendit të kësaj gjuhe, i cili mund të jetë pozitiv ose negativ (Byram, 2002:36). Stereotipet dhe paragjykimet bazohen në shumë në ndjenja, sesa në arsyetim.

Sipas Byram-it teoria e identitetit social i ndihmon mësuesit për të kuptuar sesi krijohen këto stereotipe dhe sesi funksionon procesi i kategorizimit të njerëzve. Gjithashtu, kjo teori ndihmon studentët të dallojnë identitetin e tyre, të kuptojnë sesi shihen nga të tjerët dhe si ndërveprojnë më ta (Byram, 2000:17).

Siç është e përmendur edhe tek analiza, mendimet që kanë studentët për kulturën angleze, zakonisht bazohen në letërsi, filma apo materiale të para në internet. Është pikërisht detyrë e pedagogut të arrijë të kuptojë këto stereotipe që kanë studentët. Byram-i thekson se, për këtë, gjatë procesit të mësimit, mësuesi duhet të realizojë këto detyra:

1. të ndihmojë nxënësit të kuptojnë sesi të tjerët i shikojnë ata dhe sesi ata i shikojnë të tjetër, sesi perceptimet e tyre ndikohen nga kategorizimet, dhe ndonjëhere edhe nga stereotipizimet;
2. të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se sa perceptimet dhe parashikimet e tyre përputhen me pritshmëritë e njerëzve, sesi antarësimi në një grup të caktuar shoqëror ndikon tek vlerat, besimet dhe sjelljet;
3. t'i ndihmojë të kuptojnë konceptin e ' identitetit social'-, për shëmbull, në formën e identiteti kombëtar- dhe rolin e tij në perceptim dhe përfaqësim. (Byram, 2000:21)

Përsa i përket stereotipizimeve objektivi kryesor është që studentët të vihen përballa situata në të cilën i bën ata reflektojnë sesi i kanë krijuar idetë e stereotipizimit dhe sesi mund të përballojnë kur të ndodhen në situata të tillë. Për këtë rekomandohet debati në klasë që të jenë të aftë të arrijnë në përfundime në mënyrë të pavarur.

Duhet të diskutohen cilat janë arsyet e stereotipizimit dhe se nga krijon, mund të vijnë si rrjedhojë e kulturës familjare, arsimit, internetit, media etj. Duhet të kuptohet nëse këto stereotipizime vijnë si rrjedhojë e eksperiencave personale apo nga atë që kanë dëgjuar nga mediat etj.

Neuner thotë që stereotipet janë gjithmonë të ngarkuar me emocione dhe përfshijnë gjykime. Këto gjykime mund të jenë pozitive: vlerësim dhe admirim, ose negative: paragjykim dhe kundërshtim. Autori flet për orgjinën e stereotipeve të cilat formohen nga faktorë të ndryshëm në nivele të ndryshme: Autori i ka ndarë në nivel socio-politik dhe socio-kulturor që fokusohet më tepër në marrëdhëniet politike midis vendeve; në nivel institucional që do të thotë që institucionet (shkolla, puna etj) dhe ambjentet që e rrethojnë një individ ndikon në imazhin që ata krijojnë për një vend të caktuar; në nivel individual gjithë eksperiencat që ka një individ duke përfshirë këtu njohuri specifike dhe kulturore ndikon në krijimin e imazhit për të tjerë (Neuner, 2012:27). Të gjitha këto imazhe mund të ndryshojnë në varësi të aftësive të individit.

Pedagogët kanë nevojë që të përdorin në klasat e tyre programe lëndore që të ndihmojnë studentët të dallojnë identitetin e tyre dhe të njerëzve të vendeve të tjera. Në programet lëndore duhet të synohet që studentët të arrijnë: të përvetësojnë mënyra sesi të kuptojnë kulturat e tjera; të reflektojnë mbi kulturën amtare; të kenë qëndrime të hapura kundrejt eksperiencave të të tjerëve dhe mënyrën e interpretimit të botës; të rivlerësojnë eksperiencën e tyre dhe interpretimin e botës (Byram.M., 2000:109).

Mësuesit duhet të organizojnë një sërë aktiviteteve që t'u mundësojnë studentëve të hulumtojnë në mënyrë të pavarur, duke arritur konkluzione nga gjithçka që kanë lexuar dhe nga përvoja e tyre personale, duke i ndarë edhe me të tjerë.

Më poshtë, po paraqitim një projekt që mund të zhvillohet në grupe, në klasat e gjuhëve të huaja: (Për realizimin e këtij plani jemi mbështetur në idetë dhe sugjerimet e Byram et al.

(2000), në '*Social Identity and the European Dimension Intercultural Competence Through Foreign Language Learning*').

Tema e leksionit : Festat në vendet anglishtfolëse

Objektivi kryesor:

1. Zhvillimi i aftësive për të interpretuar, analizuar dhe krahasur ndërmjet kulturave
2. Zhvillimi i aftësive për të komunikuar
3. Zhvillimi i aftësive hetuese/zbuluese për të gjetur informacion mbi vendet anglishtfolëse,
4. Studentët kuptojnë dhe vlerësojnë kulturat e vendeve të tjera, dhe reflektojnë mbi materialet:

- Dokumente ose materiale që mund të jenë marr nga literatura të ndryshme,
- Media, filma, internet, gazeta
- Fjalor (Dictionary of English Language and Culture (Longman),
- Hartë ose postera.

Aktivitetet:

1. Studentët bejnë një prezantim të projektit të tyre. Prezantimi mund të jetë në grup ose individual.
2. Pedagogu mbledh materialet dhe shënon temat për çdo grup në tabelë

Vlerësimi:

1. Studentët krahasojnë përgjigjet e kolegëve dhe japin vlerësimin e tyre. Pedagogu nxit debate për të kuptuar nëse ata bien dakord midis njëri-tjetrit për çështje të ndryshme.
2. Aftësia për të prezantuar.
3. Aftësia për të organizuar informacionin.
4. Aftësia për të krahasuar dhe analizuar

Për arritjen e qëllimeve, pedagogët duhet:

1. Të kenë objektiva të qarta të mësimin të gjuhës së huaj, plane të leksioneve dhe materiale.
2. Të nxisin studentët të përdorin metodën krahasuese dhe analizën kritike për dy kulturat.
3. Të ndihmojnë studentët të mbledhin, interpretojnë dhe analizojnë informacionin .
4. Të rritin kuriozitetin e studentëve për kulturat e tjera.

Për të gjitha këto, pedagogët duhet të jenë në dijeni për metodologjitë e fundit dhe t'i praktikojnë në klasa. Kjo kërkon që ata të shohin me kujdes programin lëndor, për të cilin mund të kenë shumë pyetje rreth aspekteve që duhen trajtuar, si duhen trajtuar etj. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të aftësive të tilla të rëndësishme si dëgjimi dhe vëzhgimi e, sidomos, të nxitet analiza krahasuese ndërmjet dy kulturave. Në temën e mësipërme, pedagogu i shtyn studentët të gjejnë sjellje kulturore të ndryshme nga ato të kulturës amtare.

Më poshtë po paraqitim disa qëllime që duhet të arrijnë pedagogët, sipas raportit të përpiluar më 1999, në *'St Martin's College and University of Central Lancashire'*, i titulluar *'Raising Intercultural Awareness in preparation for periods of residence abroad'*: (Toll,S., 2000:8)

- Studentët të kuptojnë konceptin e vetëdijes ndërkulturore.
- Studentët të dinë orgjinën e vlerave kulturore, supozimeve dhe qendrimeve të tyre dhe sesi vlerat e tyre ndikojnë tek perceptimi që kanë për të tjerët.
- Studentët të identifikojnë shkaktarët e keqkuptimeve ndërkulturore.
- Studentët të kuptojnë sesi perceptimet e tyre, qendrimet dhe sjelljet ndikojnë në të mësuarit kulturor.
- Studentët të mësojnë strategji dhe të zhvillojnë sjellje që do t'i ndihmojnë si të përshtaten në një vend të huaj dhe sesi të veprojnë në mënyrë të pavarur.
- Studentët të vëzhgojnë, monitorojnë dhe raportojnë në mënyrë të pavarur të mësuarit kulturor. (Toll,S., 2000:8)

Për të ndihmuar studentët që të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore, Deardorff-i sugjeron OSEE Tool. (Deardorff.D & Bowman,K, 2011: xxviii)

O - të vëzhgosh se çfarë po ndodh,

S - të shprehesh objektivisht për çfarë po ndodh,

E - të zbulosh shpjegime të ndryshme për atë që po ndodh,

E - të vlerësosh cilat nga shpjegimet ka më shumë gjasa të ndodhin.

Siç shihet, kjo metodë fillon së pari me vëzhgim dhe dëgjim, duke kaluar në hapin tjetër 'të shprehesh objektivisht çfarë po ndodh'. Ky është një hapi i vështirë për t'u zbatuar, Deardorff-i sugjeron, p.sh., të shikosh një filmi të shkurtër dhe të shkruash rreth tij. Hapi tjetër "të zbulosh shpjegime të ndryshme", do të thotë ta shohësh edhe nga prespektiva e tjetrit, pra shpjegim mund të jetë personale dhe kulturore. Hapi i fundit është edhe më i vështiri, dhe mund të kryet, duke mbledhur informacion nga bisedat me të tjere e duke berë

pyetje. Pasi të gjitha hapat janë kryer, mund të kalohet nga supozimet, në një këndvështrim objektiv (Deardorff,D & Berardo,K., 2012:58). Nëse studentët janë të informuar për elementet përberëse të OSEE-së, kjo do t'i ndihmojë për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore, dhe për të interpretuar sjellje të ndryshme.

Moeller & Nugent (2014) sugjerojnë disa aktivitete që mund të kryen për procesin ndërkulturor:

1. Autorët sugjerojnë që gjatë orëve të mësimi të paraqitet një klip të një filmi. Fillimisht video shfaqet pa zë, në mënyrë që studentët të shohin vetëm imazhin, veprimin dhe ndërveprimin, pra studentet përqendrohen vetëm në vëzhgim. Gjatë vëzhgimit, mësuesi kërkon nga studentët t'i adresohen shkronjës *O (observer)*, thjesht të vëzhgojnë veprimet dhe ndërveprimet në ekran. Më pas kalojnë në shkronjën *S (Stating)*, listojnë veprimet e vëzhguara pa i përshkruar situatat si të dëshirueshme apo të padëshirueshme. Hapi tjetër që i referohet shkronjës *E (Exploring)*, i udhëzon studentët të punojnë në gurpe të vogla duke zbuluar veprimet e ndërveprimet e kulturës së synuar. Hapi i fundi, shkronja *E (Evaluating)*, studentët vlerësojnë të gjitha shpjegimet e mundshme, për të zgjedhur më të duhurën nga sjelljet e para në film. (Moeller & Neugent, 2014:9-10)

2. Të caktohen së pari një temë kulturore që mund të merret nga librat akademik dhe t'ju ofrohet studenteve për diskutim. Pedagogu i nxit të gjithë studentët që të mblidhen rreth një letre të madhe dhe të shkruajnë fjalë e ide që ju vijnë ndërmend për atë temë. Gjatë leximit të këtyre shkrimeve, pedagogu identifikon të dhëna statistike dhe informacione të rëndësishme. Pedagogu nuk u bën pyetje për tekstin e shkruar, por i nxit studentët që të

zbulojnë ndryshimet në mënyrë të pavarur. Pas përfundimit të mësimit, gjithë studentët mbledhen tek letra me mendime të shkruara që në orën e parë, dhe diskutojnë për ndryshimet që pësuan në qëndrime dhe besime. Qëllimi i këtij aktiviteti është që studentët të kuptojnë se shumica e perceptimeve të tyre nuk bazohen në fakte. Ndërsa studentët përvetësojnë njohuri mbi kulturën e synuar, pedagogu ka mundësi të nxis aftësinë për të krahasuar ndërmjet dy kulturat. (Moeller & Neugent, 2014:10-11)

3. Analizimi i artefakteve: Kjo mënyrë sugjeron përdorimin e artefakteve në praktikën e kultursë së synuar. Pedagogu kryen thjesht rolin e ndërmjetësit në klasë, ndërsa studentët vlerësojnë informacionin për atë kulturë. P.sh.,: U kërkon studentëve të imagjinojnë sikur janë ftuar në një festë ditëlindjeje të një shokut të tyre kinez, Ata shohin që objektet që gjenden atje janë shumë të ndryshme nga ato në ditëlindjet e tyre. Pas njohjes së situatës, studentët ndahen në grupe për të diskutuar për objektet e festës së ditëlindjes, secilit grup i jepet një objekt por nuk u lejohej që të kërkojnë informacion mbi objektet, duhet thjesht të hamendësojnë, bazuar në njohurit që kanë në lidhje me këtë vend. Pas mbledhjes së informacioneve bëhet diskutimi me gjithë klasën. Në këtë pikë, mësuesi krijon edhe një ide se çfarë perceptimi kanë studentët për kinezët. Pas kësaj, kalohet në fazën e dytë, studentëve u kërkohej të hulumtojnë për të zbuluar fakte kulturore dhe mësuesi i ndihmon me disa pyetje të hapura, si: Pse përdoret? Cili është qëllimi? Kur përdoret në një festë ditëlindjeje? A ka ndonjë lidhje midis kulturës kineze dhe kulturës suaj? Ishin supozimet tuaja të verteta apo të gabuara? Në këtë mënyrë, studentët jo vetëm mësojnë si të hulumtojnë në mënyrë të pavarur për kultura të tjera, por u jepet edhe mundësi për të krahasuar me kulturën mëmë. (Moeller & Neugent, 2014:13-14)

Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore në klasat e gjuhëve të huaja kërkon edhe një menaxhim të mirë të klasës, pedagogët mund të organizojnë punë në grupe, në cifte ose me të gjithë klasën. Studentëve u kërkohet të ndjekin disa rregulla kur shfaqen mendime e opinione të ndryshme, që debati të orientohet drejtë. Byram et al. sugjeron disa rregulla të cilat duhen pasur parasysh nga mësuesit: respektimi i mendimit të kolegeve gjatë fazës së debatit; të dëgjohen të gjithë kolegët kur flasin dhe të respektohet rendi; në çdo debat pavarësisht nga tema duhet të përdoret një gjuhë e edukuar; çdo sjellje diskriminuese, racise ose homofobike duhet të shmanget në klasë; të përdoret një ton respektues në klasë (Byram, M., et al. 2002:26)

Për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në mësimëdhënien e gjuhës angleze, pedagogët duhet të mbështeten në disa elemente të rëndësishme:

Së pari, është e rëndësishme që të vihet në dukje lidhja e ngushtë që ekziston midis gjuhës dhe kulturës, si elemente të pandashëm që çojnë në një komunikim efikas. Pra, studentët duhet të rrisin njohuritë e gjuhës së huaj së bashku me elementet e kompetencës ndërkulturore. Bazuar në planin e mësimin të zhvilluar nga *Mc Neil* (2014):

Objketivi: 1. Studentët duhet të dinë kuptimin e fjalës ‘kulturë’

2. Rëndësia e kulturës në mësimin e gjuhës së huaj dhe sesi gjuha dhe kultura janë të ndërlidhura.

3. Të shpjegojmë mënyrat e të mësuarit për kulturën e gjuhës së synuar

Pyetjet që nxisin reflektim:

a. Çfarë do të thotë kulturë për ty? Shpjego dhe jep shembuj.

- b. Mendon që kultura dhe gjuha janë të ndërlidhura? Pse ose Pse Jo? Shpjego.
- c. Si mund të mësojmë për kulturën e synuar?
- d. Si përshendet njerëzit në gjuhën që ti po studion ose di? (Mc Neil , 2014)

Së dyti, është e rëndësishme që të studentët të jenë të ndërgjegjshëm për vecantit e çdo kulture. Në momentin e përballjes me kultura të ndryshme, i dallojnë këto veçanti, duke i përqasur me kulturën në të cilën janë rritur.

Së treti, duhet të sigurohen materiale të përshtatshme që ta ndihmojnë studentin për të përgatitur studentin të arrijë objektivat e synuara.

Si do të procedohet në lidhje me materialet: Pedagogu sjell në klasë materiale që i referohen një situate, të cilat ju ofrohen studentëve për t'i lexuar me vëmendje. Më pas studentët duhet t'u përgjigjen pyetjeve, duke bërë krahasime me kulturën e tyre. Kështu jo vetëm njihet diçka e re, por edhe reflekton për atë që di.

Loja me role është një metodë e të mësuarit ku secili student vendos veten në një situatë të caktuar. Aktivitetet që mund të realizohen me këtë lojë janë të shumta. Përgjithësisht janë situata imagjinare, që mund të përdoren për tema të ndryshme, si :‘Në një restorant’, ‘Në një takim pune’, ‘ Festa e Krishtlindjes’ etj. Lojat me role e bejnë orën e mësimit më tërheqëse. Kjo mënyrë e lejon pedagogun që të vlerësojë kompetencat komunikative. Duhet patur parasysh që temat që do të zgjidhen nga pedagogu të jenë tema të nevojshme dhe interesante për studentët (Kodotchigova,M. 2002). Një mënyrë e mirë për të siguruar këtë synim, është që studentët t'i zgjedhin vetë situatat në të cilat duan të ‘lujanë’. Pedagogu në këtë fazë bën rolin e ndërmjetësuesit, duke ndërhyrë shpesh për të

dhëne këshillat apo komente. Do të ishte mirë që korrigjimet për fjalitë që kanë probleme gramatikore dhe fjalori, të shkruheshin në tabelë, për t'u memorizuar më lehtë nga studentët.

Autorë të ndryshëm janë shprehur që loja me role ndikone në zhvillimin e empatisë, aftësive të përshtatjes, kuriozitetit dhe respektit. Modeli bazë i saj është 'një lojë ndërmjet dy grupeve 'të ndryshme', që duhet të ndërveprojnë'. Kjo lojë ofron kuadrin për dialogje dhe negociata, të cilat janë një kusht e rëndësishme për takimet ndërkulturore. (Hiller, G.G., 2010:155). Ajo kërkon të mirëmenaxhohet që, së pari, askush të mos ofendohet nga skenari që zhvillohet në klasë; së dyti, studentëve t'u jepen role që nuk ndeshen në jetën e përditshme. Duhet, gjithashtu, të ndahet mirë koha, që të diskutohet pas lojës me role atë që u zhvillua në klasë dhe se çfarë ata përvetësuan. (Council of Europe and European Commission, 2000:66).

Sipas Maja Wozniak (Cit. Hiller,G, 2010:12), kjo metodë është një mënyrë e mirë sepse:

1. Pjesëmarrësit mund të trajnohen për aftësi të ndryshme.
2. Shërben si mjet për 'peer assessment' – 'vlerësimin e kolegeve'
3. Nuk është një praktikë e vështirë për t'u zbatuar.
4. Të gjithë studentët janë të përfshirë si pjesëmarrës, si vlerësues dhe secili mund të thellojë të kuptuarit e tij për aftësitë ndërkulturore specifike.

Teatri, poezi dhe shkrimi krijues - është një mundësi shumë e mirë për të zbuluar dhe reflektuar për eksperiencat që studentët nuk i hasin në jetën reale të tyre. Dramat dhe poezitë ndihmojnë që të zhvillojnë imagjinatën dhe të përfitojnë njohuri për njerëz që nuk i

kanë takuar më parë, dhe të imagjinojnë për situata që nuk i kanë jetuar më parë.
(Navaitiene,J et al. fq 36)

Situata kritike: Në kontekstin ndërkulturor, situatë kritike konsiderohet ajo në të cilën mund të krijohet një keqkuptim, problem, ose konflikt për shkak të ndryshimeve kulturore midis njerëzve (Cit.Hiller,G., 2010:157). Situata kritike nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një situatë dramatike. Ajo mund të jetë edhe situatë që ka rëndësi për një individ të caktuar, por mund të mos jetë e tillë për një individ tjetër. Situatë kritike është ajo ku çdo individ ngre pyetje për gjëra që bien ndesh me parimet e tij. Ajo krijohet edhe nga mënyra sesi shihet e interpretohet një situatë e caktuar e në ndonjë rast, mund të ndikojë edhe në mënyrën tonë të menduarit. Një situatë e tillë mund të krijohet nga një skenar i shkruar, verbal, audio apo viziv dhe i fton pjesmarrësit të eksplorojnë e të reagojnë për të (Tomalin,B, 2009:121).

Objektivi i përdorimit të situatave kritike është të kuptuarit e kompleksitetit të ndërveprimit komunikativ (Tomalin,B, 2009:159). Pedagogu duhet të sjellë materiale mbi situata reale, të cilat duhet të jenë të shkurta. Studentëve u shpërndahen materiale për një situatë kritike, duke ju dhënë kohën e mjaftueshme për ta lexuar. Pas leximit të materialit duhet të behen pyetje të tilla:

1. Çfarë interpretimesh keni për situatën?
2. Si mund të interpretohet ndryshe situata?
3. Çfarë faktorësh kanë ndikuar në situatë?
4. Si do të reagoni, nëse do të përballeni me një situatë të tillë në të ardhmen.

Më poshtë po paraqitim një shembull të marrë nga Corbett-i, për të kuptuar më mirë situatën kritike:

‘Një mësuese amerikane në një kurs veror vendos të bëjë një festë për studentët e saj dhe i fton në shtëpinë. Japonezët erdhën në orën 20.00, hengrën pjesën më të madhe të ushqimit dhe u larguan në orën 22.00, kur italianët po vinin. Në mesnatë, kur erdhën latinoamerikanët, ushqimi kishte mbaruar, por ata qëndruan, kënduan dhe kërcyen deri në katër të mëngjesit. Arabët nuk erdhën në festë. A duhet të organizojë më festë ajo?’ (Corbett,2003:112)

Kjo situatë, siç shprehet Corbett, mund të çojë në stereotipizime të sjelljeve kulturore. Në këtë rast, keqkuptimet erdhën si rrjedhojë e mënyrës sesi e konsiderojnë një festën, orën se kur duhet të fillojë etj. P.sh., arabatë ndoshta nuk shkuan në festë, duke marrë parasysh që një të mund të përdorej edhe alkol ose ushqime që nuk u lejoheshin. (Corbett., 2003:112)

Navaitiene et al. (2013) propozon disa mënyra klasike për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore:

Përshkrim verbal ose i shkruar: Mund të jetë një tekst i shkruar ose verbal që përshkruan të njëjtën ngjarje ose sjelle që paraqitet nga njerëz të tjerë, me formim kulturor të ndryshëm, të cilat e shikojnë nga një prespektive tjetër. Kjo mënyrë ndikon tek studentët për të zhvilluar ndjenjën e emaptis, të menduarit joparagjykses, aftësit e vëzhgimit, interpretimit, krahasimi, analizës etj. Kjo i ndihmon studentët të kuptojnë pse njerëzit shohin të njëjtën ngjarje ose sjelle në mënyra të ndryshme. (Navaitiene et al, 2013:36)

Narracioni i historive: Kjo mënyrë ndihmon studentët të largohen nga vlerat, normat dhe besimi i tyre për të parë prespektivën e njerëzve të përfshirë në histori. Studentët eksplorojnë njëri-tjetërin si individë kompleks. (Navaitiene et al, 2013:37)

Prezantimet: Çdo prezantimi që ka si synim të paraqes vendin e një individ dhe atë të gjuhës së synuar ndihmon në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Me anë të kësaj metode synohet që të rritet interesi i studentit për vendin në të cilin jeton dhe në të njëjtën kohë të rritet motivimi për vendet e tjera. (Navaitiene et al, 2013:38)

Pune me projekte: Kjo metodë është berë shumë e përdorshëme për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Studentit i caktohet një temë kulturore ose mund edhe ta zgjedhi temën vete, dhe më pas ai duhet të menaxhoj kohën për të zbuluar mbi një fenomen të caktuar. Materialet paraqiten për vlerësim. (Navaitiene et al, 2013:38)

Përdorimi i medias: Media nuk është një mënyrë neutrale e transmetimit të informacionit. Media ndikon në besimet dhe qëndrimet e një individi. Një shembull që autori sugjeron është të merret një foto dhe më pas të diskutohet nëse ka mesazhe raciste në foto. Hapi i parë drejt zhvillimit të kompetencës ndërkulturore është se çfarë mesazhi ndërkulturore mbart fotoja. Të njëjtën gjë mund të behët edhe nëpërmjet filmave nga burime të ndryshme (si prsh., YouTube) (Navaitiene et al, 2013:39)

Shoku ndërkulturore: Në momentin që një individ ndodhet në një mjedis kulturor të ndryshëm mund të pushtohet nga një ndjenjë jo e rahatshme. Kjo metode mund të përdoret në klase prsh. duke paraqitur një skenë të caktuar të një filmi, sidoqoftë, idealja do të ishte udhëtimi dhe kontaktet me njerëz me formim kulturor të ndryshëm. (Navaitiene et al, 2013:39)

Rast studimore: Duhet të ofrohet një rast studimor i caktuar dhe më pas të ofrohen zgjidhje alternative për këtë rast. Kjo metodë nxitë të menduarit kritik dhe zhvillon aftësitë e zgjidhjes së problemeve. (Navaitiene et al, 2013:39)

Përveç materialeve të sjella, pedagogët mund të tregojnë edhe eksperiencën e tyre personale. Kjo mund mund t'i bëjë studentët të reflektojnë dhe të paraqitin, edhe ata, situata nga përvoja tyre. Në vijim, po paraqitim një situatë në të cilën kemi qenë të pranishëm.

‘Në një Workshop të organizuar nga një organizat joqevitare në Shqipëri, ishte i ftuar një ekspert nga Gjermania. Ai së bashku me tri femra ishin ulur në kafën e hotelit, ku organizohej workshopi. Workshopi duhej të fillonte në orën 10.00, por, edhe pse minutat kishin kaluar dhe të gjithë e kishin pirë kafën, asnjë nuk po çohet nga tavolina. Përse ndodhi kjo?’ Në këtë situatë, në dukje shumë e thjeshtë, pati një keqkuptim kulturor, që mund të interpretohet nga këndvështrimetë ndryshme:

1. Gjermani donte të ishte i sjellshëm, duke ua lënë në dorë femrave për të vendosur.
2. Ai ishte i ftuar në këtë ceremoni, prandaj ishin ato që e mirëprisnin që duhet të fillonin workshop-in.
3. Ndërkohe femrat, mendonin se, duke qenë ai eksperti, ishte ai që duhet të thoshte për fillimin e workshop-it.

Kjo situatë mund të paraqitet në klasë, duke u kërkuar studentëve të japin mendimin e tyre. Ata duhen nxitur që të pozicionojnë veten në një situat të tillë dhe më pas duhet të japin mendime. Duke qenë se kemi një situatë me individë nga kultura të ndryshme, mënyrat sesi e perceptojnë atë, variojnë sipas formimit kulturor që ka secili.

Temë që mund të diskutohet në klasë: Një situatë e paraqitur nga Huber-Kreigler et al. ku jepen shembuj të ndryshëm mbi elementet kulturorë. Në anglisht nuk ka një shprehje ekuivalente me shprehjen ‘bon appetit’, në shqip ‘të bëftë mirë’ (Huber-Kreigler et al 2003:134). Në vendet anglishtfolëse nuk thuhet asgjë e ngjashme para fillimit të ushqimit. Ndërkaq, në disa familje e kanë si traditë të thojnë lutje para.

Pyetjet që parashtrohen në këtë rast nga pedagogu:

1. A ekzistojnë shprehje të tilla në kulturën tonë? Janë shprehje të detyrueshme apo variojnë sipas të mjedisit dhe individëve?
2. Çfarë rregullash zbatohen para dhe pas ngrënies së ushqimit?
3. Mendoni për sjellje në tavolinë që mund të çojnë në keqkuptime.

Çdo situatë e paraqitur në klasë duhet të jenë konfliktuale. Pedagogët duhet të bëjnë kujdes që metodat e përdorura të përfshijnë të gjithë elementet e kompetencave ndërkulturore. Ato duhen të jenë të mirëmenduara që çdo aktivitet i kryer në klasë të arrijë të dyja objektivat njëkohësisht, atë gjuhësor dhe atë ndërkulturor.

Disa metoda që sugjerojnë Holmes: Së pari, ‘telecollaboration’ (telekomunikimi) që është një mundësi e mirë për të përfshirë studentët në shkëmbime ndërkulturore. Së dyti, gjuha e përmbajtjes dhe të nxënës të integruar (content language and integrated learning) katër konceptet bazë për ‘gjuhën e përmbajtjes dhe të nxënës të integruar’ sugjerojnë mënyra sesi të ndërtojnë kompetencën ndërkulturore nëpërmjet gjuhës: (Holmes, 2014:82)

- *përmbajtja* – progres në njohuri, aftësi dhe të kuptuarit lidhur me elemente specifike të një kurrikule të mirëpërcaktuar (prsh. të mësuarit të kulturës përmes historisë, gjeografisë, letërsisë, gjuhës)

- *komunikimi* – të përdorësh gjuhën për të mësuar ndërkohë që mëson sesi të përdorësh gjuhën
- *njohje* – zhvillimi i aftësive të menduarit që lidh konceptet e të formuarit (abstrakt dhe konkret) (prsh. nëpërmjet *five savoirs* në Modelin e kompetencës ndërkulturore të Byram)
- *kultura* – ekspozim ndaj alternativave prespektive dhe të kuptuarit të përbashkët që thellon vetëdijen për të tjerët dhe vetën (prsh. nëpërmjet ndërveprimit ndërkulturore) (Cit. Holums, 2014:82. Byram, 2008)

Autorët Barrett et al. (2014) në projektin *Developing intercultural competence through education* sugjerojnë që lehtësuesit (pedagogët/ mësuesit) duhet të përfshijnë eksperiencën, krahasimin, analizën, reflektimin dhe veprimin në planin e tyre.

Eksperienca – mënyra më e mirë për të zhvilluar kuriozitetin, respektin, të qënurit i hapur, dhe për të përfituar njohuri të kulturave dhe ndërlidhjeve të tjera, është të shikosh sesi veprojnë, ndërveprojë dhe komunikojnë njerëzit, duke i parë nga prespektiva e tyre. Lehtësuesit (Pedagogët) duhet të ofrojnë mundësi për të mësuar nëpërmjet eksperiencës, që mund të paraqitet si një situatë reale nga eksperienca e pedagogëve dhe studenteve ose mund të jenë situata të imagjinuar. (Barrett et al., 2014:29)

Krahasimi – Mënyra më e mirë për të kuptuar njerëzit që i përkasin kulturave të ndryshme është të vihen përballë me këto ‘ndryshime’. Studentët kanë tendencë të krahasojnë çfarë është e panjohur me atë që e kanë të njohur. Ata kanë tendencë që paragjykojnë të panjohurën. Detyra e lehtësuesit është që të nxitë krahasimin ndërmjet dy kulturave, duke gjetur të ngjashmet dhe të ndryshmet, por në mënyrë joparagjykyese. Kjo i ndihmon studentët që të nxisin reflektimin e tyre për krahasimin e vlerave të tyre dhe qëndrimet e të tjerëve. (Barrett et al., 2014:29)

Analiza – Përtej ngjashmërive dhe ndryshimeve, ka shpjegime rreth praktikave, vlerave dhe besimeve, që shumica e njerzve të përkatësive të ndryshme kulturore mund të ndajnë. Lehtësuesit duhet të mbështetin studentët në analizën se çfarë mund të qëndrojnë nën to, se çfarë mund të dallojnë ata, duke bërë ose duke parë. (Barrett et al., 2014:30)

Reflektimi - Krahasimi, analiza dhe eksperiencia duhet të shoqërohen më kohën dhe hapësirën e duhur për reflektim dhe për zhvillimin e vetëdijes kritike. E thënë në terma më praktike, pedagogët mund t'iu kërkojnë studentëve të diskutojnë eksperiencat e tyre, t'i inkurajojnë dhe ti shkëmbejnë ato më të tjeret. (Barrett et al., 2014:30)

Veprimi – Reflektimi mund dhe duhet të jetë bazë për të ndërmarrë veprime të ndryshme, për angazhimin me të tjerët nëpërmjet dialogut ndërkulturor dhe për t'u përfshirë në aktivitete bashkëpunuese me njerëz që kanë përkatësi të ndryshme kulturore. Lehtësuesit mund të ndërmarrin përgjegjësi të tilla, si inkurajimi dhe menaxhimi i veprimeve bashkëpunuese. (Barrett et al., 2014:30)

Sipas *Nyegorodcew, A. et al* për të zhvilluar njohurit dhe vetëdijen kulturore gjatë aktiviteteve ndërkulturore, pedagogët gjatë kërkimit dhe zgjedhjes së materialeve duhet të mbajnë mend këto pika: 1. Studentët mund të zhvillojnë aftësitë kritike dhe autonominë nëse ata nxiten që punojnë dhe analizojnë informacionin në mënyrë të pavarur; 2. Projektet që përfshijnë etnografine "kombetare" dhe "virtuale" kërkojnë një zhvillim paraprak të aftësive kërkimore dhe pikepamjeve; 3. Çdo krahasim që i behët studentit midis kulturave, thellon edhe njohurit e tij mbi kulturën amtare. 4. Tekstet që përfaqesojnë stile dhe zhanre të ndryshëm si në gjuhën amtare dhe atë të huaj janë të dobishme për krahasimin e

kulturave te ndryshme; 5 Tekstet dhe mjetet vizuale që prekin stereotipet ose homogjenitetin e kulturave i lejojnë studentet te zhvillojnë njohuritë individualisht; 6. Tekstet mbi incidentet kritike ilustrojnë influencën e njohurisë socio kulturore mbi efikasitetin e komunikimit. (Nyegorodcew, A. et al, 2001:50)

Në lidhje me tekstet ose informacionet e paraqitur sipas autoreve Fiske & Neuberg (Cit. Sercu, 2000) nuk është gjëja e duhur të paraqesim tek studentë një gamë të gjerë njohurish për kulturën e synuar, pasi një sasi e madhe informacioni dhe njohurish nuk siguron rritjet të të nxënës.

Navaitien et al. shprehen që modele të ndryshme për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore mund të grupohen sëbashku dhe të klasifikohen në lloje. Tudorache (2012) propozon klasifikimin e metodave të zhvillimit të kompetencës ndërkulturore: (Navaitien, 2013:34-35).

Metodat konjitive: Këto metodat mund të përdoren për të mbledhur informacion në lidhje me diversitetin kulturor. Kjo metode të lejon që të paraqitesh një sasi të madhe informacioni në mënyrë të mirë strukturuar. (Navaitien et al., 2013:34)

Metodat e vetë-kuptuarit: Këto metoda vlejnë më shumë për studentët që janë kurioz dhe duan që të mësojnë më shumë për veten e tyre, si përsh. për reagimet e tyre të mundshme me njerëz me formim kulturor të ndryshëm. Duhet patur parasysh që njohurit dhe analiza e kryer në mënyrë pavarur nga studenti nuk mund të jetë në një nivel të lartë nëse nuk është i kontrolluar nga pedagogët (Navaitien et al., 2013:35)

Metodat e sjelleve- Qëllimi kryesor i kësaj metode është që të ndihmoj studentët për të pasur sjellje të përshtatshme dhe të zëvendesoj sjelljet jo të përshtatshme. (Navaitien et al., 2013:35)

Metodat eksperimentale: Studentët mund të kryejnë skenarë të ndryshëm ku duhet të sillen sikur janë një nga përfaqësuesit e kulturave të tjera, dhe ku duhet të përdoren traditat kulturor dhe gjuha si objektiv kryesor i këtij aktiviteti. (Navaitien et al., 2013:35)

Metodat e atributimit: Kjo metodë ndihmon studentët që të analizojnë sjelljet e të tjerëve dhe të jenë të aftë të nxjerrin përfundime bazuar në fakte. (Navaitien et al., 2013:35)

Në faqe të Internetit mund të gjenden materiale në lidhje me mësimin e kulturës, më poshtë po paraqisë disa nga këto faqe (*Larrea, A., et al. . Pixel-Bit. Revista de Medios y Educacion*)

Burime:

1. <http://www.projectbritain.com/behaviour.html>. Është një faqe interneti në të cilën mund të gjenden informacione në lidhje me kulturën e Mbretërisë së Bashkuar. Ku mund të mësojnë gjithcka në lidhje me jetën dhe kulturën e Mbretërisë së Bashkuar. Faktet, informacionet dhe gjithcka tjetër që nevojiten, materialet janë të thjeshta për t'u kuptuar dhe analizuar.
2. <http://www.everythingsl.net/in-services/crosscultural.php>. Është një faqe interneti në të cilën ju shërben pedagogëve në lidhje me aktivitetet që mund të zhvillohen në klasë.

3. <http://www.culture-at-work.com/contents.html#culture> Është një faqe interneti që ofron teori dhe praktikë në lidhje me kulturën.

4. <http://areyouintercultural.eu/> Është një faqe interneti e ofruar nga Këshilli i Europës, të cilën teston kompetencën ndërkulturore dhe ndihmon në përmisimin e kompetencës ndërkulturore. Këto pyetje mund duhet të përdoren si nga pedagogët ashtu edhe nga studentët.

5. http://www.coe.int/t/dg4/autobiography/default_en.asp Është një faqe interneti ofruar nga Këshilli i Europës e hartuar për të nxitur njerëzit të mendojnë dhe të mësojnë nga takimet ndërkulturore që ata kanë hasur ballë për ballë ose nëpërmjet medias vizuale si prsh. televizioni, revistat, filmat, interneti etj. Ato janë të ndara në dy paralele: Autobiography of Intercultural Encounters (AIE) (Autobiografi për takime ndërkulturore), dhe An Autobiography of Intercultural Encounters through Visual Media (AIEVM) (Një autobiografi për takimet ndërkulturore ndëpërmjet Medias Vizuale). AIE dhe AIEVM ofron një sërë materialesh në të cilën mund të shkarkohen falas. Përdoruesit e AIE dhe AIEVM (mund të përdoret nga pedagogë e student) zhvillon të kuptuarit dhe kompetencat për të ardhmen duke reflektuar në mënyrë kritike mbi përvojat e tyre.

4.3. Vlerësimi i kompetencës ndërkulturore

Një ndër vështirësitë që pedagogët kanë përmendur në fokus grup, është si të vlerësojnë kompetencën ndërkulturore. Ky është një aspekt i vështirë që ka nevojë edhe për trajnim. Një autor ka shkruar që 'kompetenca mund të matet, por matja varet, së pari, nga përkufizimi'(Klemp 1979, p.41. Cit. Deardorff,D.K, 2006:233). Të vlerësosh kompetencën

ndërkulutrore do të thotë që të kesh informim të mirë se çfarë është kompetenca ndërkulutrore, si të vlerësohet kompetenca në fillim, në mes dhe në fund të procesit të përvetësimit të kompetencës. Një ndër metodat më të përdorura për të vlerësuar kompetencën ndërkulutrore është provimi, por nuk mjafton, sepse ai mat vetëm disa njohuri të përgjithshme, prandaj është e nevojshme të përdoren një sërë metodash. Barret,M. et al. shprehet që planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve për zhvillimin e kompetencave ndërkulutrore shoqërohet gjithmonë me një lloj vlerësimi (Barret,M. et al., 2013:34). Vështirësia më e madhe është të vlerësosh nëse studentët kanë ndryshuar qëndrime, nëse janë bërë më tolerantë ndaj kulturave të tjera (Byram et al. 2002). Deardorff-i (2006) sugjeron që kompetenca ndërkulutrore është mirë të vlerësohet nëpërmjet kombinimit të metodave të sasiore dhe cilësore.

Në këtë kapitull do të paraqiten disa sugjerime sesi mund të bëhet vlerësimi i kompetencës ndërkulutrore tek studentët. Sipas Deardorff, hapi i parë në vlerësim është të dish çfarë duhet të vlerësohet: (Deardorff, 2011:66)

Së pari, kompetenca ndërkulutrore është një proces i vazhdueshëm, prandaj është e rëndësishme që të t'ju jepet mundësia për të reflektuar dhe vlerësuar zhvillimin e tyre të kompetencës ndërkulutrore gjatë gjithë kohës.

Së dyti, aftësitë e të menduarit kritik luan një rol të rëndësishëm në aftësitë e një individi për të përvetësuar dhe vlerësuar njohuri. Pra, kjo do të thotë që vlerësimi i të menduarit kritik mund të jetë një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të kompetencës ndërkulutrore.

Së treti, qëndrimet – në veçanti respekti, kurioziteti dhe të qenurit i hapur – shërbejnë si baza e këtij modeli dhe kanë një ndikim në të gjithë aspektet e kompetencës ndërkulturore. Atëhere, trajtimi i vlerësimit mbi qëndrimet bëhet një pjesë e rëndësishme.

Së katërti, ekspertët ndërkulturore janë dakort vetëm me një pjesë të këtij studimi: aftësia për të parë nga këndvështrimi i tjetërit. Si rezultat, të vlerësosh prespektivën globale dhe aftësia për të kuptuar botëvështrimet e tjera bëhet gjithashtu një pjesë e rëndësishme. Këto njohuri të thella kulturore, përfshijnë një pikëpamje me holistike dhe kontekstuale për të kuptuar një kulturë, duke përfshirë kontekstin historik, politik dhe social. Kështu çdo vlerësim i njohurive specifike kulturore duhet të shkoj përtej njohurive tradicionale sipërfaqësor të ushqimeve, përshendetjeve, traditave e kështu me rallë. Për më tepër, vetëm njohurit nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore; si shprehet Bok (2006) , zhvillimi i aftësive për të menduar ndërkulturalisht është më e rëndësishme se vetë njohuritë e përvetësuar. (Deardorff, 2011:66-68)

Lussier et al.(2007:29-30) sugjerojnë që para se të zgjidhet se cila metod është më e përshtatshme për vlerësimin e kompetencës ndërkulturore të studentët duhen të kenë parasysh këto:

1. Ekzistojnë dy lloje të ndryshme vlerësimesh të kompetencës ndërkulturore: vlerësimi formativ dhe vlerësimi sumativ. Gjatë procesit të vlerësimit të kompetencës ndërkulturore sugjerohet më shumë të përdoret vlerësimi formativ. ‘Vlerësimi Formativ’ ka si synim zhvillimin e kompetencës dhe të mbaj procesin e të nxënësit më aktiv. ‘Vlerësimi

Sumativ' vlerëson të nxënin në fund të lëndës me një notë vlerësuese, dhe ky vlerësim nuk është i duhuri kur vlerësohet kompetenca ndërkulturore.

2. Duke qenë se autor të ndryshëm e përshkruajnë kompetencën ndërkulturore si një proces i vazhdueshëm atëherë dhe autori Lussier et al. sugjeron që edhe vlerësimi i kompetencës ndërkulturore të jetë në mënyrë të vazhdueshme. 'Vlerësimi i vazhdueshëm' është një vlerësim i kryer nga mësuesit por edhe nga studentët për performacën e tij/ të saj, si prsh. me anë të projekteve etj.

3. Duke qenë se ekzistojnë dy lloj vlerësimesh direkte dhe jo direkte. Përpara se të përcaktohet nëse vlerësimi do jetë direkt ose jo direkt pedagogu krijon një 'listë të kontrollit', pra të gjithë ato elemente që i duhen pedagogut gjatë vlerësimit. Quhet 'vlerësim direkt' kur studenti aktualisht është duke bërë ose performuar dhe vlerësuesi bën lidhje të performacës me kategorinë më të duhur në 'listën e kontrollit'. Kurse 'vlerësimi jo direkt' kur përdorim një test, zakonisht në formë të shkuar, që zakonisht mat njohurit.

4. Vlerësimi mund të jetë holistike ose analitike. Të dyja këto vlerësime kryen nga pedagogët, më momentin që kryehet një vlerësim holistik jepet një vlerësim i përgjithshëm i studentit, ndërsa vlerësim analitik pedagogu duhet të shkoj me vëmendje të gjitha dimensionet dhe nëndimensionet ose mund ti shkoj të ndara për të nxjerr një vlerësim përfundimtar mbi kompetencën.

5. Vlerësimi mund të behët nga të tjerë por vetëvlerësim, i cili kërkon vlerësimin rreth performancës tënde, mund të jetë një suplement efektive për teste dhe vlerësimin e mësuesve. (Lussier et al., 2007:29-30)

Sipas Lussier et al shprehen që vlerësimi i njohurive kulturore ‘knowledge’ (savoirs) nuk duhet të limitohet thjesht me teste, me alternativa, përgjigje të shkurta (Lussier et al, 2007:147). Por duhet të merren parasysh tek njohurit:

- Përqasja humaniste (informacioni kulturor që lidhet me gjeografinë, historinë, artin, letërsinë, etj).
- Përqasja antropologjike (jeta e përditshme, traditat, zakonet, stereotipet, etj)
- Përqasja sociologjike (konteksti socio-kulturor të shoqërisë, identitetit kombëtar, besimet, etj)

Vlerësimi i (intercultural know-how/ savoir-faire) *di-si ndërkulturore/savoir faire* duhet të merret parasysh sesi studentët përshtaten mjedisve sociale dhe kulturore, që do të thotë të futet eksperiencat në gjuhën e synuar për të përdorur në mënyrë efektive kompetencat komunikative si folës ndërkulturor.

Vlerësimi i (intercultural being/ savoir-etre) kompetenca e të qënurit, në këtë pjesë duhet të merret parasysh që të arrihet ‘vetëdija kritike’ dhe të marrin parasysh identitet, besimet, vlerat e të tjerëve. Pra, të jenë ndërmjetës kulturor (Lussier et al.,2007:27).

Lundgren-i, nënvizon që kompetenca ndërkulturore është një proces ku studenti zhvillon njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe nuk mund të vlerësohet me sasi (Lundgren,2009:147). Në studimin e një rasti, (për më shumë shih ‘*Becoming Interculturally Competent*’ Feng. A et al.) ai ka përdorur reflektimet e studenteve si një formë vlerësimi. Autori ka vlerësuar reflektimit e studenteve në javët e parë, dhe më pas i ka krahasur me

javët e fundit ku ata kanë dhënë edhe reflektimet e fundit. Sipas këtij vlerësimi, studentët deklarorin se ishin më kompetentë ndërkulturalisht pas kursit pilot që zhvilluan në Universitetin Jonkoping, Suedi.

Edhe Moeller & Nugent theksojnë se një ndër vështirësitë më të mëdha është vlerësimi i përgatitjes së studenteve, pasi ata hyjnë në klasë me këndvështrime të ndryshme dhe është gati e pamundur ë të presësh që të rriten në njëtin nivel ndërkulturalisht. Kjo është aryeja pse shumë kërkues e përshkruajnë kompetencën ndërkulturore në klasë si proces. (Cit.Moeller &Neugent, 2014:5 Byram,1997; Deardorff,2006; Moloney & Harbon,2010)

4.3.1. Disa nga modelet për vlerësimin e kompetencave ndërkulturore

Vlerësimi i pesë dimensioneve të kompetencës ndërkulturore nuk është diçka e lehtë. Shumica e pedagogëve janë mësuar të vlerësojnë njohuritë e përgjithshme faktike, por kjo nuk mjafton. Të gjithë elementet të rëndësishme, prandaj është i domosdoshëm vlerësimi tërësor i tyre. Më poshtë paraqiten disa sugjerime mbi mënyrën e vlerësimit të kompetencës ndërkulturore:

Modeli i vlerësimit **Intercultural Sensitivity Inventory** (ICSI) (Bhawuk & Brislin, 1992:420) është një instrument vetëvlersimi në të cilën individët japin një përgjigje mbi një serë pyetjesh me shkallën matës Likert nga 1 deri tek 7: (1- totalisht dakord, 2- plotësisht dakord, 3- dakord 4- i papërcaktuar, 5- jo dakord 6- plotësisht kundër 7- totalisht kundër). Ky instrument u krijua për të matur aftësitë e një individi për të ndryshuar sjelljet në mënyra kulturalisht të përshtatshme kur levizin midis kulturave. Ky model i referohet

aftësive të individit për të njohur dhe pranuar ndryshimet kulturore në takimet ndërkulturore. Në fakt ky instrument u krijua për të krahasuar sjelljet në një kulturë individualiste (Shtetet e Bashkuara) kundrejt një kulture kolektiviste (Japonia) (Sinicrope, Norris, & Watanabe, 2007:16). Pyetjet janë të ndara në 3 seksione. *Intercultural Sensitivity Inventory* kërkon nga individët që të përgjigjen një serë situatash ndërkulturore. Duke përdorur këtë mënyrë është e mundur që të përcaktojmë nëse njerëzit në mënyrë të natyrshme (a) identifikojnë dallimet midis sjelljeve të pritshme kulturore (b) kuptohen me anëtarë të kulturave të tjera, dhe (c) janë të gatshëm që të ndryshojnë sjelljet e tyre për të dhënë një përgjigje kulturalisht të përshtatshme (Bhawuk & Sakuda, 2009:420). Në seksionin e parë që përbehet nga 16 pyetje, individët u kërkuan për t’ju përgjigjur pyetjeve duke imagjinuar sikur jetonin dhe kishin si qëllim të ndiqnin një karrierë në Shtetet e Bashkuara. Në seksionin e dytë që përbehet nga 16 pyetje, individët u kërkuan të përgjigjeshin për të njëjtat pyetje por duke imagjinuar sikur jetonin në Japoni. Kurse në seksionin e tretë ishin pyetje në lidhje me fleksibilitetin dhe të qënurit mendje hapur. (Bhawuk & Brislin, 1992:420). Autorët janë me mendimin që individualizimi dhe kolektivizmi mund të përdoren për të matur ndjeshmërinë ndërkulturore. Ata mendojnë që duke pasur nën shenjestër sjelljet që mund të ndryshojnë ndërkohë që njerëzit lëvizin nga njëri vend në tjetërin krijon një qasje e mirë për të konceptualizuar ndjeshmërinë (Bhawuk & Brislin, 1992:431) Pra, me pak fjalë është një instrument matës kur kemi të bëjmë me njerëz me orientim individualist kundrejt kolektivizmit, nivelin e të qënurit mendjehapur, dhe fleksibilitetin e tyre. Autorët janë të mendimit që ndjeshmëria ndërkulturore është një proces i të mësuarit kulturor që përfshinë procesin konjitiv, emocional dhe procesin e sjelljes (Bhawuk and Sakuda, 2009: 257-260). Procesi konjitivi që është hapi i pari i

ndjeshmërisë ndërkulturore përfshin aftësinë për të njohur ndryshimet kulturore. Procesi emocional që do të thotë të përgjigjesh në mënyrë positive ndryshimeve ndërkulturore. Procesi i sjelljes do të thotë që një individ duhet të jetë i aftë të formuloj një përgjigje kulturalisht të përshtatshme. Procesi konjitiv dhe emocional ndodhin në mëndjen, ndërsa procesi i sjelljes është i hapur për tu vlerësuar nga publiku. Ndjeshmëria kulturore nuk ka që qëllim përfundimtare dhe asnjë një pikë të matshme të ekselencës. Ndjeshmëria kulturore është thjesht udhëtimi i përjetshëm i zhvillimit personal.

Sipas autoreve Byram, Gribkova & Starkey (2002) shprehet që të vlerësosh sa informacion ka përvetësuar një student nuk është e vështirë pasi mund të krijohen teste të thjeshta për të matur sasin e informacionit të përvetësuar, ajo çfarë është e vështirë të vlerësosh është njohurit, të kuptuarit, nëse kanë ndryshuar perceptimet për kulturat e tjera. Këshilli i Europës ka zhvilluar *European Language Portfolio* që është i ndarë në tre pjesë. Qëllimi kryesor është që të ndihmoj studentët të kuptojnë që aftësitë e tyre mund të përvetësohen si në mjediset shkollore ashtu edhe jashtë saj. (Byram, Gribkova & Starkey 2002:29-31)

Passport Section – jep një pasqyrë të nivelit të kompetencave gjuhësore në gjuhë të ndryshme në një kohë të caktuar; kjo pasqyrë përcaktohet në lidhje me aftësitë dhe nivelet e përbashkëta të referencës në Kuadrin e Përbashkët European.

Language Biography: lehtëson procesin e përfshirjes së studentit në planifikim, reflektim dhe vlerësim të procesit të të nxënit dhe progresin e atij/asaj; nxisi studentët që të konstatojnë se çfarë munde ai/ajo të bëjë në secilën gjuhë dhe të përfshijnë informacione mbi eksperiencat gjuhësore dhe kulturore të përvetësuar brenda dhe jashtë kontekstit të arsimit formal; është e krijuar për të nxitur mësimin shumëgjuhësh prsh. zhvillimin e kompetencave në një serë gjuhësh.

Dossier: i ofron studentëve mundësinë për të zgjedhur materiale për të dokumentuar dhe të ilustronjë arritjet ose eksperiencat të rregjistruara në ‘Language Biography’ ose ‘Passport’.

Vlerësimi i kompetencës Ndërkulturore (The Assessment of Intercultural Competence, AIC) mat zhvillimin e kompetencave ndërkulturore gjatë kalimit të kohës. Pyetëtori i

hartuar në formën YOGA (Your objectives, Guidelines, and Assessment), mund të përdoret për vetëvlerësim nga mësuesit dhe studentët. Është i hartuar që të analizojë zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Ky pyetësor ndihmon që të analizohen objektivat ndërkulturore, shërben si udhëzues gjatë fazës së përjetimit të eksperiencës ndërkulturore, dhe shërben si instrument matës gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit ndërkulturore. Ky pyetësor vlerëson kompetencën ndërkulturore në këto elemente: vetëdijne (awareness), qëndrimet (attitude), aftësitë (skills), njohurit (knowledge), nivelin e gjuhës (Language Proficiency). Secila nga këto matet në katër nivele, dhe në secilën fushë duhet të zgjedhësh ndërmjet (0- jo kompetenca deri tek 5- kompetenca shumë të larta). Ky pyetësor gjendet në internet (*Assessing Intercultural Competence: A YOGA Form*) dhe mund të shkarkohet nga çdo individë. Pedagogët mund ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë në klasë tek studentët. Ky instrument u hartua nga FEIL (Federation of the Experiment in International Living) (*Deardoff, D.K., 2009*). Fantini (1995,b) shprehet që vlerësimi i kompetencës ndërkulturore paraqet shumë sfida. Autori deklaron që shumica e mësuesve dinë si të vlerësojnë njohuri dhe aftësi, ndërsa vetëdije dhe qëndrimet shumë rrallë mund të jenë pjesë e vlerësimit tradicional, pasi nuk mund të vlerësohen me sasi.

Komisioni Europian (2009) propozon **Intercultural Competence Assessment (INCA) Project.**, (INCA- Intercultural Competence Assessment- www.incaprojec.org) ka krijuar mjete matëse për kompetencën ndërkulturore, duke ofruar edhe udhëzime për ata që do të bëjnë këtë vlerësim, Projekti INCA e mbështet vlerësimin e kompetencës ndërkulturore në gjashtë elemente:

1. *Tolerancë ndaj ambiguitetit* – aftësia për të pranuar ambiguitetin dhe mungesën e qartësisë dhe aftësia për ta përballuar në mënyrë konstruktive.
2. *Fleksibilitet në sjellje* – aftësia për t'u përshtatur me kërkesat dhe situatat e ndryshme.
3. *Vetëdije në komunikim* – Aftësia për të dalluar konvencionet e ndryshme gjuhësore, aftësi të ndryshme të gjuhëve të huaja dhe ndikimi që kanë në proceset e ligjeratës, dhe për të negociuar rregullat e duhura për komunikim ndërkulturor.
4. *Zbulim i njohurive* – aftësia për të përvetësuar njohuri të reja të kulturës dhe praktikave kulturore dhe aftësia për të vepruar duke përdorur këto njohuri, qëndrime dhe aftësi nën limitet e komunikimit dhe ndërveprimit në kohën reale.
5. *Respekt për të tjerët* – respekti për të tjerë shfaqet nëpërmjet kureshtjes, të qënurit i hapur dhe i gatshëm.
6. *Empati* – aftësia për të imagjinuar vetën në prespektivën, opinionin, motivet mënyrën e të menduarit dhe ndjerë të një personi tjetër. Personat empatik janë persona që janë të aftë të lidhin dhe të reagojnë në mënyrën e duhur ndaj ndjenjave, preferencave dhe mënyrën e të menduarit të të tjerëve. (INCA,2009:4-11)

Vlerësimin e kompetencave ndërkulturore e kanë ndarë në tri nivele (*INCA ASSESSOR MANUAL, INCA, LdVII, 2004*). Niveli i parë është *kompetenca bazike* - Në këtë nivel, ke dëshirë për ndërveprim të sukseshëm, por nuk di si të ndërveprosh në situata ndërkulturore të përgjithshme. Në këtë fazë, je tolerant deri në një farë pike për vlerat, zakonet apo praktikatat. Niveli i dytë është *kompetenca mesatare* - Si rezultat i trajnimit dhe eksperiencës, në këtë nivel, jeni më të përgatitur për të reaguar dhe për t'iu përshtatur situatave

jofamiljare. Niveli i tretë është *kompetenca të plotë* - Në këtë fazë, ke shumë njohuri dhe aftësi si të përballosh ndryshimet kulturore. Më pas, autorët e Projektit prezantuan një strukturë tjetër, duke e ndarë kompetencën në tre shtresa:

1. Të jesh i hapur (Openness) –përfshin respektin për tjetrin dhe tolerancë ndaj ambiguitetit
2. Njohuri (Knowledge) –përfshin njohuri për të zbuluar dhe empati
3. Përshtatshmëri (Adaptability) –përfshin fleksibilitet dhe ndërgjegjësim komunikativ

Për secilën nga këto pikat është dhënë edhe një përshkrimi i detajuar për secilën nga këto aftësit. Secila nga këto kompetenca ndahet në tre nivel: Niveli i parë bazik (Basic), Niveli i dytë mesatar (Intermediate) dhe niveli i tretë i plotë (Full). Vlerësimi i INCA-së përmban tre lloj testesh, të tria mund të vlerësojnë një aspekt apo të gjitha aspektet e kompetencës ndërkulturore. Ato janë:

1. *Pyetësor* - merret informacione për formimi profesionale dhe përvojat personale.

Vlerësuesi merr informacion mbi formimin ndërkulturor të personit që vlerëson.

2. *Skenar* - u jepet për të lexuar një tekst apo për të parë një video, dhe më pas u përgjigjen pyetjeve. Vlerësuesi lexon dhe vlerëson përgjigjet e pyetjeve.

3. *Lojë me role* - u jepen role të caktuara për ndërveprim, dhe merren shënime, duke vlerësuar sjelljen e secilit pjeshtar në lojë. Vlerësuesi merr rolin e një vëzhguesi, mban shënime dhe i lidh me gjashtë elementet e kompetencës ndërkulturore. (INCA Manula, 2004:13)

Edhe Byram et al. (2013), sugjerojnë forma të ndryshme të vlerësimit, përvec provimit, si p.sh., ‘protofolios’ ose ‘learner-diaries’, me të cilat vlerësimet mund të kryehen nga pedagogët, në grup ose në mënyrë individuale. Sipas, këndvështirimit të Fantini-ttvlerësimi i kompetencave ndërkulturore nuk fillon me metodën apo mjetet që nevojiten për të vlerësuar, por fillon pikërisht me atë që dëshirojmë të matim, që të sigurojmë se synimet janë në përputhje me programin, etj (Fantini, 2009:456) Ky autor këshillon që, pasi përcaktohen komponentët më të rëndësishëm, të zgjidhet lloji i testit që u përshtatet më së miri. Fantini (2009) u rekomandon mësuesve të zgjedhin modele testesh si prsh. nga. *Assessment of Intercultural Competence (AIC)*; *Intercultural Competence Assessment (INCA)* projekt që janë të paraqitur më sipër. Ai sugjeron edhe disa forma vlerësimi: direkte, jodirekte, diskrete dhe globale. Direkte janë testet ose quizet që vlerësojnë njohuritë e marra. Vlerësimi jodirekt është i vazhdueshëm, pedagogu vlerëson studentin gjatë gjithë simestrit dhe mban shënime për performancën e tij. Vlerësimi diskrete përqendrohet vetëm në një çështje specifike të të mësuarit, si prsh., nëse studentët treguan ndonjë aftësi të vecantë. Vlerësimi global ka si objekt aftësitë që kërkojnë sintezë dhe zbatimin në kontekste të tjera.

Autori sugjeron, gjithashtu, disa teknika që përdoren në vlerësim (Fantini, 2009:464): pyetje të hapura e të mbyllura; aktivitet individual ose në grup, dialogje, intervista, debate dhe diskutime, punë me role, postera; aktivitet me gojë dhe me shkrim.

Deardorff-i këshillon që të përcaktohen si prioritare aspektet të ndryshme të kompetencave ndërkulturore, në zgjedhjen e të cilave mund të ndihmojnë edhe studentët, duke i konsideruar më të rëndësishme për programet që kanë, dhe më pas të përcaktohet

mënyra e vlerësimit. Pas përcaktimit të aspekteve specifike të kompetencave ndërkulturore, duhen përcaktuar qëllimet dhe objektivat e matshme. Vlerësimi i kompetencës ndërkulturore është i vështirë për t'u kryer nga një individ i vetëm, prandaj, në këtë proces, duhet të ndihmojnë edhe vetë studenët. (Deardorff, 2009:477)

IDI (Intercultural Development Inventory) (Hammer,M., 2012)– është një model i vlerësimit të kompetencave ndërkulturore që është bazuar në modelin e Bennett ‘*Developmental Model of Intercultural Sensitivity*’. Modeli i Bennett fillon me tre faza etnocentrike, në të cilën kultura jonë është në një farë mënyre në qender. Ndërsa tre fazat etnorelative në të cilën kultura jonë shifet në kontekstin e kulturave të tjera. (Bennett, 2001:10) Në fazën etnocentrike janë: mohimi, mbrojtja, minimizimi ndërsa në fazën etnorelative: pranimi, përshtatja, integrimi

Modeli **Intercultural Development Inventory** vlerësimi u shërben studentëve, pedagogëve, fakulteteve etj. IDI ofron mundësi për të matur kompetencat ndërkulturore të një individi ose një grupi. Ai është një pyetësor me 50 pyetje, që përdorur shkallën e vlerësimit Likert nga ‘dakord’ deri në ‘aspak dakord’ dhe është i disponueshëm në internet. Ky model është përdorur në 170 universitete në SHBA dhe në shumë universitet të tjera kombëtare (Hammer, 2008-2012). IDI mund të përdoret për të matur në mënyrë efektive orientimet drejt ndryshimeve kulturore. IDI mund të përdoret për të vlerësuar nivelin e kompetencave ndërkulturore të një individi, grupi apo një organizate. Pyetësi përfshin pyetje që u lejojnë personave të përshkruajnë eksperiencën ndërkulturore në lidhje me këto çështje (Hammer:2012):

- a. Qëllimet e tyre ndërkulturore;
- b. Sfidat që ata ndeshin, kur përballen me ndryshimet kulturore;
- c. Sitatat kritike që ata ndeshin, kur përballen me ndryshime kulturore gjatë studimeve të tyre jashtë shtetit;
- d. Mënyra sesi i përballojnë këto ndryshime kulturore. (Hammer,M., 2012:117)

Përdorimi i IDI-t do t'i ndihmojë shumë studentët që të jenë të vetëdijshëm për nivelin e kompetencave ndërkulturore të tyre. Më poshtë do të paraqisë një shembull të njëjësive vetëvlerësuese të IDI-së (Paige et al., 2003, Cit. Sinicrope, Norris & Watanabe, 2007:18)

Fazat e zhvillimit

Shembull i njëjësive

- | | |
|----------------------|---|
| 1. Mohimi | Shoqëria do të ishte më e mirë nëse grupet e ndryshme kulturore do të qëndronin me veten e tyre. |
| 2. Mbrojtje | Njerëzit në kulturën tjetër nuk janë aq mendje hapur sa në kulturën time. |
| 3. Minimizimi | Njerëzit janë njësoj pavarësisht ndryshimeve në pamje. |
| 4. Pranimi | Është normale që njerëzit nga kulturat e tjera nuk kanë me domosdoshmëri të njëjtat vlera dhe qëllime si njerëzit nga kultura ime |
| 4. Përshtatje | Kur hyj në kontakt me njerëz që janë nga kultura të tjera, e ndryshoj sjelljen për t'ju përshtatur atyre. |
| 5. Integrim | <i>nuk ka shembuj</i> |

Modeli i vazhdimësisë të zhvillimit ndërkulturor (Intercultural Development Continuum (IDC))- Rezultatet e IDI-t paraqiten në IDC, një kuadër teorik që fillon nga monokultura tek orientimet shumë kulturor (Hammer,2012:118). Ky është një model që vlerëson aftësitë e një individi ose grupi për të kuptuar ndryshimet dhe të përbashkëtat kulturore, për të komunikuar në mënyrë efikase me antarë të një gjuhë dhe kulturë tjetër. IDC-ja është një model i zhvillimit të kompetencave ndërkulturore i bazuar në

Developmental Model of Intercultural Sensitivity (DMIS), propozuar nga Milton Bennett-i (1986, 1993).

Ky model është i përberë nga 5 elemente të rëndësishëm, duke filluar nga orientimi njëkulturore (Denial- mospranim i kulturave të tjera) tek orientimi shumëkulturore (Adaptation- aftësia për t'u përshtatur). IDC-ja tregon që individët ose grupet që kanë 'mendime ndërkulturore', kanë më shumë mundësi t'u përgjigjur pozitivisht ndryshimeve kulturore, të njohin të përbashkëtat midis vetes dhe të tjerëve dhe të veprojnë në mënyrën e duhur. (Hammer, 2012). Pra, bazuar në modelin e krijuar të autorit kuptojmë që kompetenca ndërkulturore është një progres të pikëpamjeve nga monocultura drejt pikëpamjeve ndërkulturore: (Hammer, M & Hammer, R.M, 'Intercultural Development Inventory V.3 (IDI))

Pikëpamjet monokulturore: - shpjegojnë diferencat dhe të përbashkëtat kulturore, sipas vlerave dhe praktikave kulturore përkatëse;

- përdor stereotipe jo të ngushta për të identifikuar diferencat kulturore;
- mbështet perceptime më pak komplekse dhe eksperiencat mbi diferencat dhe të përbashkëtat kulturore.

Pikëpamjet ndërkulturore/globalizuese:

- shpjegon diferencat dhe të përbashkëtat kulturore, sipas vlerave dhe praktikave kulturore përkatëse dhe të tjetrit;
- përdor përgjithësimet kulturore për të shquar diferencat kulturore

- mbështet perceptime më komplekse dhe eksperiencat e të përbashkëtave dhe diferencave kulturore.




Figura 7. Modeli i vazhdimësisë të zhvillimit ndërkulturor *Burim: Hammer, M. (2012:119)*

1. **Mohimi** – Kjo është karakteristikë e individëve që kanë një eksperiencë të limituar me grupe të kulturave të tjera dhe kanë tendencë t'i përgjithësojnë ato kulturat. Në këtë fazë, individët nuk janë të prirur për të pranuar kulturat e tjera, duke mos vënë re as ndryshimet kulturore rreth tyre. Mohimi konsiston në mosinteresimin për kultura e tjera. Këshillohet që të punohet me studentët për të kuptuar ndryshimet kulturore, duke filluar nga elementet e dukshme (ushqime, muzike), tek elementet kulturore të padukshme (tabutë, zakonet, sjelljet joverbale) (Hammer, 2012:121). Që të njohin dhe të përballen me ndryshimet kulturore, një mënyrë e mirë është të pyesim individë ose grupe që kanë sjellje e perceptime të përbashkëta e të ndryshme me individë nga kultrua të tjera. (Hammer, M., 2015) Mendojmë se është gjithnjë e

rëndësishme që pedagogët të përpiqen të zgjojnë tek studentët kuriozitetin ndaj të tjerëve, duke përdorur metoda dhe ekka të përshtatshme

2. Polarizimi- Në këtë fazë, shihet kultura si ‘us versus them’, që do të thotë ‘ne kundër atyre’. Siç shprehet Hammer (2012), në këtë rast pozicionohemi në mbrojtje , duke e konsideruar kulturën tonë si më superiore, ose më të mirën dhe, për më tepër, duke shfaqur edhe ndjenja negative ndaj kulturave të tjera. Mund të ndodhë edhe e kundërta: t’i konsiderojmë kulturat e tjera më të mira, duke marrë rolin e një gjykuesi për kulturën tonë. Në të dyja këto raste kemi të bëjmë me një kuptim jo të sakët të kulturës. Këshillohet që pedagogu të ndihmojë studentët të mos kalojnë në ekstreme pa i kuptuar mirë dhe të tentojnë të gjejnë të përbashkëtat. (Hammer, 2012:208)
3. Minimizimi - Thekson të përbashkëtat kulturore dhe vlerat universale. Në këtë fazë studentët janë të vetëdijshëm për kulturat e tjera, mund të kenë njohuri edhe për disa zakone ose tradita. Këshillohet të rritet vetëdija kulturore, të rritet aftësia për të kuptuar element më të thella të diferencave kulturore, background-i (kornizat) i kulturës së përgjithshme, ose elementet specifike kulturore. (Hammer, 2012:209). Duke vepruar kështu, mësohet më shumë edhe për kulturën amtare.
4. Pranimi - Këtu kalohet drejt një orientimi global ndërkulturor. Në këtë fazë studentët janë në gjendje të kuptojnë dhe të vlerësojnë ndryshimet dhe të përbashkëtat midis kulturave. (Hammer, 2012). Kjo arrihet duke filluar më shumë njohuri për ndryshimet kulturore, çka i bën t’i shohin dhe t’i kuptojnë që këto karakteristika kulturore nga prespektiva e kulturave të tjera. Studentët kuptojnë që kultura amtare është vetëm një mënyrë për interpretimin e botës, por, në këtë fazë,

nuk janë akoma në gjendje të përshtaten me ndryshimet kulturore. Strategjia që këshillohet për këtë fazë është të ndihmojmë individët ose grupet të përfshihen në ndërveprim ndërkulturore, për të fituar më shumë njohuri mbi ndryshimet kulturore.

5. Përshtatja- aftësia për të qenë në gjendje për të ndryshuar prespektivat kulturore dhe për të pasur një sjellje të përshtatshme në çdo ambient kulturor Strategjia që këshillohet të rriten njohuritë e një personave për diferencat kulturore dhe të zhvillohen më tej aftësitë për t'iu përshtatur këtyre ndryshimeve. (Hammer, 2012)

Modeli **AAC& U Intercultural Knowledge and Competence Value Rubric** – u zhvillua nga përfaqësues akademikësh të universiteteve dhe kolegjeve të Shteteve të Bashkuar, pjestarë të *Association of American Colleges and Universities* (AAC & U). Sipas tyre, është një detyrim yni të përfshijmë njohuritë dhe kompetencën ndërkulturore në arsim, si anëtarë të një komuniteti botëror, që ndajmë të ardhmen me të tjerët. '*Intercultural Knowledge and Competence*' sugjeron një mënyrë sistematike që të matim kapacitetin tonë për të identifikuar karaktersitikat tona kulturore, të krahasojmë dhe të gjejmë ngjashmërit, të tregohemi empatikë dhe fleksibël në kontekste të ndryshme. Kjo modele e vlerëson kompetencën ndërkulturore në vlerën nga 1 (fillestar) deri në 4 (mjeshtër). *Intercultural knowledge and Competence* bazohen tek Bennett's (1993) *Developmental Model of Intercultural Sensitivity* (DMIS), Deardorff's *Intercultural Framework of Intercultural Competence* (2006). (Burim i informacionit: *Intercultural Knowledge and Competence Value Rubric*, *Association of American Colleges and Universities AAC & U Intercultural Knowledge and Competence Rubric* ndahet në gjashtë rubrika si më poshtë:

1. Njohuri (Knowledge) a. Vetëdija kulturore b. Njohja e kuadrove botërore kulturore

2. Aftësit (Skills) a. Empatia b. Komunikimi verbal dhe joverbal

3. Qëndrimet (Attitudes) a. Kurioziteti b. Të qenit i hapur

Modeli IES (Intercultural Effectiveness Scale) është një instrument matës që mund të përdoret në arsim, qeveri, sipërmarrje etj. Është krijuar për të matur sesa njerëzit janë në gjendje të menaxhojnë ndryshimet kulturore. Ky model fokusohet: sesi mësojmë për kultura të tjera dhe saktësia e të mësuarit; sesi i zhvillojmë dhe menaxhojmë marrëdhëniet me njerëz nga kultura të tjera; sesi e menaxhojmë stresin dhe sfidat kur ndërveprojmë me njëri-njëri që janë të ndryshme nga ne. IES mat tre faktorë, secili i përberë nga dy kompetenca: Continuous Learning (Të nxënies e vazhdueshme), Interpersonal Engagement (Përfshirje ndërpersonale), Hardiness (Qëndrueshmëri). Ky instrument matës është i përbërë nga 60 pyetje që maten me shkallën nga 1 (e ulët) dhe 6 (e lartë) (Burimi i informacionit: Mendenhall, M., et al. 'Specification of the Content Domain of the Intercultural Effectiveness Scale,' Volume 1, Number 3, November 2012)

1. **Continuous Learning** (Të nxënies e vazhdueshme) – Dimensioni i të nxënies të vazhdueshme matet me dy kompetenca kryesore: Self-Awareness (vetëdija) dhe Exploration (Eksplorimi). Këto kompetenca ndikojnë tek suksesi ndërkulturor, duke vepruar si motivues të brendshëm për të mësuar pse njerëzit nga një kulturë tjetër sillen dhe mendojnë ndryshe.

a. **Self-Awareness** (Vetëdija) – i referohet nivelit në të cilën njerëzit janë të vetëdijshëm për: a. pikat e dobëta dhe të forta në aftësit ndërpersonale. b. filozofinë dhe vlerat e tyre vetjake c. sesi eksperiencat e së shkuarës ka ndikuar në formimin e tyre. d. ndikimin që kanë vlerat dhe sjelljet në marrëdhënie me të tjerë.

b. **Exploration (Eksplorimi)** – pasqyron të qëniti i hapur dhe aktiv për të kuptuar ide, vlera, norma, situata dhe sjellje që janë të reja dhe të ndryshme. Përfshin gatishmërinë për të kuptuar ndryshimet kulturore dhe për të shmangur stereotipizimin e njerëzve nga kultura të ndryshme. Gjithashtu, refleton një dëshirë të brëndshme për të mësuar gjëra të reja, aftësi për të mësuar nga gabimet dhe për të ndryshuar strategjitë personale, për të siguruar sukses në mjedisin e punës dhe atë social.

2. **Interpersonal Engagement** (Përfshirje ndërpersonale) është një faktor që matet duke përdorur a. Global Mindest (Mendimi Global) dhe Relationship Interest (Interesi i marrëdhënies).

a. **Global Mindset** (Mendimi Global) mat shkallën e interesit të një individi për të mësuar në mënyrë aktive për kulturat e tjera. Ky proces i të nxëniti mund të zhvillohet nëpërmjet medias, lëndëve me zgjedhje në klasë, internetit, gazetave, dokumentarve etj. Shkalla në të cilën një individ kërkon në mënyrë aktive për të zgjeruar njohuritë personale për njerëzit dhe kulturën e tyre, pasqyron forcën e mendimit global të individit.

b. **Relationship Interest** (Interesi i marrëdhënies) pasqyron shkallën në të cilën njerëzit shfaqin dëshirë dhe gatishmëri për të filluar dhe mbajtur marrëdhënie me njerëz nga kultura të tjera.

3. **Hardiness** (Qëndrueshmëri) është e përbërë nga dy faktorë a. Positive Regard (lidhje positive) dhe Resilience (aftësi përshtatjeje)

a. **Positive Regard** (Lidhje positive) i referohet predispozitave për të parë kulturat e tjera dhe njerëzit e atyre kulturave nga një prespektive pozitive. Kjo është një përpjekje për të shmanguar stereotipet negative.

b. **Emotional Resilience** (Aftësi Përshtatje) i referohet shkallës në të cilën një person ka fuqi emocionale dhe përshtatje për të përballuar situatat sfiduese ndërkulturore. (Mendenhall, M et al., 2012: 7-12)

Modeli Global Prespective Inventory (GPI) është një vlerësues me bazë ueb-i për eksperiencat e individit dhe zhvillimin e perspektivës globale. Më shumë se 200 kolegje, universitete, organizata arsimore në Shtetet e Bashkuar përdorin GPI për të matur kompetencën ndërkulturore, të mësuarit global, dhe eksperiencën e të studiuarit jashtë shtetit. GPI mat sesi studentët mendojnë, si e shohin veten si njerëz me trashëgimi kulturore, dhe sesi ndërveprojnë me të tjerë me kultura, vlera dhe formim të ndryshëm. Janë tre dimensione që maten: secili dimension ka dy nën ndarje. (Braskamp, L.A et al., 2014:5 <http://gpi.central.edu>) Dimensionet janë:

Dimensionimi konjitiv : Zhvillimi konjitivë fokusohet tek njohuritë dhe në të kuptuarit e një personi se çfarë është e rëndësishme dhe e vërtete për t'u kuptuar.

Të dish: Shkalla e kompleksitetit të këndvështrimit të një individi për rëndësinë e kontekstit kulturor në vlerësimin se çfarë është e rëndësishme për të ditur dhe vlerësuar. (7 pyetje)

Njohuri: Shkalla e mirëkuptimit dhe ndërgjegjësimit për kultura të ndryshme dhe ndikimi i tyre në shoqërinë globale dhe niveli i avancuar i kompetencave gjuhësore në më shumë se një gjuhë. (5 pyetje)

Dimensioni Intrapersonal: Zhvillimi intrapersonal fokusohet në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe integritit të vlerave personale dhe identitetit në vete personin.

Identiteti: Niveli i ndërgjegjshmërisë për shkallën e veçantisë së identitetit, qëllimit dhe shkallën e pranimi të identitetit të një personi. (6 pyetje)

Ndikimi: Niveli i respektit dhe pranimi të prespektivave kulturore të ndryshme nga të tyret, si dhe niveli i besimit emocional, kur jetojnë në situata komplekse. (8 pyetje)

Dimensioni Interpersonal: Zhvillimi ndërpersonal është i përqëndruar në gatishmërinë e një personi për të ndërvepruar me persona me norma sociale dhe formim kulturor të ndryshëm nga i tij, si dhe në pranimin e të tjerëve.

Përgjegjësia Sociale: Niveli i ndërvarësisë dhe shqetësimit social për të tjerët. (5 pyetje)

Ndërveprimet Sociale: Shkalla e përfshirjes me të tjerë që janë të ndryshme nga vetja dhe shkalla e ndjeshmërisë kulturore në një mjedis pluralist. (7 pyetje)

Të dhënat e mbledhura nga GPI të ndihmojnë të kuptosh se si eksperiencat individuale ndikojnë në procesin e të nxënit dhe në zhvillimin e perspektivës globale. GPI ndihmon për të kuptuar se si studentët mendojnë (konjitive), se si e shohin veten e tyre (intrapersonal), dhe se si ndërveprojnë me të tjerë, që u përkasin kulturave dhe formimeve të ndryshme ose kanë vlera të ndryshme (interpersonal). Të dhënat maten me anë të shkallës Likert, duke filluar nga Plotësisht dakord – Plotësisht kundër (*Burimi i informacionit: <http://www.gpi.hs.iastate.edu>*).

4.4. Problemet dhe vështirësitë që ndeshin mësuesit në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore

Kompetenca ndërkulturore është një temë që është futur vetëm në vitet e fundit, gjë që e bën të vështirë për pedagogët për ta integruar gjatë orëve të mësimit në klasat e gjuhëve të huaja. Në ditët e sotme, trajnimi i pedagogëve për kompetencën ndërkulturore është shumë i nevojshëm. Pedagogët e gjuhëve të huaja janë gjithnjë përballë sfidës që të përditësohen me metodat më të reja, për të përmbushur kërkesat që po i shtohen arsimit. Pedagogët duhet të reflektojnë për metodat mësimore që përdorin gjatë orëve të mësimit për t'ju përgjigjur pyetjeve si: çfarë temash ndërkulturore duhet të përfshihen gjatë orëve të mësimit, cili është qëllimi i tyre, çfarë metodash mund të jenë më efikase për studentët duke pasur parasysh disavantazhet që ka arsimi jonë, cilat nga këto metodat e matjes së kompetencave ndërkulturore mund të jetë më efikase për arsimin tonë, a mendojnë që metodat që ata zgjedhin janë të përshtatshme për zhvillimin e kësaj kompetence.

Në kushtet tona, pedagogët nuk e kanë të lehtë të qëndrojnë gjatë në vendet anglishtfolëse, për të marrë eksperiencën e mjaftueshme për kulturën e gjuhës, pavarësisht që në pyetësor kanë deklaruar që kanë shumë njohuri në çdo fushë të kulturës. Ndërkaq, të ndjekin trajnime profesionale për kompetencat ndërkulturore, është edhe kosto financiare. Sipas Lazar, I & Harris, R., (2011) shprehen që të qëndruarit jashtështetit dhe trajnimet bëjnë një ndryshim thelbësor në shpeshësinë e aktiviteve me bazë kulturën që zhvillohen në klasë. Trajnimet në gjuhën e huaj sesi të zhvillojnë kompetencën ndërkulturore shërbejnë për të dhënë udhëzime praktike sesi të përfshijnë aktivitete me bazë kulturën gjatë orëve të mësimit dhe të ndihmojnë pedagogët të zhvillojnë tek studentët e tyre të ardhme

kompetencën ndërkulturore. Siç e kanë pohuar vetë ata, edhe koha që kanë në dispozicion për mësimdhënien e gjuhës së huaj, e bën të vështirë përfshirjen edhe të elementeve të tjera gjatë orëve të mësimi. Rekomandimi është që të planifikohen leksionet duke i ndërthurur të dyja në një plan të vetëm. Pra, të përdoren tema të cilat jo vetëm bëjnë të mundur përfshirjen e aftësive të nevojshme për zhvillimin e kompetencës por edhe të përvetësojnë kompetencën gjuhësore përmes aktiviteteve. Gjithashtu eksperiencia personale për mësimin e kompetencave ndërkulturore është e pakët. Problem përbën edhe fakti që një pjesë e mirë e pedagogëve, nuk e konsiderojnë si një qëllim të mirëfilltë mësimin e kompetencave ndërkulturore.

Pedagogët hasin shumë vështirësi në vlerësimin e kompetencave ndërkulturore:

- Vështirësia qëndron në faktin që nuk dinë se cilit prej elementeve t'i japin më shumë prioritet gjatë një orë mësimi;
- Nuk kanë në përdorim një plan vlerësimi të mirëpërcaktuar dhe të standardizuar;
- Objektivat e mësimdhënies duhet të përcaktohen në lidhje me njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vetëdijen kritike kulturore.
- Nuk janë të trajnuar dhe nuk kanë modele si të vlerësojnë kompetencat ndërkulturore.
- Nuk kanë bashkëpunim ose është shumë i limituar me institucionet që përfaqësojnë kulturën e gjuhës angleze në vendin tonë.
- Nuk kanë një plan sistematik sesi të zhvillohet kompetencën ndërkulturore,

Prania e limituar e materialeve kulturore që ofrohen në librat e gjuhës, e bën punën të vështirë dhe i detyron pedagogët të kërkojnë e të gjejnë më shumë materiale të tjera, . Përgatitja e këtyre materialeve kërkon kohë dhe punë ekstra. Sipas Byram,M., et al. (2002) në *Developing the intercultural dimension in language teaching, a practical introduction for teachers* sugjeron që edhe temat të cilat trajton në librat mund të cojnë në zhvillimin e kësaj kompetence, çelisi qëndron që t’ju ofrohet studenteve mundësia për të krahasuar temat në një situatë familiare me shembuj nga një situatë jo familiare. Së dyti, autorët shprehen që nuk është e nevojshme që pedagogët të jenë ekspertë në çdo fushë, detyra e tyre është të ndihmojnë studentët të bëjnë pyetje, dhe të interpretojnë përgjigjen. Së treti, kompetenca ndërkulturore është pjesërisht njohuri, por përbëhet edhe nga dimensione të tjera (savoir être, savoir apprendre/faire, savoir comprendre and savoir s'engager) që do të thotë në procesin e të nxënurit dhe të mësuarit duhet kushtuar rëndësi të gjitha këtyre elementeve. Pyetja në të cilën pedagogët duhet të bejnë nuk është sa informacion duhet studentët të përvetësojnë gjatë orës së mësimit, por sesi ti ndihmojmë studentët për të zhvilluar të gjitha dimensionet e kompetencës ndërkulturore. Gjithashtu, autorët shprehen që pedagogët dhe studentët jovendas kanë avantazhin për të parë kulturën nga një distance, me pak fjalë një person e ka shumë të vështirë të analizojë kulturën e tij. (Byram, M et al., 2002).

Pa ndërgjegjësimin e pedagogëve dhe të kuptuarit të rëndësisë së çështjeve kryesore të komunikimit ndërkulturor, progresi i studenteve është nën kërcënim. (Sercu, 2002b, Cit. Álvarez,I and Garrido,C, 2005). Duhet të jetë dëshira e pedagogëve për të integruar teori të reja. Qëndrimet dhe opinionin e pedagogëve në këtë çështje luan një rol kyç. Procesi i

përvetësimi të kompetencës ndërkulturore nuk është një proces që përvetësohet në mënyrë automatike.

Në lidhje me vërtetimin e hipotezave, bazuar në gjetjet dhe interpretimin e të dhënave arrijmë këto përfundime.

Hipoteza 1, “Kurrikula e gjuhës angleze nuk e parashikon si një rezultat të pritshëm të nxënësit zhvillimin e kompetencës ndërkulturore” vërtetohet pasi nga gjetjet del se kompetenca ndërkulturore nuk parashikohet si një rezultat i të nxënësit.

Hipoteza 2, ‘Mësimi i gjuhës së huaj është i përqendruar më tepër në zhvillimin e aftësive gjuhësore sesa në aftësimin për të kuptuar kultura të tjera’, vërtetohet pasi sipas gjetjeve zhvillimi i kompetencave gjuhësore mbetet parësor në mësimin e gjuhëve të huaja.

Hipoteza 3, “Pedagogët e gjuhës angleze nuk janë kualifikuar dhe trajnuar për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore”, vërtetohet pasi pedagogët kanë konfirmuar se nuk kanë marrë një trajnim të mirefilltë për kompetencën ndërkulturore.

KAPITULLI V:

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky kapitull synon të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të përfundimeve bazuar në gjetjet e studimit dhe rekomandimet respektive.

5.1. Kompetenca ndërkulturore mbi bazën e përceptimit të studentëve

Nga studimi rezulton se *mësimi i kompetencës ndërkulturore* në orët e gjuhës angleze është në një nivel mesatar. Sipas referimeve të studentëve, informacioni i ofruar në lidhje me historinë, gjeografinë, kushtet politike dhe kulturës e huaj është i mjaftueshëm, ndërsa aftësitë për të kuptuar dhe trajtuar situatat e kontaktit ndërkulturor si dhe qëndrimet tolerante ndaj kulturave të tjera kultivohen në një nivel mesatar. Studentët deklarojnë se vetëm 17.7% e pedagogëve integrojnë 100% kompetencën ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze.

Nga të dhënat e këtij studimi, mund të thuhet se *motivacioni i studentëve* për mësimin e gjuhës angleze dhe, në përgjithësi, qëndrimi i tyre ndaj gjuhës angleze është i një shkalle të lartë, pavarësisht se ata e konsiderojnë mësimin e gjuhës angleze mjaft të vështirë dhe pohojnë se kanë njohuri të një niveli mesatar në lidhje me kulturën e gjuhës angleze.

Për të testuar *njohjen me vendin e gjuhës së huaj*, studimi e përqendroi vëmendjen në veprimtaritë personale të studentëve, siç janë: udhëtimet, leximi i gazetave dhe revistave, përdorimi i internetit dhe i televizionit. Rezultate tregojnë se interneti dhe kanalet televizive janë mjetet më të përdorura për të siguruar këtë njohje. Pak është përdorur me këtë synim nga studentët leximi i gazetave dhe autorëve të huaj, ndërsa vizitat në vendin e

gjuhës së huaj janë të rralla (Tabela 26), duke përfshirë këtu vizitat turistike, ato tek të afërmit, për kurse gjuhe, ose në kuadrin e mobilitetit të studentëve (Tabela 28). Po kështu dhe kontaktet kulturore-shkencore, si vizita në institucionet kulturore të vendit të huaj, takime me pedagogë dhe studentë të huaj, janë thuajse të pakta. (Tabela 29).

Rëndësi e veçantë për kultivimin e kompetencës ndërkulturore iu kushtua njohurive lidhur me *kulturën dhe arsimin* e vendit të gjuhës së huaj, të *letërsisë dhe historisë* si dhe *vlerave dhe besimeve* përkatëse. Sipas rezultateve të studimit, studentët deklarojnë se kanë njohuri të mjaftueshme të kulturës së rinisë, arsimit dhe jetës profesionale si dhe aspekteve të tjera kulturore, letërsi, histori, gjeografi, sistem politik, etj. Njohuri të pakta pasqyrohen në lidhje me vlerat dhe besimet dhe grupet e ndryshme etnike dhe sociale.

Aktivitetet bazë të përdorura nga pedagogët, për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore të studentëve, ishin *tregimi, komenti, ilustrimi, imazhi dhe përvoja personale* (Tabela 21). Studentët konstatojnë se tregimi, përvoja personale dhe komenti përbëjnë metodat e përdorura më shpesh në mësimin e gjuhës angleze, kurse ilustrimi dhe imazhi më rrallë (Tabela 30). Përsa u përket aspekteve të veçanta kulturore që pedagogët trajtojnë në klasë, studentët gjejnë në shkallën "mjaftueshëm" aspekte të kulturës së rinisë dhe letërsisë dhe më pak aspekte të vlerave dhe besimeve kulturore (Tabela 31).

Për të hetuar rëndësinë dhe mundësinë e integritit të mësimdhënies kulturore, u studiuan aspekte të tilla siç janë: *roli i mëimit në kuptimin e identitetit* kulturor, *pamundësia e integritit të mësimdhënies* ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj, *zotërimi i gjuhës së huaj* si kusht për mësimdhënien kulturore, *imazhi pozitiv* i kulturës së

huaj (Tabela 22). Studentët janë pjesërisht dakord se mësimi i gjuhës së huaj mund të kontribuojë në zhvillimin e identitetit ndërkulturor, që përfshin tolerancën dhe të imazhit pozitiv për kulturën e huaj. Njëkohësisht, rezultatet tregojnë se studentët pjesërisht përkrahin mendimin që zotërimi i gjuhës së huaj është kusht bazë për mësimdhënien ndërkulturore. Për pamundësinë e integritit të mësimdhënies ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj, mendimi i studentëve është i papërcaktuar (Tabela 32).

5.1.1. Roli i gjinisë në përceptimin e kompetencës ndërkulturore të studentëve

Rezultatet e studimit zbulojnë ngjashmëri dhe ndryshime në përceptimin e kompetencës ndërkulturore të studentëve. Nuk u konstatuan diferenca gjinore në lidhje me çështjet: *mësimi i kompetencës ndërkulturore në mësimdhënien e gjuhës angleze, motivacioni i studentëve për mësimin e gjuhës angleze si dhe qëndrimi i studentëve ndaj mësimin të gjuhës angleze.*

Për çështjen *njohja me vendin e gjuhës së huaj*, rezulton që vajzat kanë më shumë se djemtë kontakte personale me vendin e gjuhës së huaj, shikojnë më shumë kanale televizive, lexojnë më shumë autorë të huaj dhe përdorin më shumë internetin për të mësuar për këtë vend (Tabela 26). Nuk u konstatuan ndryshime gjinore edhe për vizita *në vendin e gjuhës së huaj dhe kontakte kulturore-shkencore*. Megjithatë, vajzat, më shumë se djemtë, u japin rëndësi njohurive që lidhen me *kulturën dhe arsimin në vendin të gjuhës së huaj*, si dhe me *letërsinë dhe historinë* e këtij vendi (Tabela 27).

Gjinia nuk luan rol në aktivitetet që përdorin pedagogët për të ushtruar kompetencën ndërkulturore të studentëve siç janë *tregimi, komenti, ilustrimi, imazhi dhe përvoja*

personale. Të njëjtin mendim kanë vajzat dhe djemtë për aspektet e veçanta kulturore që trajtojnë pedagogu në klasë, siç janë: arsimi, kultura e rinisë dhe letërsia, vlerat dhe besimet kulturore (Tabela 31). Në lidhje me *rendësinë dhe mundësinë e mësimdhënies ndërkulturore në mësim*, vajzat, më shumë se djemtë, deklarojnë se imazhi pozitiv i kulturës së huaj mund të kontribuojë në mësimdhënien ndërkulturore (Tabela 32).

Në përgjithësi, vihet re që vajzat janë më të interesuara se djemtë për të pasur kompetencë ndërkulturore.

5.2. Kompetenca ndërkulturore mbi bazën e përceptimit të pedagogëve

Nga pedagogët, ashtu si nga studentët, u kërkuan të dhëna për çështjet e mëposhtme: (a) perceptimi i kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze, (b) gjuha dhe kultura e huaj në mësimin e gjuhës angleze, (c) njohja që kanë me kulturën e huaj, (d) aktivitetet mësimore për kulturën në gjuhën e huaj, dhe (e) mësimdhënien ndërkulturore në lëndën e gjuhës së huaj. Veç këtyre aspekteve, u testua dhe përceptimi i pedagogëve për objektivat e mësimin të gjuhës së huaj në lidhje me mësimdhënien ndërkulturore. Analiza e të dhënave u përqendrua në të gjitha këto aspekte të rëndësishme.

5.2.1. Përceptimi i kompetencës ndërkulturore mbi bazën e raportimit të pedagogëve

Analiza e të dhënave për objektivat e mësimin tregojnë se pedagogët përqendrohen në këto çështje kryesore: (a) *Kuptimi e identitetit dhe kulturës së studentëve*, (b) *Zhvillimi i prirjeve pozitive drejt kulturave të panjohura*, dhe (c) *Familjarizimi me kulturën e huaj*. Përcaktimi i kulturës dhe identitetit kulturor të studentit zë vendin kryesor në këto objektiva, pasi analiza faktoriale tregon se shpjegon përqindjen më të madhe të variancës (Tabela 16). Megjithatë,

në mësim, pedagogët merren shumë me familjarizimin me gjuhën e huaj dhe zhvillimin e prirjeve pozitive ndaj kulturave të panjohura (Grafiku 1).

Lidhur me *mësimin e kompetencës ndërkulturore* në mësimdhënien e gjuhës angleze, pedagogët i japin më shumë rëndësi ofrimit të informacionit për historinë, gjeografinë, kushtet politike dhe kulturën e huaj, dhe më pak rëndësi krijimit të aftësive ndërkulturore, si kontakti e toleranca (Grafiku 2). Ndërkaq, informacionin mbi vendin e gjuhës së huaj studentët mund ta marrin edhe në mënyrë të pavarur. Rezultatet tregojnë qartë se pedagogët i kushtojnë më shumë vëmendje mësimin të gjuhës së huaj, vetëm një pedagog deklaron integrim të gjuhës me kulturën e huaj (Tabela 3). Vlen të theksohet që shumica e pedagogëve e ndjen të nevojshme t'i kushtohet më shumë kohë kulturës së huaj në mësim. (Tabela 4).

Sipas të dhënave të pedagogëve, studentët shprehin një *motivacion të kënaqshëm* për të mësuar gjuhën angleze dhe për të njohur njerëz që kanë lidhje me këtë gjuhë, ndërsa mendojnë se mësimi i kësaj gjuhe është relativisht i vështirë dhe se njohuritë e tyre për kulturën që lidhet me këtë gjuhë angleze janë mesatare (Tabela 5).

Lidhur me kontaktin që kanë studentët me vendin e gjuhës së huaj, pedagogët deklarojnë se interneti është mjeti i përdorur më shpesh, kurse udhëtimet në vendin e huaj, leximi i gazetave apo revistave të vendit dhe televizioni shfrytëzohen më pak (Tabela 6). Për këtë çështje konsiderohen shumë të rëndësishme programet e mobilitetit për studentët.

Sa i takon *njohjes* me vendin e gjuhës së huaj, del se pedagogët njohin shumë kulturën dhe arsimin e këtij vendi dhe, thuajse më shumë se mjaftueshëm, letërsinë, vlerat

kulturore dhe besimet (Tabela 7). Vizitat në vendin e gjuhës së huaj janë, përgjithësisht, të rralla, por më të rralla janë ato në kuadrin e mobilitetit profesional (Tabela 8). Kontaktet më të shpeshta të pedagogëve realizohen nëpërmjet medias, ndërsa janë më të pakta ato mes vizitave në institucione kulturore të vendit të huaj në Shqipëri, takimeve me njerëz nga ky vendi që jetojnë në Shqipëri, me pedagogë ose studentë të huaj që vijnë në Universitet (Tabela 9).

Pedagogët deklarojnë se tregimi dhe komenti janë metodat që përdoren më shpesh në mësimin e gjuhës angleze, kurse ilustrimi dhe imazhi përdoren pak (Tabela 10). Për aspektete veçanta kulturore që trajtohen në klasë, pedagogët deklarojnë se i japin shumë rëndësi kulturës së rinisë dhe letërsisë dhe më pak vlerave dhe besimeve kulturore (Tabela 11).

Lidhur me rëndësinë dhe mundësinë e mësimdhënies kulturore, pedagogët janë pjesërisht dakord se mësimi i gjuhës së huaj mund të kontribuojë në zhvillimin e identitetit ndërkulturor dhe imazhit pozitiv për kulturën e huaj. Njëkohësisht, deklarojnë se janë pjesërisht kundër mendimeve se është i pamundur integrimi i mësimdhënies ndërkulturore në mësim dhe se zotërimi i gjuhës së huaj është kusht bazë për mësimdhënien ndërkulturore (Tabela 12).

5.2.2. Lidhja e metodave të mësimdhënies në gjuhën angleze me përceptimin e kompetencës ndërkulturore.

U aplikuan analizat e korrelacionit, për të studiuar se sa metodat e mësimdhënies lidhen me përceptimet e pedagogut për kompetencën ndërkulturore. Sipas rezultateve, formimi i

identitetit kulturor lidhet kryesisht me *tregimin.*, përdorimi i shpeshtë i të cilit sjell intensifikim të zhvillimit ndërkulturor. Metodat e tjera të mësimit nuk lidhen me zhvillimin e prirjeve pozitive dhe familjarizimin me kulturën e huaj (Tabela 14).

Faktor tjetër që ndikon pozitivisht në përdorimin e metodave të mësimit në gjuhën e huaj, është *motivacioni* i studentëve. Konkretisht, sa më shumë përdoret ilustrimi në mësim, aq më tepër rritet interesi i studentëve për gjuhën angleze (Tabela 16). Gjithashtu, metodat e mësimit ndikohen pozitivisht nga njohja që kanë pedagogët me gjuhën angleze. Konkretisht, sa më shumë kontakt kanë pedagogët me vendin e gjuhës së huaj, aq më shumë përdorin metodat e tregimit, të komentit dhe ilustrimit. Udhëtimet dhe njohja e vlerave dhe besimeve kulturore kontribuojnë pozitivisht në shfrytëzimin më të shpeshtë të përvojës në mësim. Njohja e letërsisë së huaj ndihmom, gjithashtu, përdorimin e shpeshtë të tregimit, të imazhit dhe përvojës si praktika mësimore (Tabela 17).

Pedagogët kanë dhënë mendime edhe për faktorët që lidhen me metodat e mësimit në mësimdhënien ndërkulturore. Konkretisht, komenti dhe identiteti kulturor lidhen pozitivisht mes tyre. Sa më shumë nxitet identiteti kulturor, aq më shumë përdoret komenti. Sa më pak pedagogët mendojnë se është i pamundur integrimi i mësimdhënies ndërkulturore në mësim dhe se zotërimi i gjuhës së huaj ka përparësi ndaj objektivave të tjera, aq më shumë përdorin komentin si metodë të mësimdhënies. Gjithashtu, mendimi se një pedagog duhet të paraqitet si imazh pozitiv i kulturës së huaj, ndikon negativisht në përdorimin e tregimit. Sa më pak e përkrahin pedagogët këtë mendim, aq më shumë përdorin tregimin (Tabela 18).

5.3. Vrojtimi i pedagogëve dhe studenteve

Studimi i kompetencës ndërkulturore në mësimin e gjuhës angleze u mbështet jo vetëm në të dhënat që u grumbulluan nga dy kampionët, i studentëve dhe i pedagogëve, por dhe në vrojtimet që u bënë në orët e mësimit, me objekt pedagogët dhe studentët. Qëllimi i tyre ishte të përdreshin si instrument për matjen e kompetencës ndërkulturore. Skedat e vrojtimit pasqyrohen në rezultatet e mëposhtme.

5.3.1. Skeda e vrojtimit të pedagogëve

Së pari, do ta nis me pyetjet (*Pedagogu korrekton modelet e të folurit, Pedagogu korrekton modelet e të shkruarit*) me vlerësimin më të madh demonstrim i shkëlqyer (vlera 4). Në bazë të këtyre rezultateve pedagogët tregonin më së mirë që korrektimi i modeleve të foluri dhe të shkruarit mbete një element shumë i rëndësishëm, që kryehesh nga të gjithë pedagogët.

Së dyti, nga ana e pedagogëve është vërejtur një demonstrim i mirë (vlera 3) për sa i përket *nxitjes së pjesëmarrjes* të studentëve në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore, dhe përmban pyetje si: "*Pedagogu u kërkon studentëve të luajnë role të takimit të njerëzve nga kultura të ndryshme*", "*Pedagogu u kërkon studentëve që në mënyrë të pavarur të hulumtojnë një aspekt të kulturës së huaj*", etj. Në bazë të skedave të vrojtimit shohim që pedagogët kishin tendence të mirë për të nxitur pjesëmarrjen e studenteve. Sigurisht, sot studenti duhet të kryej një rol sa më aktiv në klasë.

Së treti, nxitjen e identitetit kulturor që përmban pyetje që matin (p.sh. *Pedagogu nxit ndjenjen e simpatise me njerezit te kulturave te tjera, Pedagogu e ve theksin ne identitetin kulturor*) ishte në një nivelin 2 (demonstrim i zbeht).

Së katërti, i referohet "familjarizimit me kulturën e huaj" (p.sh. *Pedagogu nxit familjarizimin e studenteve me kulturen, qyteterimin e vendeve ku flitet gjuha angleze*). Këto pyetje janë vlerësuar me shkallën 3 (demonstrim i mirë). Të dhënat e pedagogëve janë të paraqitura në grafikun (3).

5.3.2. Skeda e vrojtimit të studentëve

Pyetjet e skedat të vrojtimit të veprimtarisë së studentëve, u nxorën përfuundime për pesë grupime: "Identifikimi i vlerave kulturore", "Identifikimi i dallimeve kulturore" "Mendimi në gjuhën e huaj" "Komentimi i dallimeve kulturore" dhe "Njohuri lidhur me kulturën e huaj".

Së pari, është studiuar veprimtaria e studentëve në mësim për 'identifikimin e vlerave' që përmbajnë pyetjet (*Studentët bëjnë dallimet kulturore, Studentet e demonstrojnë lidhjen e gjuhes me kulturen perkatese, Studentët i njohin stereotipat për kulturën e huaj*) në të cilën është vlerësuar me vlerën 2. Përsa i përket pyetje të grupuara në 'mendimi në gjuhën e huaj' (*Studentët e shohin veten si përdorues të gjuhës angleze, Studentët mendojnë në gjuhën angleze*) është vlerësuar me vlerën 3 pasi shifja një përpjeke të studenteve të përvetësonin sa më shumë nga gjuha e huaj. Veprimtaria e studentëve në mësim për 'Identifikimi i dallimeve kulturore' që përmbajnë pyetjet (*Studentët bëjnë dallimet kulturore, Studentet e demonstrojnë lidhjen e gjuhes me kulturen perkatese, Studentët i*

njohin stereotipat për kulturën e huaj) është vlerësuar me vlerën 2. "Komentimi i dallimeve kulturore' që përmbajnë pyetjet (*Studentët mbajnë një qëndrim për dallimet kulturore, Studentët e pranojnë ndryshimin në veten e tyre nëpërmjet ndikimit të gjuhës angleze, Studentët komentojnë praktikën kulturore*) është vlerësuar me vlerën 2, dhe "Njohuri lidhur me kulturën e huaj" që përmbajnë pyetjet (*Studentët kanë njohuri për kulturën e vendit të gjuhës angleze, Studentët i njohin dallimet ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës angleze*) është vlerësuar me vlerën 3. Të dhënat e studenteve janë të paraqitura në grafikun (4).

5.4. Fokus Grupet

Me rëndësi për studimin ishin dhe diskutimet në fokus grupet të cilat u përqendruan në metodologjinë e mësimdhënies dhe problemet që dalin gjatë zhvillimit të mësimi. Pyetjet e fokus grupeve ishin shumë të rëndësishme për të zbuluar mbi problemet që kanë pedagogët e gjuhëve të huaja, si p.sh mospasje e informacionit të duhur, mungesë dijes për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencës ndërkulturore. Për të plotësuar këto mungesa, pedagogëve u nevojitet një trajnim specifik.

Sipas mendimit të pedagogëve, problem për studentët është mungesa e aftësive praktike, ata nuk dinë si duhet të reagojnë në situata të caktuara, pasi nuk kanë jetuar në këto vende. Kjo del edhe nga përgjigjet e studenteve, të cilët deklarojnë që nuk udhëtojnë në vendet anglishtfolëse.

Ndër propozimet që kanë përmendur pedagogët janë: trajnimet specifike për zhvillimin e vlerësimin e kompetencës ndërkulturore dhe bashkëpunimi me institucionet që ndodhen në Shqipëri, kjo si për pedagogët ashtu edhe për studentët.

5.5. Rekomandimet

Synimi këtij disertacioni është që të kuptohet rëndësia që po merr kompetenca ndërkulturore në mësimin e gjuhës së huaj. Duke mësuar një gjuhë të huaj, studentët në mënyrë të pashmangshme mësojnë për shoqëritë e tjera dhe për praktikat kulturore. Të mësosh një gjuhë ashtu siç flitet nga një grup i caktuar do të thotë të mësosh kuptimet e përbashkëta, vlerat dhe praktikat të këtij grupi ashtu sic janë të mbartuar në atë gjuhë (Byram & Fleming, 1995:2).

Në bazë të dhënave të paraqitura del shumë qartë që zhvillimi i kompetencës gjuhësore mbetet objektivi parësor, kurse mësimi i kompetencave ndërkulturore mbetet objektivi dytësor. Edhe pse shumë autorë rekomandojnë metodat e krahasimit, të analizës me kulturën e gjuhës amtare ato nuk janë të shpeshta në mësimin e gjuhës së huaj. Kultura ashtu si gjuha është pjesë e identitetit të një personi. Perceptimi që kanë pedagogët në lidhje me kompetencën ndërkulturore është pozitiv, dhe kjo është një avantazh për studentët. Nëse student priten që të përvetësojnë kompetencën ndërkulturore, atëherë pedagogët e gjuhëve të huaj duhet të mësojnë atyre këtë kompetencë (Lochman.K., & Kappel,J., 2008). Duhet patur parasysh që student kanë vështirës për mësimin e kompetencave ndërkulturore, pasi rrethanat ekonomike dhe pozicioni gjeografik nuk të ofron kushte të përshtatshme për kontakte ndërkulturore, gjë që është një disavantazh për studentët dhe pedagogët tanë. Ashtu siç është përmendur edhe në analizën e të dhënave studentët, në Shqipëri kanë deklaruar që udhëtimet, kurset e gjuhëve të huaja ose programet e shkëmbit në kuadër të mobilitetit janë shumë të limituara. Të jesh kompetentë ndërkulturalisht përfshinë edhe këtë element, por jo vetëm. Duke qenë se kjo pjesë është një disavantazh si për pedagogët

edhe studentët, rekomandoj si teknik ‘nxitjen e imagjinatës’. Atë çfarë do ti duhet një folësi të dijë do të varet nga rrethanat dhe konteksti social në të cilën do të gjendet, ndërsa pedagogëve ju ngelet për të mësuar studenteve të gjitha aftësitë dhe njohuritë që do ti duhen një individ për të analizuar dhe interpretuar individualisht. Kompetencë ndërkulturore do të thotë të vlerësosh kulturat e tjera dhe të përshtatësh sjelljen tënde me një ose më shumë kultura (Lange, D., & Paige, M., 2003:237). Klasat e gjuhëve të huaja është vendi i duhur që ofron zhvillimin e kësaj kompetence.

Së pari, është e rëndësishme që të kuptohet që kompetencë ndërkulturore nuk do të thotë të heqësh dorë nga kultura e identiteti yt, por të fitosh aftësi për të kuptuar dhe interpretuar situata ndërkulturore të ndryshme nga të tuat.

Së dyti, duke qenë kompetent ndërkulturalisht, një individ është i aftë jo vetëm që të interpretojë dhe analizojë një kulturë të ndryshme, por edhe të reflektojë mbi kulturën e tij.

Së treti, kompetenca ndërkulturore nuk mund të përvetësohet në mënyrë spontane, ajo mund të zhvillohet, duke futur në kurrikulat e gjuhës së huaj, si një element të rëndësishëm të mësimi të saj. Sigurisht, kompetenca ndërkulturore nuk mund të përvetësohet njëherë e përgjithmonë, ajo është një proces i vazhdueshëm që na shoqëron gjatë gjithë jetës. Planifikimi dhe nxitja e përvetësimit të saj mbetet një detyrë e rëndësishme e pedagogëve të gjuhëve të huaja.

Është e rëndësishme që metodat tradicionale të të mësuarit, të zëvendësohen me metoda më efektive, që nxitin zhvillimin e kësaj kompetence. Të tilla janë metodat krahasuese, analizuese, interpretuese etj. Në lidhje me pedagogët e gjuhëve të huaja,

rekomandoj teorinë e identiteti social të Byram (2000). Kjo teori është shumë e vlefshme për pedagogët për të kuptuar sesi krijohen stereotipet dhe karakterizimi i tyre. Në bazë të kësaj teorie mund të ndërtojnë plane mësimore efikase në shërbim të studentëve.

Duhet të kuptohet se janë mësuesit ata që prezantojnë koncepte dhe vlera të reja tek studentet, janë ata që lehtësojnë procesin e zhvillimit të aftësive e të kompetencës dhe krijojnë kushte për t'i zbatuar këto në jetën e përditshme, në shkollë, në shtëpi apo në komunitetin ku jetojnë. (Brett, 2009:10) Rekomandohet, gjithashtu, që pedagogët t'i përgatitin aktivitetet për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore, duke përdorur metoda e mjete ndryshme dhe jo gjithnjë të njëjtat, për këtë lipset:

- të përcaktohen objektiva të qarta të nxënësit;
- të përcakohet tema dhe koha që do t'i kushtohet;
- temat të jenë të rëndësishme dhe të mundësojnë diskutim në grup;
- studenti të ketë një rol aktiv gjatë orës së mësimi,
- mësimi të mirëmenaxhohet, në mënyrë që të përfshihen të gjithë studentët.

Një ndër arsytet që është përmendur nga pedagogët është mungesa e kohës, pasi kjo kërkon kohë shtesë, dhe duke pasur parasysh kurrikulat e mbingarkuara dhe një kohë të shkurtë për të përmbushur silabusin brenda një simestrin, e bën të vështirë të integrohet gjatë orëve të mësimi. Sigurisht, gjetja e materialeve të ndryshme kërkon kohë, por tashmë, me metodat e reja të mësimëdhënies që kërkojnë një rol aktiv të studentëve në klasë, ata mund të ndihmojnë në mbledhjen e këtyre materialve. Zgjedhja e materialeve duhet të jetë në përputhje me objektivat. Pedagogët duhet të jenë të aftë për të zgjedhur

materialët e duhura, të japin detyrat e duhura që t'i ndihmojnë studentët që të aftësohen ndërkulturalisht (Sercu, 2006:57). Duhet të ofrohen nga pedagogët mënyra për gjetjen e materialeve, duke i orientuar me literaturë ekzistues, me faqe web-i, me gazeta online etj. Sot, me avancimin e teknologjisë është edhe më e lehtë të kërkojsh informacione në lidhje me çdo fushë. Nuk duhet që kompetenca ndërkulturore të zhvillohet në momentin që studenti ekspozohet me kulturën, por bazat duhet të merren nëpërmjet arsimit. Nuk është e vështirë për të gjetur argumenta të mjaftueshëm për të kuptuar rëndësinë që merr zhvillimi i kompetencës ndërkulturore tek studentët.

Është e domosdoshme që pedagogët të jënë të mirëinformuar për Piramidën dhe Modelin e procesit të kompetencës ndërkulturore (Deardorff,2006, Deardorff, 2009). Piramida është një model shumë i qartë që tregon sesi një individë mund të bëhet kompetent ndërkulturalisht duke ndjekur disa etapa. Sipas piramidës, procesi i kompetencës ndërkulturore paraqitet në formën e një cikli, duke theksuar idenë se kompetenca ndërkulturore është një proces i vazhdueshëm. Përsa i përket vlerësimi të kompetencës ndërkulturore, është thelbësore që të kuptohet që kompetenca ndërkulturore është një ndër qëllimet e mësimi të gjuhës së huaj dhe gjithashtu ndikon në ndryshimin e dinamikave në klasë dhe rrijten e motivimit të studenteve.

Sipas Deardorff-it, për të ndihmuar studentët që të zhvillojnë kompetencën ndërkulturore, mund të përdoret *OSEE Tool*, nëse janë të informuar për të. Në këtë pikë rekomandojmë që studentët të përgatien në rrallë të parë për pjesën teorike, që do të thotë të dijnë se çfarë është *OSEE Tool*, dhe më pas t'ju ofrohen situata konkrete ku të kuptojnë dhe ti analizojnë këto elemente.

Disa aktivitete që mund të realizohen për zhvillimin e kompetencës ndërkulturore janë: *loja me role* një aktivitet që e bën orën tërheqëse dhe zhvillon ndjenjën e empatisë dhe të respektit; prezantimi dhe analizimi i *situatave kritike*, ato raste të cilat lindin konflikte e keqkuptime si rezultat i mënyrave se si i percepton gjerat; *teatri, poezi dhe shkrimi krijues që* ndihmon jo vetëm në zhvillimin e imagjinatës, por edhe në përballjen me situata që nuk i ndeshin në jetën reale; *filmat dhe tekstet*, si një mënyrë e mirë për të zbuluar kulturën e huaj; *media sociale dhe mjete të komunikimit online*, si një mundësi e mirë për të shkëmbyer këndvështrime dhe opinione me një grup individësh të ndryshëm.

Vlerësimi i kompetencës ndërkulturore është një ndër vështirësitë që pedagogët hasin më shumë. Duke qenë se është një koncept i ri i futur vetëm në vitet e fundit dhe mungese e trajnimeve në lidhje me këtë koncept të ri e bën akoma më të vështirë për pedagogët. Në këtë disertacion kam dhënë disa sugjerime sesi të vlerësohet kompetenca ndërkulturore tek studentët. Modeli AIC (*Assessment of Intercultural Competence*) që mat zhvillimin e kompetencës ndërkulturore gjatë kalimi të kohës. Modeli INCA (*Intercultural Competence Assessment Project*), në të cilin ofrohen edhe udhëzime të detajuara si të vlerësohet kompetenca ndërkulturore. Gjithashtu, një mënyrë matëse e kompetencës ndërkulturore është edhe skeda e vrojtimit e krijuar në këtë disertacion. Ajo është e thjeshtë për t'u praktikuar gjatë orëve të mësimi. Aty shprehen qartë të gjitha elementet që nevojiten të vlerësohen nga pedagogët me shallën (1 nuk demonstronhet – 4 demonstrim i mirë). Pedagogët mund të mbajnë një kopje të kësaj skede gjatë orëve të mësimi.

Do të rekomandoja që pedagogët të jenë të mirëinformuar me modelin e vazhdimësisë të zhvillimit ndërkulturore (*Intercultural Development Continuum (IDC)*), që është një kuadër teorik që fillon nga monokultura drejt orientimit shumë kulturore. Me anë të këtij modeli kuptohen fazat në të cilën ndodh një student dhe sesi mund të ndihmoj një pedagogë gjatë kalimit nga njëra fazë në tjetrën. Sigurisht, pa harruar zhvillimin e një silabusi që përfshinë sëbashku gjuhën dhe kulturën, duke u fokusuar në analizën e sjelljeve, vlerave, qëndrimeve etj të kulturës së synuar.

LISTA E REFERENCAVE

LIBRA

1. Arabski,J. & Wojtaszek, Adam. *'Aspects of culture in Second Language Acquisition and Foreign Language Learning'* Springer (2011:29)
2. Bortini,P & Motamed-Afshari, Afshari,B. *'Intercultural Competence Research Report'* Developed and demonstrated within the framework of Youth in Action: Released 16 March 2012 (2012:4)
3. Bertelsmann Stiftung *'Intercultural competence – the key competence in the 21st century?'* Theses by the Bertelsmann Stiftung based on the models of intercultural competence by Dr. Darla K. Deardoff
4. Barret,M., Byram,M., Lazar,I., Mompoin-Gaillard,P., Philippou,S. Series editor Josef Huber *'Developing Intercultural Competence through Education'* Council of Europe Pestalozzi Series, No.3, Council of Europe Publishing, Printed at the Council of Europe (2013)
5. Bhawuk. D.P.S,& Sakuda,K.H. *'Intercultural Sensitivity for Global Managers'*, Chapter 19. (2009: 255-266)
6. Brett P., Mompoin-Gaillard & P., Salem M.H. *"How all teachers can support citizenship and human rights education: a framework for the development of competences"* Council of Europe Publishing, Strasbourg (2009:10)
7. Brandl,K *'Communicative language teaching in Action: Putting Principles to Work'*, Pearson, (2008:2-3)
8. Byram, M., Gribkova,B.,& Starkey,H,. *'Developing the intercultural dimension in Language Teaching'* A practical introduction for teachers. Council of Europe, Strasbourg (2002)
9. Byram, M., *"Multicultural societies, pluricultural people and project of intercultural education"* Council of Europe Publishing, Strasbourg (2009)
10. Byram. M., *'From Foreign Language Education to Education for Intercultural Citizenship'* Essays and Reflections (2008:86)
11. Byram,M,. *'Teaching and Assessing Intercultural Communicative Competence'* Multilingual Matters (1997)
12. Byram,M., et.al *'Developing Intercultural Competence in Practice'* Languages for Intercultural communication and education (2001)
13. Byram,M., et.al *'Intercultural Competence'* Language Policy Division DG IV- Directorate of School, Out-of-School and Higher Education, Council of Europe, Strasbourg, May (2003)

14. Byram, M., & Feng, A., '*Living and Studying Abroad*' Research and Practice, Languages for Intercultural Communication and Education 12, Multilingual Matters LTD (2006:233)
15. Byram, M., & Fleming, M., '*Language Learning in Intercultural Perspective*' Approaches through drama and ethnography, Cambridge Language Teaching Library, Cambridge University Press (1998)
16. Byram, M. & Zarate, G. '*Young people facing difference: some proposals for teacher*' Language learning for European citizenship and European Youth Campaigning against Racism, Xenophobia, Anti-Semitism and Intolerance, Council for Cultural Co-operation Education Committee, Council of Europe Publishing, (1995)
17. Byram, M et al. "*Multicultural Societies, Pluricultural People and the Project of Intercultural Education*", Language Policy Division DG IV/EDU/Lang (2009) 15, April, 09 www.coe.int/lang
18. Celce-Murcia, M., 'Rethinking the Role of Communicative Competence in Language Teaching' by Soler, E., & Jorda, M.P.S. 'Intercultural Language Use and Language Learning', Published by Springer (2007)
19. Coperias Aguilar, M.J 'Dealing with Intercultural Communicative Competence in the Foreign Language Classroom' by Soler, E., & Jorda, M.P.S. 'Intercultural Language Use and Language Learning', Published by Springer (2007)
20. Corbett, J. '*An Intercultural Approach to English Language Teaching*' ICE Languages for Intercultural Communication and Education (2003)
21. Cook, G. '*Applied linguistics*' Oxford University Press, (2003)
22. Council of Europe (2008). "*White Paper on Intercultural Dialogue: Living Together as Equals in Dignity*" Launched by the Council of Europe Ministers of Foreign Affairs at their 118th Ministerial Session, Strasbourg, 7 May 2008
23. Council of Europe '*Living together: Combining diversity and freedom in 21st-century Europe*' Report of the Group of Eminent Persons of the Council of Europe.
24. Council of Europe "*Autobiography of intercultural encounters*" Context, concepts and theories, Language Policy Division, Council of Europe Publishing, Strasbourg (2009)
25. Douglas Brown, H., 'Learning a second culture' in 'Culture Bound: Bridging the culture gap in language teaching' by Merrill Valdes, J., Cambridge University Press (2002: 35-34)
26. Deardorff, D.K & Berardo, K. '*Building cultural competence: Innovative Activities and Models*' 2012 By Stylus Publishing, D.K., '*The SAGE Handbook of Intercultural Competence*' SAGE Publications, Inc. bishinin, LLC
27. Deardorff, D., 'The SAGE Handbook of Intercultural Competence' SAGE Publications, Inc. (2009)

28. Deardorff, D., & Berardo, K. *'Building cultural competence: innovative activities and models'* Published by Stylus Publishing, LLC First Edition, (2012)
29. Deardorff, D. & Bowman, K. 'Beneath the Tip of the Iceberg: Improving English and Understanding of U.S Cultural Patterns.
<https://www.press.umich.edu/pdf/9780472033331-intro.pdf>
30. Emert, H.A. *'Developing Intercultural Competence through Teaching Abroad with Fulbright: Personal Experience and Professional Impact'* A Dissertation submitted to the faculty of the graduate school of the university of Minnesota. (2008:13-15)
31. Fantini, A. 'Language: Its cultural and intercultural Dimension' Adapted from 'Language, Culture and World view: Exploring the Nexus' By Alvino E. Fantini (1995), International Journal of Intercultural Relations, 19, pp 143-153
32. Fantini, A., & Tirmiyi, A., *'Exploring and Assessing Intercultural Competence'* SIT Graduate Institute/SIT Study Abroad Digital Collections (2006)
33. Fantini, A. 'Assessing Intercultural Competence Issues and Tools,' by Deardorff, D.K. 'The Sage Handbook of Intercultural Competence' (2009:466)
34. Graddol, D. Thompson, L. & Byram, M. *'Language and Culture'* British Studies in Applied Linguistics, British Association for Applied Linguistics in association with Multilingual Matters Ltd. (1993:24)
35. Glaser, E., et al. *'Intercultural competence for professional mobility'* European Centre for Modern Languages, Council of Europe Publishing (2007:15)
36. Guilherme, M., 'Critical language and intercultural communication pedagogy' (2012:360) Chapter 2 by Jackson, J. 'The Routledge Handbook of Language and Intercultural Communication'
37. Hammer, M. & Hammer, R.M., 'Intercultural Development Inventory V.3 (IDI)
38. Hammer, M. (2015) 'A Resource Guide for Effectively Using the Intercultural Development Inventory (IDI) Revised: January 1, 2015. Handbook of Methodology For Development of Intercultural Competence (2015: 29)
39. Holmes, P., 'The (inter)cultural turn in foreign language teaching' (pg.76) in Pachler, N., & Redondo, A. 'A practical Guide to Teaching Foreign Language in the Secondary School', Routledge Teaching Guides, Second Edition published (2014)
40. Huber-Kriegler, M. Lazar, I. & Strange, J. *'Mirrors and window'* An Intercultural Communication Textbook, European Center for Modern Languages; Council of Europe Publishing (2003:26)
41. House, J. 'What is an 'Intercultural Speaker' by Soler, E., & Jorda, M.P.S. 'Intercultural Language Use and Language Learning', Published by Springer (2007:19)
42. Jackson, J. *'Introducing Language and Intercultural Communication'* First published by Routledge (2014)

43. Lange, D., & Paige, R.M., " Culture as the Core: Perspectives on Culture in Second Language Learning" University of Minnesota-Twin Cities Campus, Information Age Publishing (2003)
44. Lazar, I., & Harris, R., Chapter Three: Action for change, Overcoming resistance, in Huber, J., 'Teacher Education for change, The theory behind the Council of Europe Pestalozzi Programme' Council of Europe Pestalozzi Series No.1 Council of Europe Publishing, (2011)
45. Liddicoat et al. 'Report on intercultural language learning', Australian Government: Department of Education, Science and Training (2003:50)
46. Lochman, K., & Kappel, J. "The World a Global Village" Intercultural Competence in English Foreign Language Teaching, Uitgeverij VUBPRESS (2008)
47. Lundgren, U., 'Intercultural Teacher: A case Study of a Course.' (2009) Chapter 7 in Feng, A., Byram, M., & Fleming, M., 'Becoming Interculturally Competent through Education and Training', Languages for Intercultural Communication and Education,.
48. Lussier, D., et al. (2007) 'Guidelines for the assessment of intercultural communicative competence (ICC) pp.(29-30) by Lazar et al. Developing and assessing intercultural communicative competence: A guide for language teachers and teacher educators, Council of Europe 2007
49. Kramsch, C. 'Language and culture', Oxford Introductions to Language Study, Series Editor H.G. Widdowson (1998:3)
50. Martin, N.J., & Nakayama, K.T.H., 'Hyrje në komunikimin ndërkulturor' UET Press, 2010, (2008:45)
51. M.E.S. Diumarti Bhaskara Rao, E., 'Methods of teaching English' Published by: Discovery Publishing House. (2004:54)
52. Moeller & Nugent "Building Intercultural Competence in the Language Classroom", by Dhonau, S., in "Unlock the gateway to communication", 2014 Report of Central States Conference on the Teaching of Foreign Language
53. Navaitiene, J., et al. (2013) 'Methodology for development of intercultural competence' This project has been funded with support from the European Commission, Project No. LLP-LDV-TOI-2013-LT-0145
54. Neuner, G (2003) 'Socio-cultural interim worlds in foreign language teaching and learning' in Byram, M 'Intercultural Competence' Council of Europe, (2003)
55. Neuner, G (2012) 'The dimensions of intercultural education' by Huber, J., 'Intercultural competence for all' Preparation for living in a heterogeneous world, Council of Europe Pestalozzi series No.2 Council of Europe Publishing, June 2012
56. O'Dowd, R. "Online intercultural exchange- An introduction for foreign language teachers" Multilingual Matters, Clevedon (2007)

57. Paulston B.Ch., *'Linguistic and Communicative Competence: Topics in Esl* (1992:39)
58. Opening Conference for the 50th Anniversary of the European Cultural Convention *'Wroclaw declaration on fifty years of European Cultural Cooperation.'*
59. Penn., J.D *'Assessing Complex General Education Student Learning Outcomes'* Chapter 6 *'Assessing Intercultural Competence'* Deardorff, New Direction for Institutional Research, no.149, Wiley Periodicals, Inc., A Wiley Company (2011)
60. Pederson, P., *'The five stages of Culture shock: Critical Incidents Around the World'*, Contribution in Psychology, Number 24, Greenwood Press, Westport, Connecticut, London (1995)
61. Richards, J.C., & Schmidt, R. Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics. Pearson Education Limited. (2002:252)
62. Richard, J.C (2006) *'Communicative Language Teaching Today'*, Cambridge University Press (2006:2-3)
63. Scarino, A. & Lidicoat, A.J., *'Teaching and Learning Languages'* A guide, Australian Government: Department of Education, Employment and Workplace Relations. (2009:27)
64. Sercu, L. *'Foreign Language Teachers and Intercultural Competence'* An international Investigation (2005) ICE Languages for Intercultural Communication and Education
65. Sercu, L., *'Acquiring intercultural communicative competence from textbooks'*, The case of Flemish adolescent pupils learning German, Leuven University Press (2000)
66. Stringer & Cassidy *'52 Activities for Improving Cross-Cultural Communication'* Intercultural Press, (2009:10)
67. Shaver, A.N., & Grandouiller Cedarville University *'Teaching history and culture here and abroad'* (2014: 38) by Dhonau, S. *'Unlock the Gateway to Communication'* 2014 Report of the Central States Conference on the Teaching of Foreign Languages.
68. Tomalin, B., *'Applying the Principles: Instruments for Intercultural Business Training'* In Feng, A., Byram, M., & Fleming, M., *'Becoming Interculturally Competent through Education and Training'*, Languages for Intercultural Communication and Education, (2009:121)
69. Tsai, Y., & Houghton, S., *"Becoming Intercultural: Inside and Outside the Classroom"*, Cambridge Scholars Publishing (2010)
70. UNESCO, *' UNESCO guidelines on intercultural education'* UNESCO Section of Education for Peace and Human Rights Division for the Promotion of Quality Education, Education Sector (2007)

71. UNESCO '*Intercultural Competences; conceptual and operational framework*'
Published in 2013 by UNESCO (2013: 9)
72. Zarate, G., et al. '*Culture mediation in language learning and teaching*' European
Center for Modern Languages (2004:219)
73. White Paper on Intercultural Dialogue '*Living Together As Equals in Dignity*'
Launched by the Council of Europe Ministers of Foreign Affairs at their 118th
Ministerial Session (Strasbourg, 7 May 2008)

ARTIKUL

74. Álvarez, I & Garrido, C 'Teachers' roles and training in intercultural education',
Resources 'Center for Languages Linguistics & Area Studies', (2005)
<https://www.llas.ac.uk/resources/paper/2258>
75. Bennett, J. '*Developing Intercultural Competence*' For international Education
Faculty and Staff; 2011 AIEA Conference* February 20-23, 2011 SAN
